

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

MANUAL PËR
PUNONJËSIT E POLICISË

TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

MANUAL PËR
PUNONJËSIT E POLICISË

NËNTOR 2021

@ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2021

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose të rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të Prezencës së OSBE-së.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Autorët: Steve Harvey, ekspert i pavarur

Anila Trimi, eksperte e pavarur

Juliana Rexha, Oficere Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore,
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

ISBN: 978 - 9928 - 294 - 70 - 8

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadrin e Programit “Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria”, zbatuar nga gjashtë organizata lokale dhe ndërkombëtare: UNICEF-i në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Terre des Homme, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë.

Ky dokument u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, gjithsesi pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

PËRMBAJTJA

Shkurtime	7
Hyrje.....	9
Kapitulli 1. Trafikimi i Qenieve Njerëzore	11
1.1 Informacion i përgjithshëm mbi trafikimin e qenieve njerëzore.....	11
1.2 Dallimi midis trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit	12
1.3 Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri, përshkrim i situatës.....	17
1.4 Legjislacioni për trafikimin e qenieve njerëzore.....	19
1.4.1 Legjislacioni ndërkombëtar	19
1.4.2 Legjislacioni shqiptar mbi trafikimin e qenieve njerëzore.....	22
1.4.3 Trafikimi i të miturve.....	24
1.4.4 Elementët e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore.....	26
1.5 Kuadri institucional në Shqipëri	32
1.6 Metodat e kontrollit	34
1.6.1 Përshkrim i mjeteve të kontrollit mbi viktimën.....	34
1.6.2 Çështja e dhënies së pëlqimit.....	37
Kapitulli 2. Treguesit e Trafikimit të Qenieve Njerëzore.....	39
2.1 Treguesit sipas udhëzuesëve ndërkombëtarë.....	39
2.2 Treguesit sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit	45
Kapitulli 3. Viktimat e trafikimit	49
3.1 Përkufizimi i “viktims” së trafikimit.....	49
3.2 Identifikimi i një viktime trafikimi	49
3.2.1 Parimet e përgjithshme të identifikimit	49
3.2.2 Identifikimi i viktimës së mundshme ose viktimës së trafikimit nga strukturat e policisë	52
3.3 Situata kur ka gjasë të hasen viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore.....	52
3.4 Intervista fillestare.....	54
3.5 Komunikimi me një viktimë trafikimi	56
3.6 Identifikimi i fëmijës viktimë e trafikimit.....	57
3.6.1 Identifikimi dhe raportimi i fëmijës viktimë e mundshme ose viktimë trafikimi nga strukturat e policisë	59
3.7 Trauma e viktimave të trafikimit	61
3.7.1 Dhuna dhe dëmtimi në një situatë trafikimi	61
3.7.2 Treguesit e traumës dhe abuzimit.....	62
3.8 Mbrojtja e viktimave të trafikimit	65
3.8.1 Shërbimet e kujdesit shoqëror, shëndetësor dhe psikologjik për viktimat e trafikimit në Shqipëri	65
3.8.2 Masa të posaçme mbrojtjeje për fëmijët viktimat	65
3.8.3 Periudha e reflektimit.....	65
3.8.4 Periudha e reflektimi në legjislacionin shqiptar	67
3.9 Parimet e punës me viktimat e trafikimit	67

Kapitulli 4. Mekanizmi Kombëtar i Referimit	69
4.1 Përkufizimi i Mekanizmit Kombëtar i Referimit. Kuadri ligjor	69
4.2 Mekanizmi Kombëtar i Referimit në Shqipëri	70
4.3 Puna ndërsektoriale	70
Kapitulli 5. Hetimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore	73
5.1 Hetimi me në qendër të drejtat e viktimës	73
5.2 Të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë hetimit sipas legjislacionit shqiptar	74
5.3 Format e hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore	77
5.3.1 Hetimi proaktiv	77
5.3.2 Hetimi reagues	78
5.4 Këqyrja e Viktimës së trafikimit	80
5.5 Vlerësimi i rrezikut	83
5.5.1 Çfarë është 'rreziku'?	83
Kapitulli 6. Intervista e një viktime trafikimi për sigurimin e provave	87
6.1 Qëllimi i një interviste	87
6.2 Intervista e Strukturuar	88
6.3 Metodologjia e Intervistës PEACE	90
6.3.1 Planifikimi dhe përgatitja për intervista	91
6.3.2 Zhvillimi i intervistës	94
6.3.3 Rrëfimi i historisë	97
6.3.4 Mbyllja	100
6.3.5 Vlerësimi	101
6.4 Intervistimi i viktimave fëmijë	102
Kapitulli 7. Teknikat Speciale të Hetimit	105
7.1 Përshkrim i teknikave	105
7.2 Përgjimi i komunikimeve	106
7.2.1 Praktika ndërkombëtare për përgjimet	106
7.2.2 Legjislacioni shqiptar për përgjimet	108
7.2.3 Shqyrtimi i të dhënave të komunikimit	109
7.3 Vëzhgimi	112
7.4 Hetimi financiar dhe pasuror	114
7.4.1 Si përdoren fitimet prej trafikantëve?	114
7.4.2 Legjislacioni ndërkombëtar	115
7.4.3 Hetimi financiar dhe pasuror sipas legjislacionit shqiptar	115
7.4.4 Hetimi Financiar në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore	117
7.4.5 Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit	117
Kapitulli 8. Bashkëpunimi me agjencitë ligjzbatuese dhe joligjzbatuese, sistemin gjyqësor dhe partnerët	119
8.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar ndërmjet agjencive ligjzbatuese	119
8.2 Shkëmbimi i Informacionit	120
8.3 Ndihma e Ndërsjellë Ligjore	121
8.4 Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile	123
Kapitulli 9. Mosdënimi i viktimës së trafikimit	125
9.1 Parime të përgjithshme	125
Bibliografi	127

SHKURTIME

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
EUROPOL	Agjencia Evropiane e Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ICTY	Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë
KDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur i Republikës së Shqipërisë
KiE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KP	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPrP	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
ILO	Organizatës Ndërkombëtare e Punës
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSBE/OSCE	Organizata për Siguri e Bashkëpunim në Evropë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët-
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
UNTOC	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar
VKM	Vendime të Këshillit të Ministrave

HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore konsiderohet si një krim kompleks për t'u hetuar dhe si një aktivitet kriminal global në rritje. Strukturat e policisë, në ushtrimin e detyrave të tyre për parandalimin dhe luftimin e trafikimit, duhet të jenë në dijeni të vazhdueshme të ndryshimeve të këtij fenomeni, qasjes globale të adresimit të tij dhe të legjislacionit vendas e të procedurave për bashkërendimin ndërinstytucional.

Ndërsa vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore ndryshon dhe shfaqen forma të reja dhe më komplekse të këtij krimi, trajnimi i strukturave të policisë është thelbësor për arritjen e rezultateve në masat kundër trafikimit.

Pothuajse njëzet vjet pas ndryshimeve më të rëndësishme të veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore në legjislacionin penal shqiptar, ndryshimet e herëpashershme në legjislacion dhe procedura për t'u përgjigjur tendencave të krimit dhe zhvillimit të akteve ndërkombëtare, kanë sjellë nevojën e përditësimit të programeve të trajnimit për policinë shqiptare në përputhje me këto zhvillime.

Për këtë qëllim, ky manual trajnimi synon të përcjellë metodat bashkëkohore të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore bazuar në të drejtat e njeriut, dhe qasjen ndërsektoriale.

Manuali i trajnimit, i hartuar me mbështetjen e Prezencës së OSBEsë në Shqipëri, sjell aspekte të pa trajtuara më parë të parandalimit të trafikimit, identifikimit dhe intervistimit të viktimave të trafikimit, hetimit proaktiv dhe bashkëpunimit me strukturat vendase dhe ato ndërkombëtare. Manuali synon të forcojë kapacitetet trajnuese të Akademisë së Sigurisë dhe në veçanti Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, për rritjen e vazhdueshme të njohurive të oficerëve në detyrë dhe atyre të ardhshëm. Ky manual vjen si rezultat i një analize të thelluar të nevojave për trajnim të strukturave të policisë të kryer nga Prezenca e OSBEsë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në vitin 2019, nëpërmjet pyetësorëve dhe intervistave me 102 punonjës policie të niveleve dhe strukturave të ndryshme. Në bashkëpunim me Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit është kryer dhe një vlerësim i thelluar i Planit Mësimor të Akademisë së Sigurisë për Trafikimit të Qenieve Njerëzore (TQNj), ku janë evidentuar çështjet që duhen përditësuar në kontekstin e trajtimit bashkëkohor të fenomenit të trafikimit si dhe në kuadrin e ndryshimeve në legjislacionin penal. Për adresimin e kuadrit ndërkombëtar, manuali i referohet materialeve burimore të ndryshme të OSBEsë, UNODCsë, ILOs dhe përsa i përket legjislacionit shqiptar i është referuar Komentari të Veprave Penale të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i botuar nga Prezenca e OSBEsë.

Qëllimi i manualit është:

- Forcimi i kapaciteteve të strukturave të policisë shqiptare për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore;
 - Njohja me konceptet e trafikimit të personave të rritur dhe të mitur si dhe me format e shfrytëzimit si dhe familjarizimi me procedurat për identifikimin e viktimave të trafikimit
 - Prezantimi i metodave proaktive të hetimit, duke reflektuar tiparet e grupeve kriminale të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore;
-

Ky manual është hartuar në kuadrin e programit “Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria”, i cili mbështetet nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe udhëhiqet nga UNICEF Shqipëri dhe zbatohet nga disa organizata përshirë OSBE-në.

Manuali është hartuar në kuadrin e veprimtarisë së Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në mbështetje të masave institucionale për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore. Në përputhje me Mandatin e miratuar nga Këshilli Permanent i OSBE-së¹, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ofron asistencë dhe ekspertizë autoriteteve shqiptare në disa fusha kryesore, ku përfshihen anti-trafikimi dhe asistenca ndaj policisë, veçanërisht nëpërmjet trajnimeve, për zbatimin e strategjive përkatëse.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbështet prej një kohe të gjatë strukturat e ndryshme shtetërore dhe të shoqërisë civile në adresimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve të punonjësve të policisë që punojnë për parandalimin dhe luftën ndaj veprës penale të trafikimit dhe në mbrojtjen e viktimave.

Autorët e manualit janë Z. Steve Harvey, ekspert ndërkombëtar për çështjet policore të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Zj. Anila Trimi, eksperte vendase për trajtimin ndërdisiplinar të trafikimit të qenieve njerëzore, Zj. Juliana Rexha, Oficere e Anti-Trafikimit e Prezencës së OSBE-së. Hartuesit falenderojnë Prof.Dr. Ilirjan Mandro, Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit të Akademisë së Sigurisë për mbështetjen dhe orientimin e vazhdueshëm gjatë procesit të hartimit të këtij manuali.

¹ Vendim i Këshillit Permanent të OSBE-së, Nr. 588, datë 18 dhjetor 2003: <https://ëë.osce.org/pc/20402?doën-load=true>

KAPITULLI 1.



TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

1.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

Trafikimi i qenieve njerëzore (TQNJ), i njohur edhe si skllavëria e kohëve moderne është një krim i rëndë si dhe një shkelje e të drejtave themelore dhe të dinjitetit të njeriut. Qëllimi i trafikimit është shfrytëzimi i personave vulnerabël për qëllimin e vetëm të përfitimit. Çdo shtet është i prekur në ndonjë formë apo trajtë të TQNJ.

Në literaturë dhe në praktikën e disa shteteve mund të haset dhe termi “trajtë moderne e skllavërisë”, një term i përdorur për të rritur ndërgjegjësimin për mënyrën se si mund të duket trafikimi për personat që janë të painformuar.

Ekzistojnë ende shumë mite në lidhje me trafikimin një prej tyre është se trafikimi i ndodh vetëm në nivel ndërkombëtar dhe se elementi ndërkombëtar i veprës së trafikimit është cilësues. Në fakt, ndonëse shumë raste të trafikimit të qenieve njerëzore përfshijnë një element ndërkombëtar, ku viktimat merret nga një shtet dhe çohet në një shtet tjetër dhe atje shfrytëzohet, trafikimi ndodh dhe brenda territorit të të njëjtit shtet dhe njihet si “trafikim i brendshëm”.

Ndonëse termi trafikim tregon një lëvizje, nuk është domosdoshmërisht e nevojshme të provohet lëvizja apo të vërtetohet kalimi i kufirit që vepra të cilësohet si trafikim. Një viktimë mund të trafikohet midis Vlorës dhe Shkodrës, për shembull, apo edhe nga njëra zonë e Tiranës në një tjetër.

Trafikimi mund të marrë trajta të ndryshme dhe mund të përfshijë:

- shfrytëzimin seksual, përfshirë prostitucionin;
 - punë apo shërbime e detyruara;
 - skllavërinë, punët e shtëpisë, heqjen e lirisë me dhunë dhe praktika që lidhen me to;
 - heqjen e organeve jetësore;
 - kriminalitetin e detyruar me forcë, p.sh. vjedhja e personave, vjedhja e dyqaneve dhe trafikimi i drogave.
-

Shfrytëzimi mund të fshihet shpesh pas veprave të tjera kriminale, si prostitucion, migracion i parregullt, krime kundër pronës, apo edhe mosmarrëveshje në marrëdhëniet e punës. Shpesh, viktimat shfrytëzohen në shumë mënyra, ose mund të përfshihen në veprimtari të tjera të paligjshme, duke rezultuar kështu në raste të trafikimit të qenieve njerëzore që nuk hetohen apo regjistrohen si të tilla.

Trafikimi i qenieve njerëzore në Shqipëri vazhdon të mbetet një problem për adresimin e të cilit kërkohet vëmendje e veçantë si e institucioneve shtetërore ashtu edhe organizatave

ndërkombëtare e OJF-ve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e parandalimit, mbrojtjes së viktimave dhe ndjekjes penale të veprave të trafikimit të personave.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta nga institucionet shtetërore dhe organizatat e ndryshme për të adresuar fenomenin ndër vite, Shqipëria ende konsiderohet “një vend burimi, tranziti dhe destinacioni për burrat, gratë dhe fëmijët subjekt i trafikimit për qëllime seksuale dhe punë të detyruar”².

Në nivel Evropian, Komisioni Evropian raporton³ se trafikimi me qëllim shfrytëzimin seksual mbetet forma më e përhapur e trafikimit në Bashkimin Evropian. Në shumë vende anëtare është raportuar edhe një rritje e trafikimit për qëllime të shfrytëzimit për punë. Pothuajse tri të katërtat e të gjitha viktimave në BE ishin femra (gra dhe vajza), më së shumti trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual. Gratë dhe vajzat kanë qenë në vazhdimësi shumica e viktimave të trafikimit që prej 2008, kur BE-ja filloi të mbledhë të dhëna për trafikimin e qenieve njerëzore. Fëmijët vazhdojnë të përbëjnë një numër të konsiderueshëm të viktimave në BE. Pjesa më e madhe e viktimave të mitura ishin vajza të trafikuar për shfrytëzim seksual dhe ishin shtetase të BE-së.

Rrjetet e trafikimit po tregojnë gjithmonë e më shumë nivele më të larta profesionalizmi dhe ekspertize. Grupet e krimit të organizuar të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore kanë rrjete kriminale të mirëstrukturuara. Një shqetësim në rritje është dhe keqpërdorimi i teknologjisë së informacionit nga ana e kriminelëve për rekrutimin dhe shfrytëzimin e virkimave të trafikimit.

1.2. DALLIMI MIDIS TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE DHE DHËNIES NDIHMË PËR KALIM TË PALIGJSHËM TË KUFIRIT

Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndryshëm nga kontrabandimi i migrantëve. Në këtë manual do të përdoret termi kontrabandim, në përputhje me terminologjinë e akteve ndërkombëtare, të cilat vënë theksin te trajtimi i njerëzve si mall që kontrabandohet nga një vend në tjetrin. Në kuptimin e legjislacionit shqiptar termi kontrabandim i referohet veprës penale “dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”.

Pavarësisht ngjashmërisë përsa i përket elementit të lëvizjes në rastet e kalimit të kufirit, trafikimi dhe kontrabandimi ndryshojnë në aspektin ligjor dhe në qëllimin e tyre.

Në përgjithësi, individët që paguajnë një kontrabandist për të hyrë në mënyrë të paligjshme në një shtet e bëjnë këtë gjë me dëshirë, ndërsa viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore shpesh mashtrohen ose detyrohen me forcë për shfrytëzim.

Hyrja në një shtet tjetër, në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme, nuk është një element i domosdoshëm i trafikimit të qenieve njerëzore. Shfrytëzimi seksual është trajta më e zakonshme e identifikuar e trafikimit të qenieve njerëzore e pasuar nga puna e detyruar. Trafikimi i personave për punë të detyruar ka gjasë të mos zbulohet sa duhet sepse është më pak i dukshëm dhe nuk identifikohet gjithmonë në mënyrën e saktë. Edhe forma të tjera të shfrytëzimit nuk janë të raportuara mjaftueshëm, të tilla si shërbimi shtëpiak, martesë e detyruar, heqja e organeve, shfrytëzimi i fëmijëve për lypje, tregtia e seksit, dhe konflikti i armatosur.

² Raporti i Departamentit të Shtetit për Trafikimin e Personave, 2020:

<https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/albania/>

³ Raport i Komisionit para Parlamentit dhe Këshillit, Raporti i tretë mbi zhvillimet në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020), sipas Nenit 20 të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave. Third report on the progress made in the fight against trafficking in human beings (europa.eu)

Në lidhje me dallimin me dhënien ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit ose kontrabandimin e emigrantëve siç cilësohet në legjislacionet e huaja "kontrabandimi i emigrantëve" është i përkufizuar në legjislacionin ndërkombëtar dhe përkufizimi i njohur ndërkombëtarisht sipas Protokollit Shtesë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar 2000, "Protokolli kundër kalimit kontrabandë të migrantëve në rrugë tokësore, detare dhe ajrore".

Neni 3 i Protokollit parashikon që:

"Kontrabandimi i emigrantëve" është prokurimi, në mënyrë që të fitohet, drejtpërdrejt ose jo, një përfitim financiar ose material, i hyrjes së paligjshme të një personi në një Shtet Palë në të cilin personi në fjalë nuk është as shtetas dhe as me leje banimi të përhershme.

Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi dallojnë në tri çështje kryesore⁴:

Pëlqimi:

Emigrantët japin pëlqimin për kalimin e kufirit dhe nëse kalimi i kufirit kryhet në rrethana të rrezikshme. Nga ana tjetër, viktimat e trafikimit ose nuk e kanë dhënë fare pëlqimin ose, nëse e kanë dhënë këtë pëlqim në fillim, ai pëlqim e humbet kuptimin nga veprimet shtrënguese, mashtruese apo abuzive të trafikantëve.

Shfrytëzimi

Kontrabandimi përfundon me mbërritjen e migrantëve në destinacionin e tyre, ndërsa trafikimi përfshin shfrytëzimin e vazhdueshëm të viktimës në një mënyrë të caktuar për të gjeneruar përfitime të paligjshme për trafikantët. Nga këndvështrimi praktik, viktimat e trafikimit pihen gjithashtu të ndikohen më rëndë dhe të gjenden në një nevojë më të madhe për mbrojtje nga riviktimizimi dhe trajta të tjera të abuzimit të mëtejshëm krahasuar me migrantët që kanë kaluar në mënyrë kontrabandë.

Dimensioni ndërkombëtar

Kontrabandimi ka gjithmonë dimensionin e kalimit të kufijve të një vendi, ndërsa trafikimi mund të mos e ketë dimensionin ndërkombëtar. Trafikimi mund të ndodhë pavarësisht nëse viktimat janë çuar në një shtet tjetër apo vetëm sa janë zhvendosur nga një vend në një tjetër, brenda të njëjtit shtet.

DALLIMI MIDIS 'KONTRABANDIMIT' DHE 'TRAFIKIMIT'

KONTRABANDIMI	TRAFIKIMI
Krim kundra kufirit shtetëror	Krim kundra njeriut
Qëllimi është transportimi	Qëllimi është shfrytëzimi
I domosdoshëm elementi i kalimit të kufirit ndërshtetëror	NUK është I domosdoshëm elementi i kësaj lloji të kufirit ndërshtetëror
Me vullnet të lirë të personit	Kundër vullnetit të lirë të personit

⁴ UNODC, Raporti Global Mbi Trafikimin e Personave, 2020. https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/tip/2021/GLOTIP_2020_15jan_web.pdf

FAKTORËT SHTYTËS DHE TËRHEQËS

Pabarazia e të ardhurave, gjendja ekonomike, situata e respektimit të drejtave të njeriut dhe siguria njihen si faktorë shtytës për migrimin. Migrimi në kërkim të punës është shndërruar gjithmonë e më shumë një strategji jetese si për gratë edhe për burrat për shkak të mungesës së mundësive për punësim të plotë dhe për një punë të përshtatshme në shumë vende në zhvillim.

Rrugët e tranzitit, tendencat dhe metodologjitë ndryshojnë dhe trafikimi i qenieve njerëzore ndikohet dhe preket nga ndryshimet kulturore, ekonomike dhe sociale.

Vetë natyra e krimit të organizuar e bën të vështirë që të ketë të dhëna krejtësisht të sakta dhe të plota për trafikimin e qenieve njerëzore. Megjithatë, përgjithësisht ai konsiderohet si një veprimtari madhore kriminale në të gjithë botën.

Në ndryshim nga llojet e tjera të veprimtarive të paligjshme, trafikimi i qenieve njerëzore mbështetet kryesisht te praktikët e shkeljes së të drejtave të njeriut të personave të viktimizuar dhe çon në mohimin e dinjitetit të tyre. Praktikët e trafikimit i bëjnë qeniet njerëzore objekt tregtie: të gjitha fitimet monetare nxirren nga shfrytëzimi i personave të përfshirë. Personat e kapur nga këto rrjete janë të detyruar të japin shërbime për përfitim të tyre: ata janë të privuar nga çdo lloj kontrolli mbi jetën e tyre pasi trajtohen si mall për t'u tregtuar.

Për shkak të kompleksitetit të këtij krimi, të gjitha strukturat ligj zbatuese të angazhuara në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore përballen me sfida dhe vështirësi në hetimin e trafikimit.

Një prej sfidave më madhore është mënyra se si të identifikohen personat e trafikuar. Identifikimi i një rasti trafikimi duke e dalluar atë nga rastet e punësimit të parregullt, migrimit të paligjshëm, prostitucionit, etj. është një prej sfidave kryesore me të cilat përballen oficerët e policisë.

Së dyti, personat e trafikuar shpesh nuk janë në gjendje të dëshmojnë si në lidhje me trafikimin e tyre, për shkak të rrezikut të ndëshkimit ndaj vetë atyre apo familjarëve/të dashurve të tyre dhe/ose për shkak të dhunës dhe përvojave traumatike që ka përjetuar viktimat.

Për rrjedhojë, oficerët e policisë përballen me një sërë sfidash krejtësisht të reja ku viktimat zakonisht nuk janë menjëherë të disponueshme për të bashkëpunuar dhe për të denoncuar autorët e veprës penale. Kjo gjë mund të krijojë vështirësi në hetimin dhe ndjekjen penale në mënyrë reaguese të rasteve të trafikimit.

Roli i Policisë lidhet me mbrojtjen e të drejtave të viktimës për siguri dhe mbështetje, përfshirë mbrojtje nga trafikantët, mbrojtje e identitetit të tyre, pavarësisht nëse viktimat vepron si dëshmitar apo jo. Për ta arritur këtë, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me aktorë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është me rëndësi kyçe.

Kjo e fundit është me vend për të gjitha fazat e hetimit të një rasti trafikimi. Ashtu si në rastin e krimeve të tjera ndërkombëtare, njohja e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për trafikimin e qenieve njerëzore është me rëndësi thelbësore për trajtimin e kompleksiteteve që paraqesin rastet e trafikimit.

TABLOJA GLOBALE

Sipas raportit global për vitin 2020 të Kombeve të Bashkuara⁵ për çdo 10 viktime trafikimi të identifikuar në botë, rreth 5 janë gra dhe 2 vajza. Rreth një e treta e të gjithë viktimeve të trafikimit në botë janë fëmijë, vajza (19 për qind) dhe djem (15 për qind), ndërsa 20 për qind janë meshkuj të rritur. Synimi i trafikantëve janë personat në vështirësi ekonomike, emigrantët e parregullt, personat në nevojë të dëshpëruar për punë që bien pre e trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë. Fëmijët nga familje tepër të varfra, jofunksionale apo pa kujdes prindëror bien lehtësisht pre e trafikantëve. Në vendet me të ardhura të ulta, rreth gjysma e viktimeve të trafikimit (46 për qind) janë fëmijë, të trafikuar me qëllim shfrytëzimin për punë. Në vendet me të ardhura më të larta, fëmijët trafikohen kryesisht për qëllim shfrytëzimi seksual, aktivitete kriminale, lypje të detyruar.

Agjencia Evropiane e Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit (Europol) paralajmëron se trafikimi i qenieve njerëzore ka gjasë të rritet në periudhën pas rënies ekonomike për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 pasi papunësia rritet si pasojë e saj, dhe mund të pritët një rritje në kërkesën për trafikim për qëllime pune dhe të shfrytëzimit seksual⁶.

Përveç formave tradicionale të shfrytëzimit (prostitucion, lypje dhe vjedhje, sektorët e produkteve tekstile dhe bujqësore), sektorë të tjerë si ndërtimi, turizmi, katering, shërbimet e infermierisë dhe shërbimet në shtëpi po preken gjithmonë e më shumë nga trafikimi i qenieve njerëzore. Përveç dëmit të tejzgatur të pësuar nga viktimat e trafikimit, mbyllja e bizneseve me marzhe të ulëta fitimi për shkak të krizës ekonomike do ta lërë tregun të hapur për ata që kanë në dispozicion punë të lirë apo të paligjshme⁷.

Shfrytëzimi seksual vijon të mbetet qëllimi mbizotërues i trafikimit në BE. Në shumë vende anëtare është raportuar edhe një rritje e trafikimit për qëllime të shfrytëzimit për punë. Pothuajse tri të katërtat e të gjitha viktimeve në BE ishin femra (gra dhe vajza), më së shumti trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual. Gratë dhe vajzat kanë qenë në vazhdimësi shumica e viktimeve të trafikimit që prej 2008, kur BE-ja filloi të mbledhë të dhëna për trafikimin e qenieve njerëzore⁸.

Fëmijët vazhdojnë të përbëjnë një numër të konsiderueshëm të viktimeve në BE. Pjesa më e madhe e viktimeve të mitura ishin vajza të trafikuar për shfrytëzim seksual dhe ishin shtetase të BE-së.

TRAFIKIMI I FËMIJËVE

Trafikimi i fëmijëve mbetet një shqetësim madhor në nivel global dhe në Shqipëri, në veçanti trafikimi i djemve dhe vajzave për shfrytëzim seksual dhe për kriminalitet të detyruar, për krime ndaj pronës si vjedhja në rrugë, dyqane banesa, shpërndarje apo kultivimi i kanabisit, për martesë të detyruar, në moshë të vogël dhe të rreme.

5 UNODC, Raporti Global Mbi Trafikimin e Personave, 2020. https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/tip/2021/GLOTiP_2020_15jan_web.pdf

6 Studimi i Europol "Përtej pandemisë". [Titulli në origjinal Europol, 'Beyond the pandemic' April 2020] <https://www.europol.europa.eu/publications-documents/beyond-pandemic-how-covid-19-will-shape-serious-and-organised-crime-landscape-in-eu>

7 Studimi i Europol "Përtej pandemisë". [Titulli në origjinal Europol, 'Beyond the pandemic' April 2020] <https://www.europol.europa.eu/publications-documents/beyond-pandemic-how-covid-19-will-shape-serious-and-organised-crime-landscape-in-eu>

8 Studimi i Europol "Përtej pandemisë". [Titulli në origjinal Europol, 'Beyond the pandemic' April 2020] <https://www.europol.europa.eu/publications-documents/beyond-pandemic-how-covid-19-will-shape-serious-and-organised-crime-landscape-in-eu>

Fëmijët që gjenden në migracion, sidomos fëmijët migrantë të pashoqëruar, vijnë në BE në rrezik më të lartë trafikimi dhe shfrytëzimi gjatë rrugëve të migrimit drejt BE-së dhe në BE. Trafikantët kanë përdorur shpesh qendrat e pritjes për të identifikuar viktimat e mundshme dhe për të organizuar transportin e tyre për në vendet e shfrytëzimit.⁹

SHFRYTËZIMI I FËMIJËVE

Vajza dhe djem nga të gjitha moshat preken dhe trafikohen si brenda edhe jashtë vendit për shumë arsye dhe për të gjitha trajtat e shfrytëzimit.

Viktimat mund të shfrytëzohen seksualisht dhe të detyrohen të punojnë në industrinë e seksit. Viktimat janë gjetur në shtëpi publike, sauna, dhe klube nate ku ka kërcime erotike. Personat që i janë nënshtruar punës së detyruar janë gjetur të punojnë për pak ose aspak lekë në ferma, fabrika, njësi estetike, lavazhe, hotele dhe restorante.

Puna si shërbyes në familje përfshin viktimat që punojnë pranë një familjeje ku i nënshtrohen orëve të gjata të punës me pak ose aspak pagesë, shpesh në kushte shumë të papërshtatshme pune. Disa herë martesat me detyrim mund të çojnë në punë si shërbyes në familje. Shfrytëzimi për veprime kriminale mund të përfshijë të rinjtë që detyrohen të punojnë në kultivimin e kanabisit, trafikimin e drogave, lypjen dhe vjedhjen e personave. Lloje të tjera shfrytëzimi përfshijnë detyrimin prej borxhit (detyruar për të punuar për të shlyer borxhe të cilat në të vërtetë nuk do të jenë asnjë herë në gjendje t'i shlyejnë), marrjen e organeve, mashtrimin financiar (përfshirë mashtrimin për përfitime), dhe adoptimin e paligjshëm.

Shpesh viktimat përballen me më shumë se një lloj abuzimi dhe skllavërie. Për shembull, ata mund të shiten te një trafikant tjetër dhe më pas të detyrohen t'i nënshtrohen një forme tjetër shfrytëzimi.

Fëmijët dhe të rinjtë mund të shfrytëzohen nga prindërit, kujdestarët, apo anëtarët e familjes. Shpesh fëmija apo i riu nuk e kuptojnë se anëtarët e familjes janë të përfshirë në shfrytëzim.

Identifikimi i fëmijëve viktimat të mundshme të trafikimit mund të jetë i vështirë pasi ata mund të mos tregojnë shenja të dukshme shqetësimi apo abuzimi. Disa fëmijë janë të pavetëdijshëm se janë trafikuar, ndërsa disa të tjerë marrin pjesë aktivisht për të fshehur se janë trafikuar.

Edhe kur një fëmijë e kupton se çfarë ka ndodhur, ata gjithsesi duket t'i nënshtrohen me dëshirë asaj që besojnë se është vullneti i prindërve apo i të rriturve që i shoqërojnë. Është e rëndësishme që edhe këta fëmijë të mbrohen. Fëmijët nuk kanë aftësi ligjore për të dhënë 'pëlqimin' e tyre për t'u trafikuar apo shfrytëzuar.

⁹ Raporti i tretë i progresit të arritur në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020), sipas përcaktimeve në Nenin 20 të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij. Tetor 2020. [Titulli në origjinal: Third report on the progress made in the fight against trafficking in human beings] https://ec.europa.eu/anti-trafficking/eu-policy/third-report-progress-made-fight-against-trafficking-human-beings_en

1.3 TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE NË SHQIPËRI, PËRSHKRIM I SITUATËS

Trafikantët e qenieve njerëzore shfrytëzojnë shtetas shqiptarë si në Shqipëri edhe në shtete të tjera. Trajta më e përhapur e raportuar e shfrytëzimit të grave dhe vajzave shqiptare është prostitucioni i detyruar në Shqipëri, Itali, Belgjikë, Francë, dhe në Mbretërinë e Bashkuar¹⁰. Ka raportime për shfrytëzim të burrave dhe djemve për punë të detyruar dhe shfrytëzim i djemve të mitur për veprimtari kriminale.

Trafikimi i personave në Shqipëri vazhdon të mbetet një problem për adresimin e të cilit kërkohet vëmendje e veçantë si e institucioneve shtetërore ashtu edhe organizatave ndërkombëtare e OJF-ve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e parandalimit, mbrojtjes së viktimave dhe ndjekjes penale të veprave të trafikimit të personave.

Pavarësisht përpjekjeve të shumta nga institucionet shtetërore dhe organizatat e ndryshme për të adresuar fenomenin ndër vite, Shqipëria ende konsiderohet “një vend burimi, tranziti dhe destinacioni për burrat, gratë dhe fëmijët subjekt i trafikimit për qëllime seksuale dhe punë të detyruar”¹¹. Si Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, ashtu edhe raporti për Punën e Fëmijëve i qeverisë së SHBA¹² shprehen se “Qeveria nuk i ka përmbushur standardet minimale për eliminimin e trafikimit” dhe “ka avancuar pak në drejtim të eliminimit të formave më të këqija të punës së fëmijëve”.

Në tabelën më poshtë pasqyrohen rastet e viktimave të mundshme dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri në periudhën 2015-2020, të mbledhura dhe raportuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Anti-Trafik pranë Ministrisë së Brendshme¹³. Rastet e raportuara janë identifikuar dhe raportuar nga institucione të ndryshme anëtarë të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, përfshirë strukturat e policisë së Shtetit. Vihet re një thellim i diferencës midis rasteve të cilësuar si “viktima të mundshme” dhe “viktima trafikimi”, që kërkon një analizë të mirëfilltë të kësaj difference.

VITI	NUMRI I PËRGJITHSHËM I RASTEVE	VIKTIMA TË MUNDSHME TRAFIKIMI	VIKTIMA TRAFIKIMI	TË MITUR VIKTIMA TË MUNDSHME DHE VIKTIMA TRAFIKIMI
2015	109	71	38	48
2016	95	62	33	44
2017	105	79	26	56
2018	95	93	2	67
2019	103	96	7	67
2020	75	70	5	51

¹⁰ Raporti i Departamentit të Shtetit për Trafikimin e Personave, 2020: <https://www.state.gov/reports/2020-traffic-ing-in-persons-report/albania/>

¹¹ https://al.usembassy.gov/ep-content/uploads/sites/140/TIP_ENG.pdf, faqe 69.

¹² Raport mbi punën e fëmijëve dhe punën e detyruar, Shqipëria, 2019: <https://www.dol.gov/agencies/ilab/resources/reports/child-labor/albania>

¹³ <https://mb.gov.al/raporte-mbi-zbatimin-e-strategjive-dhe-planeve-kombetare-te-veprimit/>

TRAFIKIMI I FËMIJËVE – SITUATA NË SHQIPËRI

Nga të dhënat zyrtare, vihet re se janë fëmijë më shumë se 50 përqind e viktimave të mundshme të trafikimit në Shqipëri. Në vitin 2020, OSBE ndërmori një studim të thelluar të rasteve të raportuara nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri¹⁴, me tregues të fortë trafikimi, dhe konstatoi se nga 41 nga 45 raste të analizuar nuk përfshinin elementin ndërkombëtar në to. Për më tepër, ato përfaqësonin rreziqe të trafikimit apo shfrytëzimit të fëmijës tërësisht brenda kufijve të Shqipërisë. Kjo vë në dukje nevojën për reformimin e kuadrit ligjor në Shqipëri me qëllim njohjen e trafikimit si një dukuri që ndodh sa brenda vendit edhe në kontekstin ndërkombëtar.

Rastet e analizuar evidentuan format më të përhapura të trafikimit, si trafikimi për shfrytëzim seksual, në veçanti nëpërmjet punës në klubet e natës dhe në industrinë e argëtimit në Shqipëri si një rrezik parësor për trafikimin e vajzave, ndërsa trafikimi për qëllime të lypjes së detyruar dhe veprimtari kriminale është një rrezik parësor për trafikimin e djemve. Ndonëse në këtë trafikim shpesh përfshihen edhe palë të treta, në studim janë identifikuar disa raste ku trafikimi lehtësohet apo tolerohet nga vetë prindërit e fëmijës.

Nga 39 raste të identifikuar si fëmijëve viktimë të mundshme trafikimi, vetëm një prej tyre u identifikua formalisht dhe në mënyrë përfundimtare si trafikimi i fëmijëve. Më tej, në 11 raste shfrytëzimi vijoi edhe pas identifikimit të fëmijës si viktimë e mundshme e trafikimit. Nga këto 11 raste, tetë ishin raste të vajzave që shfrytëzoheshin seksualisht, pra, u lanë në duart e trafikantëve pavarësisht nga rreziqet e identifikuar.

Pamundësia për të arritur në një përfundim të saktë në lidhje me numrin e rasteve apo përhapjen që ka fenomeni i trafikimit të fëmijëve është një fakt global. Shkaqet janë disa, ndër më shpesh të përmendura janë natyra e fshehtë e krimit të trafikimit, tendencat vazhdimisht të ndryshme të fenomenit për shkak të strategjive të ndryshme që ndjekin trafikantët, format e reja të shfrytëzimit, nevoja për rritje të vazhdueshme të kapaciteteve të institucioneve që kanë në fokus masat anti-trafikim, mungesa e mbledhjes së të dhënave në mënyrë sistematike nga të gjitha institucione që mund të jenë në kontakt me një viktimë të mundshme dhe viktimë trafikimi.

Në një analizë të të dhënave zyrtare¹⁵ vihen re dy grupime kryesore fëmijësh të trafikuar në Shqipëri: 1) vajza adoleshente të trafikuar brenda dhe jashtë Shqipërisë për qëllim shfrytëzimi seksual, dhe; 2) djem dhe vajza të moshës së mitur të shfrytëzuar për lypje të detyruar brenda Shqipërisë. Ndonëse ka të dhëna të besueshme për ekzistencën e formave të tjera të shfrytëzimit të fëmijëve, si shfrytëzimi për shpërndarje substancash narkotike, shfrytëzimi për vjedhje dhe punësim i parregullt, ky informacion është i paplotë dhe i pamjaftueshëm për të analizuar metodat e rekrutimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve për këto forma të reja shfrytëzimi.

Sipas Raportit Vjetor të Ministrisë së Brendshme për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018-2020¹⁶, gjatë vitit 2018 në Shqipëri janë evidentuar 95 viktima dhe viktima të mundshme trafikimi, nga të cilët 67 janë fëmijë. Të dhënat zyrtare tregojnë se format më të përhapura të shfrytëzimit janë shfrytëzimi seksual dhe ai për lypje të detyruar. Në raportet ndërkombëtare për situatën e trafikimit, Shqipëria konsiderohet “një vend burimi, tranziti dhe destinacioni për burrat, gratë dhe fëmijët subjekt i trafikimit për qëllime seksuale dhe

¹⁴ Tipologji e Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri, 2020, Prezenca e OSBEse në Shqipëri. A. McQuade, J. Rexha, A. Trimi. <https://www.osce.org/files/f/documents/f/e/457549.pdf>

¹⁵ <https://mb.gov.al/raporte-mbi-zbatimin-e-strategjive-dhe-planeve-kombetare-te-veprimit/>

¹⁶ [https://mb.gov.al/raporte-mbi-zbatimin-e-strategjive-dhe-planeve-kombetare-te-veprimit/faqe-4.\[faqja-e-parë-në-tetor-2019\].](https://mb.gov.al/raporte-mbi-zbatimin-e-strategjive-dhe-planeve-kombetare-te-veprimit/faqe-4.[faqja-e-parë-në-tetor-2019].)

punë të detyruar”¹⁷. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) dhe Raporti për Punën e Fëmijëve i Qeverisë së SHBASë shprehen se “Qeveria nuk i ka përmbushur standardet minimale për eliminimin e trafikimit” dhe “ka avancuar pak në drejtim të eliminimit të formave më të këqija të punës së fëmijëve”.¹⁸

Arsyet përse fëmijët shqiptarë trafikohen janë të ndryshme, duke nisur nga faktorë madhorë makro-ekonomikë e socialë, deri në dinamika dhe rrethana krejtësisht personale. Elementët kulturorë të grupeve apo komuniteteve të caktuara luajnë gjithashtu rol për të përcaktuar kushtet e jetesës së fëmijëve dhe rrjedhimisht shfrytëzimin apo trafikimin e tyre. Liberalizimi i lëvizjes së lirë ka krijuar gjithashtu një dëshirë për të emigruar drejt vendeve që ofrojnë mundësi më të mëdha punësimi, por njëkohësisht ka rritur dhe vulnerabilitetin ndaj migrimit jo të sigurt i cili ndonjëherë përfundon në trafikimin e fëmijës. Rrethana të ndryshme në vendet e destinacionit përbëjnë dhe faktorë tërheqës për aktivitete të lidhura me trafikimin, siç mund të jenë kërkesa e lartë për krah të lirë pune, mungesa e rregullimit të sektorëve të caktuar të punësimit dhe kërkesa për shërbime seksuale në sektorin e turizmit¹⁹. Sipas raportit të vitit 2016 të Komisionit Europian për situatën e trafikimit në Bashkimin Europian (BE), Shqipëria renditet ndër 5 vendet e para, jo anëtare të BE-së, për numrin e viktimave të trafikimit në BE²⁰.

Një fenomen shqetësues në Shqipëri është bërë tashmë trafikimi i brendshëm siç vihet re dhe nga të dhënat e raporteve zyrtare ku fëmijët e shfrytëzuar për lypje apo për punë të tjera të lidhura me situatën e rrugës, përbëjnë numrin më të lartë të rasteve të identifikuar. Ndërsa është e vështirë të përlogaritet përmasa e trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve në Shqipëri për shkak të mungesës së të dhënave sistematike, të sakta dhe të krahasueshme, vështirësia e dallimit të qartë midis shfrytëzimit dhe trafikimit krijon vështirësi si përsa i përket mbledhjes së të dhënave dhe raportimit dhe menaxhimit të rasteve.

Në Planin Kombëtar të Veprimit për mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik²¹, paraqitet një pasqyrë e rasteve të fëmijëve në situatë rruge të identifikuar në periudhën 2018-2016, ku 1,108 raste janë fëmijët në situatë lypjeje.

1.4 LEGJISLACIONI PËR TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

1.4.1 LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR

Përkufizimi i pranuar gjerësisht për trafikimin e qenieve njerëzore është marrë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar 2000 dhe Protokollit Shtesë “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në veçanti të grave dhe fëmijëve”, i njohur si Protokollit i Palermos. Shqipëria e ka nënshkruar Konventën e Kombeve të Bashkuara dhe Protokollin Shtesë të saj, dhe janë ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 21 gusht 2002. Përkufizimi i trafikimit shtjellohet në nenin 3 të Protokollit të Palermos. Teksti në përkthimin

¹⁷ https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/TIP_ENG.pdf, faqe 69.

¹⁸ US Department of Labor's, 2017 Findings on the worst forms of Child Labor, faqe 83.

¹⁹ https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/Toolkit-files/08-58296_tool_9-2.pdf

²⁰ http://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/organized-crime-and-human-trafficking/trafficking-in-human-beings/docs/commission_report_on_the_progress_made_in_the_fight_against_trafficking_in_human_beings_2016_en.pdf

²¹ Vendim Nr. 704, datë 21.10.2019 i Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, botuar në Fletoren Zyrtare: <https://qbz.gov.al/previeje/83c9b61a-eadc-40c6-8f99-4d61ca169b3d>

zyrtar përdor fjalën “trafik” personash që është termi i gabuar. Për këtë arsye, në këtë manual do të përdoret termi “trafikim” dhe kur i referohet drejtpërsëdrejti Protokollit të Palermos.

-
- (a) “Trafikim personash” nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitudet.
- (b) Pëlqimi i viktimës së trafikimit për shfrytëzimin e qëllimshëm të përmendur në nënparagrafin (a) të këtij neni do të jetë i pavend nëse janë përdorur mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a).
- (c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet “trafikim personash” edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni.
- (d) “Fëmijë” nënkupton çdo person nën 18 vjeç.
-

Një tjetër dokument ligjor me po aq rëndësi për Shqipërinë është Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005, të cilën Shqipëria e ratifikoi më 6 shkurt 2007 dhe hyri në fuqi më 1 shkurt 2008.

Konventa është një traktat gjithëpërfshirës dhe fokusohet kryesisht në mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre me qëllimin e identifikuar në mënyrë specifike te Neni 1 si:

-
- a) parandalimi dhe lufta e trafikimit të qenieve njerëzore, duke garantuar barazinë gjinore;
- b) mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit, ndërtimi i një kuadri gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, duke garantuar barazinë gjinore, si dhe duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive;
- c) nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
-

Kjo Konventë zbatohet për ‘të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, qoftë kombëtare ose transnacionale, të lidhura apo jo me krimin e organizuar.’ - Neni 2.

Përkufizimi për trafikimin e qenieve njerëzore që jepet te Neni 4 i Konventës është i njëjtë me atë të Protokollit të Palermos por ligji jep gjithashtu udhëzime të qarta në lidhje me masat për parandalimin e trafikimit si dhe ndjekjen penale të trafikantëve.

Neni 3 i Konventës përcakton shumë qartë përgjegjësinë e Shtetit Palë për pasjen e masave për të mbrojtur dhe nxitur të drejtat e viktimave, duke garantuar barazi gjinore.

Ka një theks të veçantë te masat për pengimin dhe dekurajimin e kërkesës, një fokus te masat dhe siguria në kufi dhe kontrolli i dokumenteve, për shembull.

Është e rëndësishme të theksohet se Konventa zbatohet për të gjitha format e trafikimit:

- kombëtar dhe ndërkombëtar
 - i lidhur apo jo me krimin e organizuar
 - pavarësisht se cilat janë viktimat, gra, burra apo fëmijë
 - pavarësisht se cila është forma e shfrytëzimit: shfrytëzim seksual, punë apo shërbime të detyruara, etj.
-

Konventa parashikon ngritjen e një mekanizmi të pavarur monitorimi (“GRETA”) për të garantuar respektimin nga ana e Palëve të dispozitave të saj. GRETA ka realizuar tri raunde vlerësimesh për Shqipërinë, i fundit vlerësimin e saj të tretë për Shqipërinë në korrik 2020.

PUNA E DETYRUAR

Termi “trafikim i qenieve njerëzore” mund të sugjerojë lëvizje. Megjithatë, në këtë rast nuk është e domosdoshme asnjë lëvizje. Ai është një krim që mund të kryhet edhe kundër një individi që nuk është larguar asnjëherë nga qyteti i lindjes. Individët mund të konsiderohen si viktimat e trafikimit pavarësisht nga fakti nëse kanë lindur në një situatë servitudi, janë transportuar në një situatë shfrytëzimi, kanë dhënë më parë pëlqimin për të punuar për një trafikant, apo ka marrë pjesë në një krim si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e të qenit objekt i trafikimit të qenieve njerëzore. Viktimat e trafikimit përfshijnë gra, burra, dhe individë transjinorë; të rritur dhe fëmijë; nënshtetas apo jo.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) e përkufizon ‘Punën e detyruar’ si:

“Të gjitha punët apo shërbimet që kryhen nga një person nën kërcënimin e një ndëshkimi dhe për të cilin personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht”, dhe ka të bëjë me tri elemente:

1. Punë apo shërbime u referohet të gjitha llojeve të punës që zhvillohen në një veprimtari, industri ose sektor përfshirë në ekonominë informale.
 2. Kërcënimi për ndonjë ndëshkim i referohet një game të gjerë ndëshkimesh që përdoren për ta detyruar dikë të punojë.
 3. Pa dëshirë: termit “ofruar vullnetarisht” u referohen pëlqimit të dhënë në mënyrë të lirë dhe të informuar nga ana e një punëtori për të marrë një punë dhe liria e tij ose saj për t’u larguar në çdo kohë. Nuk është ky rasti, për shembull, kur një punëdhënës apo rekrutues bën premtime të rreme në mënyrë që punëtori ta pranojë një punë që ai ose ajo përndryshe nuk do ta kishte pranuar.
-

1.4.2 LEGJISLACIONI SHQIPTAR MBI TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë përfshin veprat penale të trafikimit në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare e ratifikuar²².

Ndërsa Kodi Penal ka pësuar disa ndryshime të dispozitave që trajtojnë veprat penale të trafikimit²³ përkufizimi i trafikimit të qenieve njerëzore është transpozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përkufizimi i Protokollit të Palermos dhe Konventës së Këshillit të Evropës.

Kodi penal i Republikës së Shqipërisë parashikon si forma të trafikimit të qenieve njerëzore atë të emigrantëve, femrave për prostitucion dhe si formë më vete atë të trafikimit të të miturve.

Neni 110/a "Trafikimi i personave" parashikon:

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

Nenet 110/b dhe 110/c penalizojnë përfitimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar si dhe veprimet që lehtësojnë trafikimin.

Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo veprë kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

²² Detyrim që rrjedh nga neni 5 i Protokollit shtesë mbi Trafikimin, pjesë e Konventës së OKB.

²³ Neni 110/a, Trafikimi i personave të rritur (Shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; ndryshuar titulli, fjalët në paragrafin e parë dhe paragrafi i tretë dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013)

Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

Trafikimi kryhet me qëllim shfrytëzimin për prostitucion, punë të detyruar, shërbime të tjera të detyruara, për transplantim të organeve.

Shfrytëzimi i viktimës së trafikimit kryhet në çdo rast kundër vullnetit dhe dëshirës së viktimës, dhe i detyruar nga subjekti i veprës penale, shfrytëzohet, në një nga format e përmendura më lart²⁴.

Ndikimi që ushtron subjekti i veprës penale tek i dëmtuari realizohet me anë të kërcënimit, ose me anë të përdorimit të forcës, ose me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose me anë të rrëmbimit, me anë të mashtrimit, me anë të shpërdorimit të detyrës ose duke përfutuar nga gjendja shoqërore apo fizike ose psikike e të dëmtuarës etj.²⁵

Gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprës penale, çdo fitim i nxjerrë nga ana e të dëmtuarit si pasojë e shfrytëzimit të tij, përfitohet, si rregull, nga ana e subjektit të veprës penale. Të dëmtuarit, gjatë kohës së kryerjes së kësaj vepre penale nga ana e subjektit, i është hequr në mënyrë të plotë liria, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ai shndërrohet në një vegël të bindur të subjektit të veprës penale, duke mos pasur fare rëndësi që të kryejë veprime sipas vullnetit të tij, dhe kjo përbën dhe një nga dallimet bazë, ndërmjet veprës penale të "Trafikimit të personave" dhe me veprat të "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve",²⁶ apo kontrabandimi siç quhet në të drejtën ndërkombëtare.

Në mënyrë që vepra të konsiderohet e kryer, nga ana e subjektit, mjafton që ai ta ketë pasur qëllimin për të kryer atë, qoftë dhe vetëm me anë të një prej formave të shfrytëzimit, të parashikuara nga dispozita, pra qoftë edhe me anë të shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, ose qoftë edhe vetëm me anë të shfrytëzimit të punës ose shërbimeve të detyruara, ose qoftë edhe vetëm me anë të skllavërimit të personit ose formave të ngjashme me të, ose qoftë edhe vetëm me vënien në përdorim ose transplantimin e organeve, ose me çdo shfrytëzim tjetër.

Në qoftë se subjekti e ka pasur si qëllim për të kryer veprën, në dy ose më shumë prej formave të parashikuara më lart, pra, e ka pasur si qëllim për ta kryer edhe për shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, edhe me anë të shfrytëzimit të punës së detyruar, edhe me anë të vënies në gjendje skllavërie të personit, etj subjekti, nuk do të përgjigjet, aq herë, në sa forma ka pasur si qëllim për të kryer veprën, por vetëm një herë të vetme, ndërsa fakti që ai ka pasur si qëllim për ta kryer veprën, në disa forma tregon për rrezikshmërinë e lartë të tij, dhe ky fakt duhet të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit.

Për kuptimin e drejtë të veprës penale të "Trafikimit të personave", në mënyrë që kjo vepër të

²⁴ Forma të cilat janë të parashikuara në mënyrë të shprehur nga neni 110/a i K.Penal.

²⁵ OSBE, "Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore; të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal, kapitull I punuar nga Z. Sandër Simoni, Kryetar i Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar." <https://www.osce.org/files/f/documents/8/c/373348.pdf>

²⁶ Në Protokollin e Palermos kjo vepër penale njihet si emigracioni ilegal ose kontrabandimi i emigrantëve.

konsiderohet si plotësisht e kryer, elementi i tretë i saj, qëllimi për shfrytëzim prostitucioni, ose për çdo qëllim tjetër të kundërligjshëm të të dëmtuarit, nuk është e domosdoshme që të realizohet nga subjekti i veprës penale, por, mjafton që të provohet qëllimi i subjektit për të shfrytëzuar në mënyrë të kundërligjshme personin e dëmtuar.

1.4.3 TRAFIKIMI I TË MITURVE

Neni 128/b “Trafikimi i të miturve”

Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë

Ligji njih që trafikimi është një proces kompleks i cili përfshin faza të ndryshme, ku ndërthuren një sërë veprimesh të lidhura me njëra tjetrën si një veprim i vetëm i kryer vetëm një herë.

Figura 1. Procesi i Trafikimit të personave të rritur




Figura 2. Procesi i trafikimit të fëmijëve



Në rastin e trafikimit të të rriturve, vepra penale është një proces që përmban tri elementë që janë veprimet, mjetet dhe qëllimi.

VEPRIMI: “REKRUTIMI, TRANSPORTIMI, TRANSFERIMI, FSHEHJA OSE PRITJA E PERSONAVE”;

Mjetet e përdorura: “kërcënimi ose përdorimi i forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënia apo marrja e pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër”;

Qëllimi për të shfrytëzuar personin, i cili përfshin minimalisht, “shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit”.

Ndryshimi mes “trafikimi i personave të rritur” dhe “trafikimi i fëmijëve” është se trafikimi i fëmijëve përmban vetëm elementët e veprimit dhe qëllimit. Përdorimi i mjeteve për të trafikuar një fëmijë, nuk është i nevojshëm që situata e fëmijës të konsiderohet trafikim, për shkak se fëmija nuk ka arritur zotësinë për të vepruar dhe për të zgjedhur punën që do të kryejë. Një vajzë nën 18 vjeç, e cila rekrutohet për të ushtruar prostitucion, duke u lëvizur nga një vend në tjetër, pavarësisht nëse ndaj saj është ushtruar forcë apo shtrëngim, konsiderohet si e trafikuar.

Zhvendosja me qëllim shfrytëzimin mund të ndodhë brenda për brenda territorit të një shteti - në këtë rast përdoret rëndom togfjalëshi “trafikim i brendshëm” apo duke kaluar kufij mes shtetesh - në këtë rast përdoret rëndom togfjalëshi “trafikim i jashtëm” ose “trafikim me kalim kufijsh”. Trajtimi i “trafikimit të brendshëm” pa dallim nga “trafikimi i jashtëm” është një prej objekteve kryesore të Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Personave. Hartuesit e Konventës qëllimisht theksuan se trafikimi ndodh si brenda dhe jashtë kufijve, i lidhur ose jo me krimin e organizuar. Pas ratifikimit të Konventës së Këshillit të Evropës dhe rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë për rishikimin e dispozitës së trafikimit në Kodin Penal, në vitin 2013 u bënë ndryshime në dispozitën për “Trafikimin e personave të rritur”, duke parashikuar se trafikimi ndodh si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky ndryshim nuk u përfshi në Nenin 128/b të Kodit Penal “Trafikimi i të rriturve”.

Pavarësisht kësaj mungese të shprehjes së drejtpërdrejtë për trafikimin e brendshëm në nenin e posaçëm të trafikimit të fëmijëve, duke qenë se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj²⁷, praktika gjyqësore në Shqipëri duhet rrjedhimisht t’i referohet Konventës dhe të konsiderojë lëvizjet brenda vendit në rastet e fëmijëve.

Qëllimi i rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes ose pritjes së një fëmije në trafikim është shfrytëzimi i tij apo i saj. Sipas fjalorit të Oxford, “shfrytëzim” është përdorimi i diçkaje ose dikujt (padrejtësisht) për përfitim personal, duke përfituar nga personi apo situata, veçanërisht në mënyrë joetike ose të padrejtë apo duke trajtuar të tjerët në mënyrë të padrejtë për të fituar një përparësi apo të mirë. Përfitimi nuk është domosdoshmërisht financiar, mund të jetë çdo lloj

²⁷ Sipas Nenit 122 të Kushtetutës së Shqipërisë, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të

përfitimi. Shfrytëzimi i fëmijës është abuzimi i fëmijës që përfshin një lloj shpërblimi apo përfitim nga ana e autorit të krimit. Përfitimi mund të jetë financiar, shoqëror, politik, etj. Shfrytëzimi përbën një formë detyrimi dhe dhune, me pasoja në shëndetin fizik dhe mendor të fëmijës, në zhvillimin dhe shkollimin e tij.

Përkufizimi i ndërkombëtar i trafikimit, i pasqyruar në legjislacionin tonë të brendshëm, përmban një listë joshteruese të formave të shfrytëzimit të fëmijës së trafikuar. Në përkufizim përmenden shfrytëzimi i prostitucionit dhe forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shfrytëzimi i punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimi ose forma të ngjashme me skllavërimin, vënia në përdorim ose transplantimi i organeve.

1.4.4 ELEMENTËT E VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Vepra penale e trafikimit konsiderohet e kryer përmes ndërthurjes së tri elementeve përbërës dhe përmes komponentëve të veçuar, ndonëse në disa raste këto elemente të veçuara do të përbëjnë vepra penale në mënyrë të pavarur nga të tjerët, p.sh. marrja me forcë, rrëmbimi, përdhunimi, mashtrimi, etj. sipas përkufizimeve të legjislacionit kombëtar.

Të tre elementët e trafikimit mund të shfaqen në faza të ndryshme: për shembull, rekrutimi i viktimës, zhvendosja brenda ose jashtë vendit dhe në fund shfrytëzimi.

Secili prej tre elementeve të trafikimit duhet të provohet që të konsiderohet e kryer vepra penale e trafikimit të personave të rritur.

Në rastin e trafikimit të fëmijëve, nuk është e nevojshme të provohen mjetet e përdorura nga subjekti i veprës penale për të realizuar qëllimin e shfrytëzimit.

Trafikimi është një kombinim i këtyre elementeve dhe jo secili prej tyre i marrë veçmas. Për shembull pritja e një personi (veprimi) nëpërmjet përdorimit të formës (mjeti) për shfrytëzim seksual (qëllimi) përbën veprën penale të trafikimit të personave të rritur.

-
- Veprimi - rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja apo pritja personave
 - Mjetet - forca, mashtrimi, shtrëngimi, mashtrimi
 - Qëllimi – shfrytëzimi i personit
-

Për të provuar trafikimin e qenieve njerëzore sipas të drejtës ndërkombëtare nuk janë të domosdoshëm të gjithë elementet në secilën listë. Kur dyshohet apo konfirmohet që ka të paktën një prej secilës listë dhe qëllimi është shfrytëzimi, atëherë rrethanat që shqyrtohen përbëjnë trafikim të qenieve njerëzore.

VEPRIMI

Rekrutimi

Rekrutimi si element I anës objektive ka të bëjë me veprimet që subjekti kryen për identifikimin dhe gjetjen personave tek të cilët përdor një nga mënyrat si forca, mashtrimi, përfitimi nga gjendja shoqërore, shpërdorimi I detyrës etj me qëllim shfrytëzimin e tyre.

Transportimi

Transportimi i personit do të nënkuptojë zhvendosjen e tij nga një vend në vendin tjetër qoftë dhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj. Në mënyrë që vepra penale të konsiderohet si e tillë me transportimin e personit, nuk do të merret parasysh mjeti me të cilën është transportuar, por çënimi I vullnetit të viktimës për kryerjen e zhvendosjes.²⁸ Duhet pasur parasysh që transportimi I personave psh në vendet e BE mund të bëhet në mënyrë të ligjshme, për shkak të lehtësisë të lëvizjes prej vitit 2010 me liberalizimin e vizave e lëvizjes brenda zonës së Schengen. Lëvizja nga një shtet në tjetrin në mënyrë të ligjshme, por me qëllimin për shfrytëzimin e tij do të konsiderohet si trafikim I personit.

Një person mund të jetë viktimë e trafikimit dhe nëse ka kaluar kufirin në mënyrë të rregullt dhe qëndrimi i tij në një territor nacional është i ligjshëm.

Transferimi

Transferimi në kontekstin e trafikimit të qenieve njerëzore duhet kuptuar si transferimi transferimit të kontrollit nga një person në tjetrin.

Pritja

Pritja përfshin mbajtjen e një personi në një vend para ose gjatë fazës së shfrytëzimit. Pra, këtu përfshihet strehimi I viktimës në vendin e shfrytëzimit, për shembull në një hotel apo banesë me qëllim shfrytëzimin seksual; strehimi I dikujt në një banesë private ku shfrytëzohet si punëtor/e shtëpie; strehimi I burrave, grave, fëmijëve në magazine apo ambiente të përshtatura si fjetore pranë fabrikave ose fushave ku janë të punësuar në punë të detyruar; strehimi i personave në çdo mënyrë gjatë udhëtimit të tyre drejt vendit ku do të kryhet heqja e paligjshme e organeve.

Në mënyrë që vepra penale të konsiderohet si plotësisht e kryer nga ana e autorit të saj, mjafton që prej tij të kryhet edhe vetëm në një nga format e mësipërme të realizimit të veprës penale, kuptohet, kur ekzistojmë edhe dy elementët e tjerë të anës objektive, të cilët do të trajtohen më poshtë. Kjo do të thotë, se kur plotësohen edhe dy elementët e tjerë të anës objektive të kësaj vepre penale, subjekti do të konsiderohet se e ka kryer në mënyrë të plotë këtë vepër penale, në rastet kur ai ka bërë vetëm rekrutimin e personit, ose vetëm transportimin e personit, ose vetëm transferimin e personit, ose vetëm fshehjen e personit, ose vetëm pritjen e personit, me anë të mashtrimit apo kërcënimit apo përfitimit nga gjendja shoqërore e tij, etj. dhe me qëllim trafikimit e tij, pavarësisht se nuk e ka trafikuar këtë person, si dhe pavarësisht se nuk e ka shfrytëzuar këtë person²⁹.

28 Shih gjithashtu: OSBE, "Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore; të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal, kapitull I punuar nga Z. Sandër Simoni, Kryetar i Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: " <https://www.osce.org/files/f/documents/8/c/373348.pdf>

29 Id. Shih gjithashtu: OSBE, "Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore; të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal, kapitull I punuar nga Z. Sandër Simoni, Kryetar i Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: " <https://www.osce.org/files/f/documents/8/c/373348.pdf>

Rast praktik: Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në lidhje me veprën penale të trafikimit, arsyeton: "...Gjykata çmon me këtë rast të sqarojë se, vepra penale e "Trafikimit të femrave", e parashikuar nga neni 114/b i Kodit Penal, është vepër penale formale, do me thënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje kriminale, në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kjo vepër, që të konsiderohet e konsumuar, mjafton që të provohet të gjithë elementët e saj, që kanë të bëjnë me objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive dhe nuk kërkon ardhjen e asnjë lloj pasoje...".³⁰

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, me vendimin e saj nr.47, datë 23.10.2007, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera ka arsyetuar: "...Figura e veprës penale të trafikimit të femrave, konsiderohet e formuar edhe me ekzistencën e njërit nga elementët e saj, kur bëhet në format dhe qëllimet e sipërcituara të kësaj dispozite. Pra, do të mjaftonte edhe vetëm elementi i rekrutimit apo i transportimit etj., nëpërmjet formave dhe qëllimeve të lartpërmendura, që i pandehuri të ketë përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Fakti, që i pandehuri nuk ia arriti qëllimit që t'a shfrytëzojë të dëmtuarën për prostitutë, nuk bën që ai të mos përgjigjet penalisht, pasi ai i ka konsumuar të gjithë elementët e kësaj figure vepre penale...".³¹

Sipas legjislacionit penal shqiptar, nuk është kusht i domosdoshëm ekzistenca e shfrytëzimit, por shfrytëzimi mund të shoqërojë apo pasojë trafikimin ose mund të përbëjë trafikimin në vetvete.

MJETET

Elementi I dytë i trafikimit të qenieve njerëzore është përdorimi i një ose më shumë prej mjeteve. Rëndësia e tyre varet nga rrethanat objektive dhe subjektive të viktimës si dhe veprimet konkrete të trafikantëve.

Kërcënimi që i bëhet personit, me qëllim trafikimin e tij nënkupton dhunën psikike ose kanosjen që i bëhet personit.

Përdorimi i forcës i referohet përdorimit të dhunës fizike që subjekti i veprës penale ushtron ndaj të dëmtuarit. Dhuna fizike, nënkupton dëmtime dhe lëndime fizike, që i bëhen personit si: rrahje, goditje me sende të ndryshme, shtyrje, rrëzim përtokë, deri tek plagosja e lehtë, që i bëhen të dëmtuarit me qëllim trafikimin e tij.

Forma të tjera të shtrëngimit përfshijnë të gjitha ato veprime, të cilat ndikojnë në mënyrë thelbësore në vullnetin e të dëmtuarit, duke i hequr atij plotësisht lirinë që të disponojë për veten e tij, të cilat janë të ndryshme nga dhuna fizike apo psikike. Si veprime të tilla, mund të përmendim për shembull: lënien e të dëmtuarit pa ushqim, ose mospajtim për të dëmtuarin i kushteve minimale të jetesës, higjeno-sanitare ose të fjetjes etj. I referohen gjithashtu marrëdhënies së viktimës me njerëz të tjerë; kërcënime se do të përjashtohet nga grupi/famija; shfaqje zemërimi apo pakënaqësie nga personi që viktimë konsideron si partner; shantazhe.

Rrëmbimi është vetëshpjegues dhe një nga mjetet më brutale të procesit të trafikimit.

Mashtrimi i referohet natyrës së shërbimeve që do të kryejë viktimë si dhe kushteve nëpërmjet të

³⁰ Vendimin nr.31, datë 14.06.2007, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M www.gjkr.gov.al

³¹ Vendimin nr.47, datë 23.10.2007, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ndaj të pandehurit E.M.

cilave detyrohet t'i kryejë këto shërbime. Për shembull, një personi l premtohet se do të kryejë një punë të caktuar por në fakt detyrohet të ushtrojë prostitucion; - personi pret të punojë si prostitutë dhe t'i marrë vetë fitimet nga puna, por në fakt detyrohet t'ia japë fitimin trafikantit; - personit l premtohet mundësia e një pune të rregullt në kushte të rregullta ligjore, por në fakt nuk paguhet dhe detyrohet të punojë në kushte të vështira, l merren dokumentet e udhëtimit dhe të identitetit dhe nuk l lihet asnjë rrugëzgjdhje përveçse të pranojë punën.

Shpërdorimi i detyrës kur në veprimet e subjektit të veprës penale, ekzistojnë të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal³². i vetmi dallim që ekziston në këtë rast, është fakti se subjekti, veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e kryen me qëllim trafikimin e të të dëmtuarit.

Përfitimi nga gjendja shoqërore e viktimës është një nga mjetet më të përhapura në procesin e trafikimit. Mjeti l përfitimit nga gjendja e viktimës ose siç njihet ndryshe “përfitimi nga pozita vulnerabël” e viktimës po bëhet gjithnjë e më e përhapur. Oficerët e policisë duhet të jenë tepër vigjilentë ndaj përdorimit të këtij mjeti jo domosdoshmërisht lehtësisht të kuptueshëm.

Viktima e gjendur në një situatë të tillë **nuk ka asnjë alternativë tjetër përveçse t'i nënshtrohet abuzimit**. Ligjvënësi e ka shtjelluar duke e përcaktuar gjendjen shoqërore, fizike apo psikike, por mund të jetë dhe emocionale, familjare, ekonomike dhe madje e lidhur me traditën apo kulturën e familjes apo etnisë së viktimës. Situata mund t'i referohet dhe statusit të parregullt të një viktime të huaj, varësisë ekonomike ndaj trafikantit, problemeve shëndetësore apo rrethane tjetër vështirësie që e detyron të pranojë shfrytëzimin.

Vendimi nr. 72 datë 23.10.2008 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, www.gjkr.gov.al.

Në një rast në gjykim në Gjykatën e Krimeve të Rënda, e mitura ishte dhënë për shfrytëzim seksual për një periudhë të caktuar në Greqi me qëllim të shlyerjes së një borxhi që e ëma e saj ia kishte marrë trafikantit e nuk kishte mundur t'ia shlyente.

Shembull nga praktika e referuar nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës

E XH, një djalë 15 vjeçar nga Durrësi jeton me babanë me aftësi të kufizuar në kushte tejet të vështira ekonomike. E ëma e braktisi vite më parë dhe ai nuk ka kontaktuar me të asnjëherë.

E XH paraqet çrregullime mendore dhe në sjellje. Ai ka qenë në situatë rruge për katër vjet, duke lypur, duke shitur drogë, duke vjedhur dhe me raste ka punuar në lavazhe makinash.

Pas vlerësimit të tij, ku u përfshi edhe një vlerësim i shëndetit mendor, ai u vendos në shtëpinë e fëmijëve në Shkodër e më pas në një strehëz në Elbasan, nga ku u arratis. Tani djali jeton në Durrës me të atin dhe rasti i tij monitorohet nga një Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës.

Përfitimi nga gjendja fizike apo psikike e të dëmtuarit, ku me gjendje të rëndë fizike, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari është i dëmtuar rëndë fizikisht, p.sh: paraplegjik. Me gjendje të rëndë psikike

³² Neni 248 i Kodit Penal përcakton: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyshje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë”.

të të dëmtuarit, do të kuptojmë rastet kur i dëmtuari ka zhvillim të vonuar mendor ose vuan nga sëmundje mendore, të cilat e bëjnë të paaftë për të kuptuar plotësisht veprimet që kryhen në dëm të tij dhe pasojat që vijnë prej tyre.

Shembull nga praktika e referuar nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës

“M” është një vajzë 14 vjeçare nga Tirana, e cila u identifikua në një fshat në jug të Shqipërisë. Ajo jetonte me një djalë më të rritur se vetja, kishte probleme të shëndetit mendor dhe varësi nga alkooli. Pas intervistës fillestare, vajza u identifikua si viktimë e mundshme e trafikimit. Megjithatë ajo paraqiste tregues të fortë trafikimit, përfshirë dyshime për shfrytëzim prostitucioni - punë e fshehtë si balerinë, lëvizje nga Tirana drejt fshatit dhe përdorimi i dhunës nga partneri - ajo nuk u identifikua formalisht si viktimë e trafikimit. Vajza u referua në një strehëz për viktimat e trafikimit, por nuk pranoi të shkonte në qendër dhe u largua nga banesa bashkë me të motrën.

Dhënia e pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër i referohet situatave kur subjekti i veprës penale, jep një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij. Në një rast viktimë ishte dhënë për shfrytëzim kundrejt një pagese prej 4,000 Euro që autori mori si kundravleftë.

Marrja e pagesave ose të përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, kur subjekti i veprës penale, merr një shumë të caktuar parash ose një përfitim tjetër tek një person tjetër, me qëllim që ky i fundit, të marrë pëlqimin e personit që ai kontrollon, me qëllim trafikimin e tij.

QËLLIMI

Qëllimi i trafikantit për ta shfrytëzuar viktimën është arsyeja përse ndodh trafikimi dhe është pikërisht ky qëllim që përcakton veprën e trafikimit. Dispozita e trafikimit në Kodin Penal përmban një listë jo-shteruese të formave të shfrytëzimit, për shkak se format dhe tendencat e shfrytëzimit mund të ndryshojnë në kohë.

KUJDES!

Ky element i veprës penale kërkon të provohet qëllimi i subjektit të veprës penale për ta shfrytëzuar viktimën. Nuk është e domosdoshme që të realizohet shfrytëzimi i viktimës, nëse provohet qëllimi i subjektit për ta shfrytëzuar atë.

Lista e përgjithshme e formave të shfrytëzimit përfshin minimalisht:

- Shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual
- Punën ose shërbimet e detyruara
- Skllavërimin ose format e ngjashme me skllavërimin
- Vënien në përdorim ose transplantimin e organeve
- Forma të tjera të shfrytëzimit

Duhet theksuar se ligji ynë penal penalizon gjithashtu:

- Përfitimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar (Neni 110/b)
 - Veprimet që lehtësojnë trafikimin (neni 110/c)
-

Në mënyrë që vepra e “Trafikimit të personave” të konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë nga ana e subjektit të veprës penale, mjafton të provohet se ai ka përdorur, qoftë edhe një nga format e mësipërme për të realizuar trafikimin e personit. Pra, vepra penale, do të konsiderohet plotësisht e kryer, në qoftë se subjekti, rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e persoanve, e ka bërë qoftë edhe vetëm me anë të kërcënimit ose qoftë edhe vetëm me anë të përdorimit të forcës ose qoftë edhe vetëm me anë të formave të tjera të shtrëngimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të rrëmbimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të mashtrimit, ose qoftë edhe vetëm me anë të shpërdorimit të detyrës, ose qoftë edhe vetëm me anë të përfitimit nga gjëndja shoqërore, psikike apo fizike, ose qoftë edhe vetëm me anë të marrjes ose dhënies së pagesave për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.

TRAFIKIMI I BRENDSHËM NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË³³

Veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, e realizuar kjo nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës, etj.

Dallimi ndërmjet trafikimit të personave të rritur dhe shfrytëzimit të prostitucionit

Shfrytëzimi i prostitucionit nënkupton shtyrjen e personit, me anë të këshillave, bisedave, udhëzimeve, premtimeve apo mashtrimeve për të ushtruar prostitucion. Ndërmjetësimi, realizohet nga persona të ndryshëm, të cilët luajnë rolin e ndërmjetësit midis të dëmtuarit dhe klientit të tij ose marrjes së shpërblimit: nga i dëmtuari ose person tjetër.

Dallimi kryesor mes shfrytëzimit të prostitucionit/neni 114 dhe trafikimit të personave të rritur/neni 110/a kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/të qenit i përgjegjshëm dhe vullneti i lirë për të ushtruar prostitucion.

Dallimi, ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 dhe nenit 128/b të Kodit Penal, qëndron në faktin se mënyrat/format e realizimit të këtyre dy veprave penale janë të ndryshme (neni 114 parashikon se një person shtyn, ndërmjetëson apo merr shpërblim për shfrytëzimin e një fëmije/të mituri për prostitucion). Në rastin e trafikimit të të miturve, qëllimi i shfrytëzimit është më i gjerë sesa shfrytëzimi vetëm për prostitucion.

Në çdo rast kur viktimë është e mitur – pëlqimi që jep i mituri për të ushtruar prostitucion nuk merret në konsideratë/nuk ka vlerë, pavarësisht faktit, nëse është cënuar ose jo vullneti, për shkak të gjendjes vulnerabël ose rrethana të tjera. Konventa e Këshillit të Evropës parashikon: “... Trafikimi i fëmijëve, për çfarëdo lloj forme shfrytëzimi, do të konsiderohet trafikim edhe nëse nuk përdoren mjetet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, pavarësisht vullnetit të fëmijës”.

³³ OSBE, “Komentari i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore; të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal, kapitulli I punuar nga Z. Sandër Simoni, Kryetar i Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar: ” <https://www.osce.org/files/f/documents/8/c/373348.pdf>

Dallimi ndërmjet trafikimit të të miturit nga keqtrajtimi i të miturit (lypja e detyruar apo shfrytëzimi në punë të detyruar).

Vepra penale e keqtrajtimit të të miturit përfshin edhe keqtrajtimin nga prindërit, familjarët por dhe rastin e detyrimit të fëmijëve për të punuar apo lypur. Në rastin e parë³⁴ dallimi kryesor ndërmjet këtyre dy dispozitave trafikimi, neni 128/b, dhe keqtrajtimi i të miturit neni 124/b është subjekti aktiv i veprës penale, që në rastin e veprës penale 'keqtrajtimi i të miturit' është i posaçëm: prindi, kujdestari ose personi që është përgjegjës për rritjen dhe edukimin e tij. Në rastin e veprës penale "trafikimi i të miturve", subjekti aktiv është i përgjithshëm, por mund të jetë edhe një subjekt i posaçëm – personi që ka për detyrë të kujdeset për të miturin. Ky rast i fundit, evidentohet në kryerjen e trafikimit përmes "shitjes së të miturit" si një formë e trafikimit të tyre, që është një veprim i cili në praktikë, është realizuar edhe nga prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor.

Shfrytëzimin për punë, shtytjen për të siguruar të ardhura, apo për të lypur Kodi ynë Penal i përfshin sërish tek vepra penale e keqtrajtimit të të miturit pag. 2 i nenit 124/b i cili parashikon se:

"Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja, ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor/ fizik apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet."³⁵

Direktiva 2011/36 e BE³⁶ e 5 prillit 2011, e konsideron lypjen e detyruar si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara siç përcaktohet në Konventën e 1930 të ILO, nr.29, në lidhje me Punën e Detyruar, prandaj, shfrytëzimi në lypje, duke përfshirë trafikimin e personit në kujdestari për lypje, përkufizohet si trafikim i qenieve njerëzore vetëm kur ndodhin të gjithë elementët e punës ose shërbimeve të detyruara. Megjithatë, kur shqetësimi është për një fëmijë, asnjë "pëlqim" i mundshëm nuk duhet të konsiderohet i vlefshëm.

Shprehja "shfrytëzim i të miturit për punë të detyruar ose për të siguruar të ardhura" duhet kuptuar si shfrytëzim i të miturit në punë apo orare punë në kundërshtim me Kodin e Punës në lidhje me përcaktimin e moshës për të kryer atë punë.

1.5 KUADRI INSTITUCIONAL NË SHQIPËRI

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave në Ministrinë e Brendshme është mekanizmi kryesor për koordinimin e përpjekjeve antitrafikim në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Që prej krijimit të saj në vitin 2005, puna e kësaj zyre është fokusuar kryesisht në krijimin dhe forcimin e strukturave referuese për viktimat e trafikimit si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal; monitorimin e trafikimit të të miturve e të rriturve; përmirësimin e identifikimit të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit si dhe standardeve për mbrojtjen e tyre; intensifikimin e aktiviteteve parandaluese dhe ndërgjegjësimit të komunitetit si dhe punonjësve të institucioneve shtetërore e organizatave të shoqërisë civile në fushën e ofrimit të shërbimeve.

³⁴ Paragrafi i parë i nenit 124/b të KP: "Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person, që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet".

³⁵ Ky paragraf në nenin 124/b është shtuar me ligjin nr. 144 datë 2.05.2013.

Strukturat kryesore përgjegjëse për luftën kundër trafikimit të personave, në kuadër edhe të zbatimit të Strategjisë kombëtare apo Planit të veprimit Kombëtar kundër trafikimit të personave janë:

1. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave
 2. Task-Forca Kombëtare Anti-Trafik
 3. Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit
 4. Autoriteti Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit.
 5. Komitetet Rajonale Antitrafik dhe tryezat teknike
-

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave Zëvendësministri i Brendshëm, njëkohësisht edhe Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave nëpërmjet Drejtorisë Antitrafik koordinon veprimtarinë e të gjithë aktorëve dhe agjencive shtetërore dhe joshetërore me detyra dhe angazhime në fushën e parandalimit dhe luftës kundër trafikimit të personave në zbatim të detyrave të përcaktuara në strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit kundër trafikimit të personave;

Koordinatori Kombëtar përgatit raporte zyrtare për Qeverinë mbi situatën e trafikimit në vend, bën vlerësime për arritjet dhe propozon nevoja për t'u adresuar apo politika për t'u adoptuar. Gjithashtu koordinon edhe ndihmën e donatorëve në fushën e anti-trafikimit dhe sigurohet që projektet e tyre të orientohen në bazë të prioriteteve, qëllimeve dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare Antitrafik. Koordinatori Kombëtar sigurohet për mirëfunksionimin e Mekanizmi Kombëtar të Referimit për mbrojtjen e Viktimat e Trafikimit.

TASK-FORCA KOMBËTARE ANTI-TRAFIK

Përbëhet nga drejtues të lartë në nivel teknik me detyra kryesore në zbatimin e objektivave të Strategjisë në institucionin ku punojnë, përfshirë përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Sistemit Gjyqësor, Komiteteteve Rajonale Antitrafik, OJF-ve të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave. Ndër të tjera Task Forca bën propozime lidhur me nevojat për ndryshime të veprimeve që u takojnë atyre për t'i ndjekur, me qëllim realizimin me efektivitet të qëllimeve të Strategjisë kombëtare antitrafik dhe të aktiviteteve të saj.

Task-Forca si rregull mbledhet 1 herë në 6 muaj nën drejtimin e Koordinatorit Kombëtar, por edhe më shpesh në rast se kërkohet.

Task-Forca konsiderohet si struktura kryesore përgjegjëse në nivel teknik për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore si dhe për vlerësimin periodik të masave antitrafikim në vend, si në nivel qendror dhe vendor.

MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT

Marrëveshja e bashkëpunimit për “Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit” rregullon funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit.

Palë në marrëveshje janë institucione shtetërore, organizata të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit si dhe IOM. Mekanizmi Kombëtar i Referimit trajtohet gjerësisht në Kpitullin IV të këtij manuali.

AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR MEKANIZMIN KOMBËTAR TË REFERIMIT PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Ngritja e Autoritetit përgjegjës është përcaktuar në nenin 7 të Marrëveshjes për Mekanizmin Kombëtar të Referimit të Viktimave të Trafikimit, me anë të një Urdhri të Përbashkët të strukturave nënshkruese të Marrëveshjes.

Autoriteti Përgjegjës përbëhet nga përfaqësues të Policisë së Shtetit (Kufiri dhe migracioni, Policia Antitrafik, Dhuna në familje dhe mbrojtja e fëmijëve), Shërbimi Social Shtetëror dhe, Drejtoria Konsullore Ministria e Punëve të Jashtme, me nga 2 anëtarë për çdo institucion. Ai u materializua me Udhëzimin e përbashkët nr. 3799, datë 08.07.2014 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces”.

Autoriteti Përgjegjës është struktura që bashkërendon identifikimin, kthimin, pritjen, referimin për ndihmë dhe ri-integrimin e viktimave dhe/ose viktimave të mundshme të trafikimit. Brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti Përgjegjës ka për detyrë hartimin dhe dorëzimin e raporteve periodike pranë Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ministrinë e Brendshme, i cili nga ana e tij informon Ministrin e Brendshëm, për të gjithë punën e bërë;

Gjithashtu ka përgjegjësi të regjistrojë dhe të raportojë periodikisht të dhënat për rastet e referuara të trafikimit. Kjo strukturë administron bazën e të dhënave për viktimat e trafikimit dhe kujdeset për ruajtjen e tyre në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

Autoriteti Përgjegjës mbledhet në mënyrë periodike, si dhe për raste të veçanta, për koordinimin e punës mbi asistimin e viktimave të trafikimit, përfshi këtu edhe rastet e fëmijëve që shfrytëzohen në rrugë, si dhe raste transnacionale të referimit, duke u vënë në kontakt nga dhe me strukturat homologe në rajon.

1.6 METODAT E KONTROLLIT

1.6.1 PËRSHKRIM I MJETEVE TË KONTROLLIT MBI VIKTIMËN

Metodat e kontrollit lidhen drejtpërdrejt me ‘mjetet’ e identifikuar më lart dhe kanë rëndësi kyçe për shfrytëzimin fillestar, dhe të mëpasshëm, të viktimës. Tashmë trafikantët përdorin më pak forcën dhe më tepër metoda të sofistikuar për të mbajtur në kontroll viktimat, veçanërisht ato të shfrytëzimit seksual. Fakti që viktimave u lihet një pjesë e fitimeve dhe lejohen të shkojnë në shtëpi, e bën më të vështirë të provuarit e trafikimit për sistemin gjyqësor.

Në shumë raste trafikimi, viktimat mund të ketë dhënë fillimisht pëlqimin të udhëtojë jashtë

vendit (në mënyrë të paligjshme), të punojë për një pagë të ulët apo fshehtas, apo të ushtrojë prostitucion. Megjithatë, sipas Protokollit të Palermos, pëlqimi i viktimës së trafikimit në lidhje me shfrytëzimin është i pavlefshëm nëse janë përdorur mjetet e paligjshme të shtrëngimit, përdorimit të forcës, etj³⁶.

Dhe në rastet kur duket se viktima e jep pëlqimin, hetimi i thelluar tregon se pëlqimi është arritur nëpërmjet përdorimit të shtrëngimit, mashtrimit, apo mjeteve të tjera të shtrëngimit si për shembull:³⁷

- Joshja dhe romanca
- Njoftime të rreme për mundësi punësimi, arsimimi, apo udhëtimi
- Dhunë dhe marrje me forcë
- Shitje nga anëtarët e familjes
- Detyrim prej borxhit
- Rekrutim nëpërmjet personave të trafikuar më parë.

DETYRIM ME ANË TË BORXHIT

Viktima duhet të paguajë borxhin e mbledhur për të mbuluar transportin, akomodimin, ushqimin si dhe një mori “shpenzimesh” të tjera që trafikantët pretendojnë se kanë bërë për ta. Viktimat detyrohen të punojnë në situata shfrytëzimi për të paguar borxhin, të cilit mund t’i shtohen dhe norma interesi mbi “borxhin”, apo tarifa të mëtejshme, për shembull qiraja e dhomës kosto e jetesës në rastin e shërbyesve të familjeve. Mund të vendosen edhe gjopa për një sërë “shkeljesh” që janë përcaktuar nga trafikantët.

Viktimave mund t’u thuhet se do t’u duhet të paguajnë vetëm për udhëtimin, etj. kur të punojnë dhe nuk u thuhet se sa do të jetë kjo pagesë dhe se çfarë do t’u duhet të bëjnë për të fituar paratë. Në disa raste, viktimat paguajnë para në dorë paraprakisht duke besuar se do të kalojnë në mënyrë të paligjshme kontrabandë, dhe më pas u kërkohen më shumë para gjatë rrugës; realiteti është se ata janë trafikuar dhe se “borxhi” do të përdoret për t’i kontrolluar dhe për t’i shfrytëzuar. Viktima mund ta pranojë borxhin në fillim, pa e ditur se në fakt nuk do të arrijë ta shlyejë dot kurrë. Përgjithësisht viktimat e trafikimit me anë të borxhit mbahen të izoluar dhe pa kontakte me njerëz në vendin e destinacionit. Zakonisht ato nuk flasin gjuhën e vendit ku ndodhen dhe janë totalisht të varura nga trafikantët.

JOSHJA DHE ROMANCA - TË DASHURIT ROMANTIKË

Një ‘i dashur romantik’ është dikush (zakonisht një djalë i ri) që josh dikë (zakonisht një vajzë të re) për ta detyruar për prostitucion apo për punë të tjera të paligjshme duke krijuar marrëdhënie romantike me viktimat e tyre. Por, kjo marrëdhënie shumë shpejt shndërrohet në një marrëdhënie abuzive emocionale dhe psikologjike. Të dashurit romantikë përdorin shantazhin dhe dhunën për t’i frikësuar viktimat e tyre që të detyrohen të binden.

³⁶ ICMPD, *Anti-Trafficking Training Material for Judges and Prosecutors [Material Trajnimi për Gjyqtarë dhe Prokurorë në Shtetet anëtare të BE-së dhe vendet candidate]*, 2006. https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/icmpd_curriculum_2006_en_1.pdf

³⁷ UNODC, *Anti-Human Trafficking Manual for Criminal Justice Practitioners 2009 [Manuali për Anti-Trafikimin për profesionistët e sektorit të Drejtësisë]*. <https://www.unodc.org/unodc/en/human-trafficking/2009/anti-human-trafficking-manual.html>

Taktika të tjera përfshijnë përshkrimin e një jete të mrekullueshme bashkë jashtë shtetit ose diku tjetër brenda vendit. Ata synojnë ta izolojnë viktimën nga familja apo komuniteti dhe në disa raste i detyrojnë që të përfundojnë në një shtet ku ato nuk mundet të flasin gjuhën e zakonshme.

Ata përgjithësisht i bindin viktimat e tyre të lëvizin përtej kufijve sepse kur janë të mashtruara, viktimat shkojnë me dëshirë dhe shpesh paguajnë edhe tarifën e transportit përkatës. Kur arrijnë, bien në duart e trafikantëve. Dhe është gjithmonë vetëm çështje kohe para se të zbulojnë natyrën e vërtetë të të dashurit të tyre romantik.

NJOFTIMET E RREME PËR PUNË

Shumë raste të trafikimit të qenieve njerëzore nisin me mashtrimin e viktimës nëpërmjet ofertave joshëse për punësim. Këto oferta janë gjithmonë të rreme, por kanë disa aspekte bindëse. Ofertat mund të postohen në internet apo në shtyp apo dhe nëpërmjet afishimit në vende publike.

Punët mund të jenë si baby sitter, punëtor shtëpie, hoteleri, turizëm, të kateringut dhe pastrimit. Kur trafikimi ka një natyrë veprimi modus operandi ndërkombëtare, këta njerëz e paguajnë vetë udhëtimin dhe arrijnë në atë vend në mënyrë të ligjshme me të gjitha dokumentet. Me mbërritjen e tyre, ata merren në kontroll dhe ndodh një proces i 'thyerjes' së tyre.

Në këtë rast, 'thyerja' përfshin një seri abuzimesh emocionale, fizike dhe psikologjike të tilla si përdhunimi, tortura, kërcënimet, degradimi, dhe konsumimi me forcë i drogave dhe alkoolit. Kjo ndodh pa mëshirë gjatë periudhës së përgatitjes për të thyer shpirtin e viktimave të trafikuar. Disa viktima të trafikimit kanë thënë gjithashtu se shumë pak kohë pas mbërritjes së tyre, kanë dëshmuar vrasjen e viktimave të tjera. Kjo u shkakton viktimave që të kalojnë në një gjendje të vetë-ruajtjes duke u bindur.

SHITJE NGA ANËTARËT E FAMILJES

Për arsye kryesisht ekonomike, përgjithësisht dëshpëruese, familjet mund të detyrohen t'u shesin fëmijët trafikantëve. Disa herë, ata mund të ndërtojnë marrëdhënie me grupe trafikantësh, hyjnë në partneritete, duke mos e treguar saktë natyrën e punës apo veprimtarisë së fëmijës me qëllim që të joshin familje të tjera për të shitur fëmijët e tyre.

Sindroma e Stokholmit është një reagim psikologjik. Ajo ndodh kur pengjet apo viktima të abuzimit krijojnë një lidhje me robëruesit apo abuzuesit e tyre. Kjo lidhje psikologjike zhvillohet me kalimin e ditëve, javëve, muajve, madje edhe të viteve nën robëri apo abuzim.

Me këtë sindromë, pengjet apo viktimat e abuzimit mundet të arrijnë të krijojnë simpati për robëruesit e tyre. Kjo është e kundërta e frikës, terrorit dhe përbuzjes që mund të pritët nga viktimat në këto situata.

Me kalimin e kohës disa viktima arrijnë të zhvillojnë ndjenja pozitive ndaj robëruesve të tyre. Ato mundet të fillojnë të ndiejnë sikur ndajnë qëllime dhe kauza të përbashkëta. Viktima mund të fillojë të ndiejë ndjenja negative ndaj policisë apo autoriteteve. Ata mund të kenë zët këto që mund të përpiqet t'i ndihmojë t'ia mbathin nga situata e rrezikshme në të cilën ndodhen.

DHUNA DHE MARRJA ME FORCË PËR TRAFIKIM TË QENIEVE NJERËZORE

Dhuna apo kërcënimi për dhunë mund të përdoret në çdo fazë të trafikimit me qëllim kontrollimin e viktimës dhe pre mund të jenë viktimat ose familjarët. Në rastin e shfrytëzimit seksual viktimat mund të rekrutohen si fillim me anë të mashtrimit. Dhuna konkrete apo kërcënimet shfaqen nëse viktima përpiqet të largohet ose përdoret për të arritur bindjen e viktimës në rastin kur është duke u shfrytëzuar.

1.6.2 ÇËSHTJA E DHËNIES SË PËLQIMIT

Nuk është e mundur që të jepet “pëlqim” për trafikimin e qenieve njerëzore.

Legjislacioni ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ka përcaktuar gjithmonë se natyra e brendshme e patjetërsueshme e lirisë personale e bën të pavend dhënien e pëlqimit në një situatë në të cilën ajo liri personale i merret individit. Ky kuptim pasqyrohet në elementin e “mjetit” të përkufizimit të trafikimit. Siç është vënë në dukje nga hartuesit e Protokollit të Palermos: “pasi është përcaktuar se është përdorur mashtrimi, shtrëngimi, forca apo mjeteve të tjera të ndaluara pëlqimi bëhet i pavend dhe nuk mund të përdoret si mbrojtje”.³⁸

Në rastet e trafikimit ku përfshihen fëmijë, Protokollit i Palermos përcakton se trafikimi ka ndodhur pavarësisht nga «mjetet» e përdorura. Prandaj, në rastin e trafikimit të fëmijëve, nevojitet vetëm që të provohet çfarë është bërë dhe lloji i shfrytëzimit.

Fëmija nuk ka aftësinë që të japë pëlqimin për një sjellje të tillë, pavarësisht nga fakti nëse është marrë në mënyrë të papërshtatshme për shkak se ligji u jep atyre status të posaçëm pasi pozita e tyre vulnerabël ua pamundëson të japin pëlqim pikë së pari.

³⁸ UNODC, *Legislative Guides for the Implementation of the United Nations Convention against Transnational Organized Crime and the Protocols Thereto* [Udhëzimi për zbatimin e Konventës së OKB-së kundër Krimin të organizuar ndërkombëtar dhe Protokolleve Shtesë]. <https://www.unodc.org/unodc/en/treaties/CTOC/legislative-guide.html>



KAPITULLI 2.



TREGUESIT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

2.1 TREGUESIT SIPAS UDHËZUESVE NDËRKOMBËTARË

Treguesit janë saktësisht shenja, tregues të një situatë që mund të përfshijë trafikimin e një personi. Njohja e treguesve të trafikimit që kanë lidhje me punën apo mjedisin operacional është me rëndësi kyçe për të kuptuar ‘pamjen që ka’ trafikimi, dhe është me rëndësi themelore për identifikimin në kohë të një viktime të trafikimit dhe për reagimin e duhur.

Prezenca apo mungesa e treguesve nuk do të thotë që trafikimi i qenieve njerëzore mund të identifikohet në mënyrë kategorike si i tillë. Prezenca e treguesve duhet të çojë në hetime të mëtejshme.

Treguesit e trafikimit të qenieve njerëzore mund të lidhet me faza të ndryshme të trafikimit dhe grupohen si më poshtë³⁹:

1. TREGUES NË VENDIN E ORIGINJËS

1.1 Tregues të lidhur me Rekrutimin

- Mashtrimi; histori apo thashetheme për punë që ose janë qartësisht të rreme ose nuk kanë gjasë të jenë të vërteta, si për shembull ofrojnë pagë të mirë për punë të pakualifikuara ose punë që nuk kërkojnë kualifikime;
- Si më lartë, por kur udhëtimi jashtë vendit është një faktor dhe administrimi i tarifave bëhet nga një ‘agjent’;
- Raportime të personave të humbur në lidhje me femra të përfshira në marrëdhënie që nuk janë miratuar nga prindërit, p.sh. skenar i mundshëm i ‘djalit romantik’;
- Persona që me sa duket janë larguar nga fshati, qyteti, rrethi, etj. befas apo shumë shpejt me një shpjegim të pamjaftueshëm p.sh. prindërit shpjegojnë mungesën e një fëmije.

1.2 Tregues të lidhur me Reklamimin

- Reklamimi apo promovimi i një migracioni të organizuar apo të asistuar për në vende që kërkojnë kriterë të larta kualifikimi apo përndryshe rrethana sfiduese;
- Pa kosto/me kosto të ulët ose organizime udhëtimi pa kosto paradhënie, sidomos në rastin e udhëtimeve ndërkombëtare;
- Vende pune të targetojnë një profil specifik apo shumë të ngushtë personash ku specifikohet gjinia dhe moshja, p.sh. femra të moshës 18 - 22 vjeç;
- Mundësi punësimi promovuar në vendndodhje apo industri ku trafikimi haset shpesh, p.sh. hotele, bare, klube nate.

39 https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/TIP_module2_Ebook.pdf

1.3 Tregues të lidhur me vendin e shfrytëzimit

- Klube nate, bare, hotele me gra të huaja të pranishme si valltare, kameriere apo mikpritëse;
- Veprimtari në mjedise të ligjshme dhe të paligjshme të industrisë së seksit;
- Sjellje apo qasje e raportuar e dyshimtë kundrejt fëmijëve pranë shkollave apo jetimoreve;
- Persona që u ofrojnë punësim migrantëve në vendet ku mblidhen migrantët;
- Persona që u ofrojnë punësim personave të pastrehë në vendet ku mblidhen dhe gjejnë strehë personat e pastrehë;

1.4 Tregues të lidhur me Transportin

- Persona që kontrollojnë pasagjerët në një automjet, p.sh. flasin në emër të tyre apo mbajnë dokumentet e tyre të identitetit apo të udhëtimit;
- Një ose disa fëmijë që jetojnë një shoqërinë e një të rrituri/rriturve që nuk janë anëtarë të familjes;
- Një i rritur në krye apo në kontroll të një grupi fëmijësh;
- Pasagjerë që nuk mund të shpjegojnë në mënyrë të mjaftueshme udhëtimin apo destinacionin e tyre.

1.5 Tregues të lidhur me komunikimin

- Mungesa, apo kontakte të ndërprera telefonike me anëtarin e familjes apo mikun që ka udhëtuar dhe është larguar së fundmi;
- E-maillet dhe letrat nuk marrin përgjigje apo kthehen si "të padërguara";
- Komunikimi nga një vend destinacioni i njohur që tregon liri të kufizuar të lëvizjes.

1.6 Tregues të lidhur me mjetet financiare

- Prindër të fëmijëve që mungojnë në shkolle dhe shfaqin pasuri apo një stil jetese të përmirësuar përtej mundësive të dukshme të tyre;
- Informacion se anëtarët e familjes kanë qenë objekt i përpjekjeve të kriminelëve apo të tjerëve për të rikuperuar një detyrim borxhi;
- Para të marra nga jashtë shtetit si remitanca;
- Remitancat e marra nga dërguesi mund të mos jenë siç ishte rënë dakord apo mbërrijnë me frekuencë të çrregullt;
- Prova të blerjeve të minutës së fundit ose bileta të paguara me para në dorë.

2. TREGUESIT NË VENDNDODHJET E TRANSITIT

2.1 Tregues të lidhur me transportin

- Persona që kontrollojnë pasagjerët në një automjet, p.sh. flasin në emër të tyre apo mbajnë dokumentet e tyre të identitetit apo të udhëtimit;
- Një ose disa fëmijë që jetojnë një shoqërinë e një të rrituri/rriturve që nuk janë anëtarë të familjes;
- Një i rritur në krye apo në kontroll të një grupi fëmijësh;
- Fëmijë i pashoqëruar;
- Pasagjerë që nuk mund të shpjegojnë në mënyrë të mjaftueshme udhëtimin apo destinacionin e tyre;
- Grupe pasagjerësh pa bagazhe të përbashkëta;
- Itinerare dhe/ose destinacione që dihet se përdoren nga trafikantët;
- Kostot e transportit të paguara nga një person tjetër;
- Transporti i përdorur nuk është ai që përdoret rregullisht apo nuk është i papërshtatshëm për pasagjerët;
- Koha e udhëtimit nuk është ajo e zakonshme;
- Biletë vetëm vajtje dhe shuma të pamjaftueshme parash që personi të mbulojë kostot e jetesës së përditshme;
- Automjeti ndërrohet pranë ose pas kalimit të kufirit.

2.2 Tregues të lidhur me vendin ku ndodh shfrytëzimi

- Akomodimi apo adresa e lidhur ose që dihet se është e lidhur me udhëtimin jo të rregullt ose me trafikimin e qenieve njerëzore;
- Mjediset nuk janë të përshtatshme ose të projektuara për banim rezidencial apo qëndrim të shkurtër;
- Mjediset nuk ndodhen në ose pranë një rrjeti të rregullt rrugor dhe/ose pikat e aksesit të fshehura nga syri i publikut;
- Veprimtari këmbësorësh e pazakonshme/jashtë orarit për llojin e vendndodhjes dhe mjediseve;
- Veprimtari automjetesh e pazakonshme/jashtë orarit për llojin e vendndodhjes dhe mjediseve;
- Përshkrimi i vizitorëve përputhet me profile të njohura trafikantësh.

2.3 Tregues të lidhur me mjetet financiare

- Personat nuk kanë ose kanë shuma apo mjete të pamjaftueshme në valutë për vendin e destinacionit;
- Evidenca të blerjeve të minutës së fundit ose bileta të paguara me para në dorë;
- Vetëm një person në grup ka para në dorë cash apo mjete pagese;
- Evidencë apo dyshim se po i paguhet ryshfet personelit ligj zbatues.

2.4 Tregues të lidhur me komunikimin

- Kontaktit me telefon celular nga vendndodhje specifike me kontakte të tjera të rregullta në vende të tjera, p.sh. trafikantët konfirmojnë mbërritjen dhe nisjen me bashkëpunëtorët e tyre;
- Kontaktit me telefon celular nga udhëtarë/migrantë të njohur të lidhur me vendndodhje specifike, p.sh. viktima të mundshme/të padysuara në rrugëtim që kontaktojnë anëtarët e familjes;
- Persona që ndalohen apo kontrollohen nga ligj zbatuesit që kanë karta SIM për vende të njohura destinacioni, transiti dhe telefona celularë të vendit të destinacionit dhe/ose të disa vendeve.

3. TREGUESIT NË VENDNDODHJET E DESTINACIONIT

3.1 Tregues të përgjithshëm

- Deklaratë ose aludim nga personi(at) që plotësojnë përkufizimin e Veprës, Mjetit, dhe Qëllimit;
- Deklaratë ose aludim nga personi(at) që plotësojnë përshkrimin e detyrimit të borxhit;
- Gjuha e trupit e personit(ave);
- Pamja e jashtme e personit(ave);
- Profili i personit(ave) p.sh. na një vend i njohur burimi;
- Kushte pune të dukshme ose të mundshme;
- Kushte të dukshme ose të qarta të akomodimit;
- Liri e kufizuar lëvizjeje e dukshme ose e mundshme;
- Liri e kufizuar e komunikimit e dukshme ose e mundshme;
- Nuk flet gjuhën 'lokale';
- Personat janë në siklet kur kanë të bëjnë me autoritetet;
- Mungesë dëshire për t'iu përgjigjur pyetjeve ;
- Nuk zotëron dokumente ID ose udhëtimi;
- Dokumente të shumfishta ID/Udhëtimi që mbahen ose ruhen në një vend;
- Vendndodhja shfaq lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore;
- Mjediset shfaqin lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore;
- Një person që flet në emër të të tjerëve ose kontrollon bisedën;
- Personi(at) nuk e di(në) ku janë;
- Personi(at) nuk është (janë) në gjendje t'u përgjigjen pyetjeve bazë që kanë të bëjnë me vendndodhjen apo me punësimin;
- Lëndime të dukshme/të qarta që nuk janë trajtuar si duhet;
- Mungesa e qasjes në kujdes shëndetësor;
- Qasje e kufizuar ose e munguar sociale;
- Ndërveprim i personit me të tjerë në prezencë të dëshmitarëve.

4. TREGUESIT NË RASTET E FËMIJËVE

- Fëmijët të pranishëm në situata të ndaluara apo të papërshtatshme. p.sh. bar, fabrikë, gurore, rrugë të ngarkuara;
- Fëmijët e angazhuar në veprimtari publike të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore, p.sh. lypja;
- Fëmijët të ndaluar nga ligj zbatuesit në lidhje me krimin p.sh. shitja e drogave, transportimi i drogave, vjedhja e shtëpive, vjedhja e xhepave;
- Fëmijët të izoluar nga të tjerët;
- Pamja e jashtme p.sh. etniciteti, mosha, gjinia, veshja;
- Shëndeti apo mirëqenie e dukshme;
- Gjuha e trupit;
- Fëmijë në moshë shkolle që nuk ndjekin mësimin;
- Imazhe, fotografi të pashpjeguara të fëmijëve të pranishëm në vendndodhje;
- Grup fëmijësh që kontrollohen nga një i rritur i vetëm;
- Grup fëmijësh që udhëtojnë me të rritur që janë të panjohur;
- Prezenca e artikujve që shoqërohen me fëmijët në mjedise të ndaluara ose të papërshtatshme p.sh. shtëpi publike, mjedis pune i rrezikshëm, vendndodhje e izoluar.

5. TREGUESIT SIPAS FORMAVE TË SHFRYTËZIMIT

5.1 Tregues të lidhur me shfrytëzimin Seksual

- Veprimtari e paligjshme në industrinë e seksit p.sh. shtëpi publike, shërbime eskortë, njoftime për këto, listë shërbimesh seksuale në dhoma hoteli;
- Vizitë e shtuar vizitorësh meshkuj në mjedise apo adresa jotregtare;
- Shqetësim klientësh në lidhje me punëtorët e seksit, p.sh. mungesë dëshire për të dhënë shërbime seksuale, stres, nën ndikimin e rëndë të alkoolit dhe narkotikëve;
- Punëtorët e seksit mbajnë tatuazhe që tregojnë pronësi nga trafikantët;
- Punëtorët e seksit nën ndikimin e rëndë të alkoolit ose narkotikëve;
- Lëvizje e grave midis vendndodhjeve të njohura ku ofrohen shërbime seksuale;
- Gra që gjithmonë janë të shoqëruara kur dalin nga mjediset;
- Gra nën kontrollin e një grupi burrash;
- Gjuhë trupi dhe sjellje e nënshtruar në prezencën e burrave specifikë;
- Pamje dhe veshje që lidhet me ofrimin e shërbimeve seksuale;
- Njohuri e gjuhës lokale që lidhet vetëm me shërbimet seksuale;
- Mosbesim ndaj autoritetit;
- Gra që punojnë si punëtore seksi përputhen me profilin e grave të trafikuar.

5.2 Tregues të lidhur me shfrytëzimin për punë

- Objekte apo mjedise që lidhen me shembuj të njohur të punës së detyruar;
- Veprimtari e vëzhguar apo e raportuar që përputhet me profilin e punës së detyruar;
- Grumbullimi i shtetasve të huaj në qendra për rekrutimin e parregullt për punë p.sh. burra që zënë radhë herët në mëngjes në pritje të merren nga automjete tregtare;
- Krahu i punës përputhet me profilin e personave të trafikuar;
- Krahu i punës janë kryesisht migrantë ose punëtorë të huaj;
- Gjuha lokale nuk njihet nga krahu i punës;
- Veshjet për mjedise punë të rrezikshme mungojnë ose janë të pamjaftueshme, p.sh. helmata, doreza, syze mbrojtëse, veshje industriale;
- Krahu i punës punon pa instrumentet dhe pajisjet e duhura;
- Punëtorët nuk kanë kontrata punësimi;
- Orari i punës, pushimet nuk janë sipas asaj që është rënë dakord apo reklamuar;
- Rroga nuk është aq sa është reklamuar;
- Rroga nuk paguhet;
- Rroga kontrollohet nga një agjent apo kryetar i bandës;
- Varësi ndaj agjentit, kryetarit të bandës, punëdhënësit p.sh. akomodim, ushqim, transport, siguri e vendit të punës, qasje në dokumente ID dhe udhëtimi.

5.3 Tregues të lidhur me shërbimin në familje

- Mjedise apo situata të lidhura me profile të njohura për shërbimin në familje;
- Personin nuk e shohin asnjëherë jashtë ndërtesës/vendndodhjes;
- Personi(at) përputhen me profilin e viktimës së shërbimit në familje p.sh. gra nga Azia Juglindore që punojnë për familje në Shtetet e Gjirit;
- Nuk ka hapësirë private përfshirë kushtet e fjetjes;
- Përrjashtuar nga ndërveprimi social me anëtarët e familjes apo të tjerë;
- Objekt i ngacmimit seksual dhe/ose abuzim fizik/verbal nga punëdhënësi;
- Nuk lejohet të hajë me anëtarët e familjes, nuk i jepen vakte të duhura p.sh. vetëm ushqimi që ka mbetur;
- Nuk lejohet të dalë nga mjediset pa u shoqëruar nga punëdhënësi apo dikush tjetër.

5.4 Tregues të lidhur me veprimtari kriminale

- Veprimtaria përputhet me profilin e njohur të shfrytëzimit për veprimtari kriminale p.sh. lypje me detyrim, administrimi i fermave urbane të kanabisit;
- Personi(at) lëvizin rregullisht nga një qytet apo shtet në tjetrin;
- Personi përfshihet në veprimtari të bandave kriminale;
- Zhdukje pas arrestimit apo ndërhyrjes së ligj zbatuesve p.sh. zhvendosur në një zonë tjetër;
- personi rezulton i arrestuar apo dënuar më parë në vende të tjera për shkelje të ngjashme;
- Përfshirë në veprimtari kriminale të të njëjtës kombësi/etnicitet në një vend të huaj p.sh. bandat kriminale shqiptare që operojnë në Mbretërinë e Bashkuar;

- Tregues të detyrimit të borxhit;
- Kontrolluar nga një person tjetër;
- Lëndime dhe vrapa të dukshme që mund të lidhen me rrahje si ndëshkim për mosbindje.

2.2 TREGUESIT SIPAS PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

Vlerësimi i situatës së personave viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit në Shqipëri kruhet kundrejt treguesve të trafikimit, sipas Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.

Përsa i përket identifikimit fillestar të viktimave të trafikimit nga Policia e Shtetit, treguesit ndahen sipas rolit të secilës strukturë të policisë që mund të kryejë identifikimin fillestar të një viktime trafikimi.

“Identifikim dhe Reagim Fillestar”, është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, vendore dhe qendrore, përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë, brenda dhe jashtë territorit të RSH-së, që përcaktojnë se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave

Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit nga Departamenti Për Kufirin Dhe Migracionin

Fëmijët	Të rriturit
I mituri ka kaluar kufirin ose është në tentativë për të kaluar kufirin në mënyrë të parregullt/lëvizjet kanë shmangur kontrollin kufitar;	Personi që hyn apo që del, ka kaluar kufirin, ose është në
I mituri është i/e shoqëruar nga persona të cilët janë të dyshuar si kontrabandistë apo trafikantë;	tentativë për të kaluar kufirin në mënyrë të parregullt/lëvizjet kanë shmangur kontrollin kufitar;
I mituri nuk posedon dokumenta/dokumentat e fëmijës janë false ose të dyshimta;	Personi që del është i/e shoqëruar nga persona, të cilët janë të dyshuar si kontrabandistë apo trafikantë;
I mituri duket më i vjetër/më i ri se të dhënat në pasaportë;	Personi që po hyn nuk ka dokument udhëtimi për shkak se është mbajtur nga punëdhënësi, personi me të cilin ka banuar etj;
I mituri nuk di adresën ku do banojë;	Personi nuk di adresën ku do banojë;
I mituri ka numra telefoni taksish;	Personi ka numra telefoni taksish;
I mituri shqiptar ka një histori lëvizjesh të shpeshta me ose pa familjen brenda dhe jashtë vendit;	Personi ka plagë;
I mituri udhëton në grup me persona që nuk janë të afërm dhe nuk ka prokurë nga prindërit /kujdestari ligjor	Personi ka bagazhe që nuk korrespondojnë me qëllimin e udhëtimit.
I mituri udhëton me dokumentat e dikujt tjetër	Personi gjatë intervistës është kontradiktor me thëniet.
I mituri vjen nga vende të njohura për trafikimin;	
I mituri ka plagë ose shenja në duar në paraqitje që tregon se ai/ajo punon;	
I mituri ka veshur rroba të papërshtatshme për moshën e tij;	
I mituri ka sjellje të pa përshtatshme për moshën e tij/ saj, sillet si më i/e rritur;	
I mituri ka bagazhe që nuk korrespondojnë me qëllimin e udhëtimit;	
I mituri nuk është i/e regjistruar në gjendjen civile;	
I mituri shfaq frikë, është i/e tërhequr;	
I mituri shfaq mosbesim tek autoritetet;	
I mituri ndihet i qetë kur bie në kontakt me policinë;	
Fshehje e statusit të emigrimit;	
Histori të njëjta (sikur të instruktura);	
Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë;	
Janë super të shkathët dhe të zgjuar (i mituri jep përgjigje të cilat tregojnë shkathtësi dhe zgjuarsia të veçantë për moshën).	

Treguesit për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit nga Strukturat e Tjera të Policisë së Shtetit

Fëmijë	Të rritur
I mituri/e mitura është i/e sjellë nga një vend tjetër për të punuar/fituar më shumë para;	Personi është sjellë nga një vend tjetër për të punuar/fituar më shumë para
I mituri/e mitura ka lëvizur i/e paregjistruar në gjendjen civile;	Personi ka një numër të kufizuar kontaktesh
I mituri/e mitura largohet shpesh nga shtëpia;	Personi është i punësuar në mënyrë të paligjshme/punon në punë të rrezikshme;
I mituri/e mitura vetë, prindërit e tij/saj dhe motra vëllezër kanë ardhur shpesh në kontakt me policinë si pasojë e ekspozimit, pësimit të dhunës;	Personi ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;
I mituri/e mitura ka një numër të kufizuar kontaktesh;	Shtrëngohen të punojnë në kushte të caktuara;
I mituri/e mitura kalon pjesën më të madhe të kohës në rrugë duke shitur, duke lypur, duke punuar;	Vijnë nga një vend i njohur si vend origjine;
Fëmijës i merren të ardhurat nga lypja, puna, veprimtaria nga më të rriturit;	Nuk janë në gjendje të tregojnë dokumentat e identitetit;
I mituri/e mitura është kapur duke kryer veprimtari të paligjshme dhe dyshohet se ka të tjerë më të rritur që e shtyjnë;	Lejojnë të tjerët të flasin për ta;
I mituri/e mitura është i/e punësuar në mënyrë të paligjshme apo punon në punë të rrezikshme;	Janë të paaftë të komunikojnë lirshëm me të tjerët;
I mituri/e mitura ka kontakte me individë apo grupe të dyshuara për aktivitete të paligjshme;	Shfaqin ankth dhe frikë gjatë komunikimit;
I mituri/e mitura shfaq frikë, është i/e tërhequr;	Nuk kanë akses te shërbimi mjekësor.
I mituri/e mitura ka mosbesim tek autoritetet;	
I mituri/e mitura tregon histori të ngjashme dukshëm të mësuara;	
Lejon të tjerët të flasin për të edhe pse mund ketë moshën ose paraqitjen për t'u përgjigjur vetë.	



KAPITULLI 3.



VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

3.1 PËRKUFIZIMI I “VIKTIMËS” SË TRAFIKIMIT

Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit kanë për qëllim kryesor mbrojtjen, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo fëmijë, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjithë llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

Përkufizimi i termit viktimë

Konventa e Këshillit të Evropës në nenin 4(e) përcakton se për qëllim të kësaj konvente “viktimë” personin fizik që i nënshtrohet trafikimit të qenieve njerëzore sipas përkufizimit që i bën konventa.

Termi “viktimë” shpesh konsiderohet si përshkrim i padrejtë i personave të trafikuar dhe në shumë shtete sot ndeshet termi “ie mbijetuar” e trafikimit.

3.2 IDENTIFIKIMI I NJË VIKTIMË TRAFIKIMI

3.2.1 PARIMET E PËRGJITHSHME TË IDENTIFIKIMIT

Identifikimi i hershëm dhe i saktë i individëve si viktimë duhet të trajtohet me përparësi, me qëllim që të sigurohet që:

- ata të largohen prej shfrytëzimit, të vendosen nën kujdes të sigurt, të marrin mbrojtje, asistencë dhe mbështetje;
- ata të ndahen nga trafikantët e dyshuar në mënyrë që të shmangët rreziku i intimidimit;
- Rrjetet e trafikimit të identifikohen dhe të çmontohen, dhe autorët e veprave penale të arrestohen dhe ndiqen penalisht; dhe
- Modelet e trafikimit të monitorohen me qëllim përgatitjen e a) programeve parandaluese të efektshme e të targetuara, dhe b) hartimin e strategjisë dhe politikës së efektshme kundër trafikimit.

Çështja e identifikimit është caq shumë e rëndësishme për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore sa që natyrshëm është përcaktuar në ligj, në nivel ndërkombëtar dhe në nivel kombëtar.

Neni 10 i Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore kërkon nga shtetet palë marrjen e masave konkrete për identifikimin e viktimave të trafikimit jo vetëm nga institucionet shtetërore por nëpërmjet përfshirjes së të gjithë aktorëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë. Identifikimin si fillimi i procesit të mbrojtjes së viktimave të

trafikimit kërkohet të normohet në akte të brendshëm rregullatore të cilat do ti ofrojnë viktimave mbrojtjen e nevojshme.

1. “Çdo Palë do t’u sigurojë autoriteteve të veta kompetente persona të trajnuar dhe të kualifikuar në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në identifikimin dhe ndihmën ndaj viktimave, përfshirë fëmijët dhe do të sigurojë që autoritetet e ndryshme bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, si dhe me organizata të ngjashme mbështetëse, në mënyrë që viktimat të mund të identifikohen me një procedurë që merr parasysh situatën e veçantë të viktimave gra dhe fëmijë dhe në raste të përshtatshme, i pajis me lejet e qëndrimit, sipas kushteve të parashikuara në nenin 14 të kësaj Konvente.”
2. “Çdo Palë do të miratojë masa legislative ose masa të tjera sipas nevojës, për të identifikuar viktimat, si të jetë e përshtatshme në bashkëpunim me Palë të tjera dhe organizata të ngjashme mbështetëse. Secila Palë do të sigurojë që, nëse autoritetet kompetente kanë shkaqe të arsyeshme të besojnë se një person ka qenë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, ai person nuk do të largohet nga territori i saj derisa autoritetet kompetente të kenë kryer procesin e identifikimit si viktimë e një shkeljeje, të parashikuar në nenin 18 të kësaj Konvente dhe gjithashtu do të sigurojë që personi të marrë ndihmën e parashikuar në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2.”
3. Kur mosha e viktimës nuk dihet dhe ka arsye të besohet që viktima është fëmijë, ai ose ajo do të prezumohet të jetë një fëmijë dhe do t’i sigurohen masa të posaçme mbrojtëse, në pritje të verifikimit të moshës së tij/saj.”
4. “Pas identifikimit të një fëmije të parashikuar si viktimë, çdo Palë:
 - do të parashikojë përfaqësimin e fëmijës nga një kujdestar ligjor, organizatë ose autoritet ligjor që do të veprojë në emër të interesave më optimale të këtij fëmije;
 - do të marrë hapat e nevojshëm për të përcaktuar identitetin dhe kombësinë e tij/saj;
 - do të bëjë çdo përpjekje për të lokalizuar familjen e tij/saj, kur kjo është në interesat më optimale të fëmijës.”

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, në Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, shprehet se:

“Mosidentifikimi si duhet i një personi të trafikuar ka gjasë të rezultojë në një mohim të mëtejshëm të të drejtave të atij personi. Për këtë arsye, Shtetet kanë detyrimin të sigurojnë që ky identifikim mundet të bëhet dhe do të bëhet.”

Neni 27 (1)(b) i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar 2000 identifikon se:

Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin, në përputhje me sistemet e tyre përkatëse ligjore dhe administrative, për të rritur efektivitetin e zbatimit të ligjit në luftë kundër veprave penale të përfshira në këtë Konventë. Çdo Shtet Palë, duhet të miratojë në veçanti, masa efektive për:

Bashkëpunimin me Shtete të tjera Palë në kryerjen e hetimeve mbi veprat penale të përfshira në këtë Konventë që kanë të bëjnë me:

Identitetin, vendndodhjen dhe veprimtaritë e personave të dyshuar për përfshirje në vepra të tilla penale ose vendndodhjen e personave të tjerë të implikuar;

Kur bëhet vlerësimi nëse një individ është viktimë apo jo, kërkohet vetëm shkaqe të arsyeshme dhe jo provë absolute.

Në disa raste, do të jetë e qartë nga informacioni i disponueshëm se personi është viktimë. Në raste të tjera, situata do të jetë më pak e sigurt. Në këto raste, duhet t'i besohet fjalës së personit deri sa të qartësohet statusi i tyre me anë të hetimeve të mëtejshme. Po ashtu, kur nuk është e qartë nëse personi është fëmijë (nën moshën 18 vjeç), duhet të trajtohet si i tillë deri sa të përcaktohet mosha e saktë.

Identifikimi i trafikimit të qenieve njerëzore nuk është një proces i lehtë. Trafikantët bëjnë përpjekje të konsiderueshme për t'u siguruar që veprimtaritë e tyre të mos zbulohen lehtë. Nuk ka mundësi që të gjitha rastet e trafikimit të jenë të njëjta. Treguesit e trafikimit me shumë gjasë mund të jenë të ndryshëm nga rasti në rast.

Identifikimi mund të jetë një proces afatgjatë. Një incident mund të tregojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme se po ndodh trafikim i personave, por në shumë raste mund të ketë vetëm një apo dy Tregues. Zakonisht, ka shumë pak informacion konkret apo shenja të dukshme të trafikimit të qenieve njerëzore. Shpesh, ka vetëm një ndjenjë ngacmuese se jeni përballë një rasti trafikimi. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ngatërrohet lehtë me forma të tjera kriminaliteti si për shembull, kontrabandimi i migrantëve, sulme seksuale apo të thjeshta. Efekti i traumatizimit të viktimat e trafikimit është i tillë sa që ata mund të mos tregojnë asgjë nga situata tyre për javë apo edhe për muaj të tërë.

Viktima mund të kontaktojë drejtpërdrejtë një patrullë policie apo të shkojë në një rajon policie dhe të raportojë situatën e tij apo të saj. Organizata të tjera mundet dhe në të vërtetë kanë referuar shumë viktima pranë agjencive ligjzbatuese në të gjithë botën. Shumë prej referimeve kanë ardhur nga OJQ-të, shpesh ato që kanë për objekt specifik të veprimtarisë luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në rastet e trafikimit të personave për qëllime të shfrytëzimit seksual, janë parë edhe raste të "shpëtimit nga klientët". Një shembull i shpëtimit nga klientit është kur një burrë paguan për marrëdhënie seksuale me një femër dhe ajo i tregon atij se është e trafikuar. Klienti mund ta marrë gruan e ta çojë në polici ose në një agjenci tjetër ose ta largohet vetë dhe e raporton çështjen.

Qytetarë të tjerë që nuk janë klientë "kanë shpëtuar" viktima dhe i kanë sjellë në vëmendje të policisë apo agjencive të tjera.

Identifikimi i viktimave të trafikimit nuk është objekt veprimtarie vetëm i Policisë apo i ndonjë agjencie tjetër ligjzbatuese, pasi trafikimi i qenieve njerëzore është një krim i rëndë, shpesh lidhet me krimin e organizuar. ndaj është e nevojshme që oficerët ligjzbatues të jenë në gjendje të identifikojnë një viktimë trafikimi në të njëjtën mënyrë që ata janë në gjendje të identifikojnë forma të tjera kriminaliteti.

3.2.2 IDENTIFIKIMI I VIKTIMËS SË MUNDSHME OSE VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT NGA STRUKTURAT E POLICISË

Në legjislacionin shqiptar, treguesit e trafikimit shtjellohen hollësisht në dokumentin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.

Në bazë të këtyre procedurave, procesi i identifikimit të një viktime trafikimi kalon në dy faza kryesore:

- në identifikimin fillestar; dhe
- identifikimin formal.

Procesi në vetvete nuk është thjesht një veprim burokratik, por shoqërohet me marrjen e masave konkrete në lidhje me rastin, siç shprehet dhe në vetë formulimin e konceptit ku fjala “reagim” shoqëron fjalën identifikim. Masat reaguese, pra ndjekja e rastit me hapa konkrete kryesisht të orientuara drejt asistencës fillestare janë të domosdoshme veçanërisht në çështjet e trafikimit të fëmijëve, ku marrja e menjëhershme në mbrojtje e fëmijës që është në një situatë rreziku, pavarësisht nëse më vonë zbulohet që është ose jo viktimë trafikimi, është parimi që duhet të udhëheqë vendimmarrjen e çdo profesionisti në një rast të mundshëm trafikimi të fëmijës.

Procedurat Standarde të Veprimit cilësojnë si “Identifikim dhe reagim fillestar” tërësinë e veprimeve të ndërmara nga punonjësit e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e personave të trafikuar në kufijtë dhe brenda territorit të RSH-së, si të institucioneve vendore, ashtu edhe qendrore që bën të mundur përcaktimin se një person i/e mitur apo i/e rritur është viktimë e mundshme e trafikimit të personave.

Mjetet e identifikimit fillestar janë treguesit dhe intervista: në rast se në sjelljen dhe paraqitjen e personit ka elemente që janë të përfshira në listën e treguesve, atëherë personi kalohet në intervistë fillestare. Përsa i përket “Identifikimit formal”, ai është identifikimi i një personi si viktimë trafikimi, i kryer vetëm nga Grupi/Struktura përgjegjëse për identifikim formal në bazë të formatit të intervistës formale të përfshirë në këto procedura. Në dallim nga identifikimi fillestar, i cili bazohet në një listë treguesish dhe intervistë të personit, mjeti i vetëm i identifikimit formal është intervista formale/zyrtare.

3.3 SITUATA KUR KA GJASË TË HASEN VIKTIMA TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Identifikimi i trafikimit të qenieve njerëzore mund të jetë një proces afatgjatë. Një incident mund të tregojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme se po ndodh trafikim i personave, por në shumë raste mund të ketë vetëm një apo dy tregues. Zakonisht, ka shumë pak informacion konkret apo shenja të dukshme të trafikimit të qenieve njerëzore. Shpesh, ka vetëm një ndjenjë ngacmuese se jeni përballë një rasti trafikimi.

Trafikimi i qenieve njerëzore mund të ngatërrohet lehtë me forma të tjera kriminaliteti si për

shembull, kontrabandimi i migrantëve, sulme seksuale apo të thjeshta. Efekti i traumatizimit të viktimave të trafikimit është i tillë sa që ata mund të mos tregojnë asgjë nga situata tyre për javë apo edhe për muaj të tërë.

Raportimi i drejtpërdrejtë nga viktimat dhe njerëz të tjerë

Viktima mund të kontaktojë drejtpërdrejtë një patrullë policie apo të shkojë në një rajon policie dhe të raportojë situatën në të cilën ndodhen. Organizata të tjera mundet dhe në të vërtetë kanë referuar shumë viktima pranë agjencive ligj zbatuese në të gjithë botën. Shumë prej referimeve kanë ardhur nga OJQ-të, shpesh ato që kanë për objekt specifik të veprimtarisë luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Në rastet e trafikimit të personave për qëllime të shfrytëzimit seksual, janë parë edhe raste të “shpëtimit nga klientët”. Një shembull i shpëtimit nga klientit është kur një burrë paguan për marrëdhënie seksuale me një femër dhe ajo i tregon atij se është e trafikuar. Klienti mund ta marrë gruan e ta çojë në polici ose në një agjenci tjetër ose të largohet vetë dhe e raporton çështjen.

Qytetarë të tjerë që nuk janë klientë “kanë shpëtuar” viktima dhe i kanë sjellë në vëmendje të policisë apo agjencive të tjera.

Veprimtari policore rutinë

Veprimtari rutinë të policisë ai prania në incidente që nuk lidhen drejtpërdrejt me trafikimin, p.sh. vjedhje në shtëpi, aksidente rrugore, dhe raporte për prishje të rendit publik janë raste të mundshme për të identifikuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe reaguesit e parë duhet të jenë të vetëdijshëm se këto situata mund të përfshijnë trafikimin e qenieve njerëzore, për shembull:

- Veprimtari rutinë në vendkalimet e kufirit dhe postbllloqe;
- Raportime kur viktimat e trafikimit janë viktimë e një krimi tjetër;
- Veprimtari të policisë dhe veprimtari të tjera ligjzbatuese, si për shembull kontrollet e personit dhe të automjetit dhe ekzaminim rutinë të dokumenteve;
- Vizita rutinë në mjedise ku viktimat ka gjasë të shfrytëzohen, p.sh. në shtëpi publike, fabrika apo mjedise bujqësore;
- Shikim rutinë i njoftimeve në media, përfshirë në internet;
- Policimi në komunitet në zona të banuara nga pakica apo imigrantë;
- Aplikime për viza dhe dokumente udhëtimi në ambasada dhe konsullata;
- Hetime dhe kërkime për fëmijë të humbur.

Veprimtari proaktive

Operacione proaktive, shpesh të udhëhequra nga informacione, kanë provuar se janë të suksesshme për identifikimin dhe rikuperimin e viktimave të trafikimit. Disa shembuj përfshijnë:

- Kontrolle që targetojnë mjedise dhe vende të dyshuara, të tilla si fabrika, miniera, shtëpi publike dhe veprimtari bujqësore.
- Organizimi i kontrolleve të përbashkëta me institucione të tjera si Inspektorati Shtetëror

i Punës⁴⁰ për të vëzhguar kushtet e punës, për të identifikuar raste të punësimit të paligjshëm apo të minorenëve pa autorizim përkatës ;

- Operacione me veprime testuese (kur lejohet sipas legjislacionit tuaj) për të përcaktuar se çfarë po ndodh dhe kush është i përfshirë në një veprimtari të caktuar;
- Vëzhgimi dhe teknika të tjera speciale të hetimit;
- Operacione të planifikuara në PKK ose kufirin e gjelbër ku dyshohet se mund të përdoret për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme.

Duke marrë në konsideratë mjediset në të cilat mund të identifikohet një viktimë trafikimi, d.m.th. disa prej 'mjedisëve operacionale' të përshkruara më lart, gjasat që punonjësi i policisë të ketë kohën dhe kushtet për të bërë një vlerësim dhe për të marrë një vendim do të jenë të pakta.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që punonjësit e policisë të informohen dhe trajnohen që si prioritet të kenë trajtimin e menjëhershëm të një personi që po shfrytëzohet ose është në rrezik të shfrytëzohet.

Procesi i vlerësimit dhe vendimmarrjes në këto situata njihet si 'intervista analizuese'.

Procesi i analizimit përbëhet nga dy faza të cilat punonjësi i policisë që ka ndërhyrë l pari do t'i 'vendosë në veprim' gjatë kontaktit me viktimën e mundshme të trafikimit dhe ka gjasë të jetë diçka që ndërmerret me anë të një bashkëbisedimi të shkurtër. Fazat janë si më poshtë:

1. Vlerësim i Treguesve të dukshëm
2. A ka element të veprës penale të trafikimit

Nëse procesi plotësohet, atëherë punonjësi i policisë ka identifikuar një viktimë të mundshme të trafikimit dhe duhet të veprojë në përputhje me PSV-të në fuqi.

3.4 INTERVISTA FILLESTARE

Qëllimi i Intervistës fillestare në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore është të identifikohet nëse ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se një person është trafikuar apo po trafikohet.

Zakonisht vendimi për të kryer intervistën fillestare merret pas identifikimit të disa treguesve të trafikimit.

Kontakti fillestar me personin mund të rezultojë nga një raportim apo ankesë se dikush është trafikuar, një operacion i paraplanifikuar si për shembull kontrolli në një bar apo inspektim në një fabrikë, kontroll rutinë i personave në një Pikë Kalimi Kufitar apo veprime të tjera rutinë.

Intervista fillestare kryhet si bashkëbisedim për t'i dhënë intervistuesit informacion të mjaftueshëm si dhe për të vendosur nëse është i nevojshëm një reagim më i gjerë nga organet e zbatimit të ligjit.

Sfidat me të cilat mund të përballen një punonjës i policisë që ndërhyrë l pari, janë:

- Koha në dispozicion - shumë shpesh, nuk ka mjaft kohë në dispozicion, p.sh. radhë/

⁴⁰ Shih marrëveshjen e përbashkët KK-Polici-ISHPSSH (OSBE)

numër i madh personash në hyrje apo dalje në PKK në aeroport

- Vendndodhja - mjedisi mund të mos lejojë një bisedë në një vend të qetë e të veçuar, p.sh. në anë të rrugës, në bar, në vendin e punës, në një automjet
- Privatësia - lidhet me vendndodhjen po më së pari lidhet me realizimin e bisedës në praninë e të tjerëve, p.sh. trafikantëve, dhe mundësinë e tyre për të dëgjuar.
- Kompetenca ligjore - a është i lejueshëm një ndalim i shkurtër dhe intervista
- Treguesit - disa mund të jenë të pranishëm por jo konkludues

Duke qenë se ka mundësi që të ketë edhe kufizime për faktin se çfarë mund të ndërmerret, intervista fillestare duhet të realizohet si një “bisedë e menaxhuar”. Nuk është efikase ta ftosh personin për të biseduar dhe të shpresosh se ata do të të japin informacionin që të nevojitet për të marrë një vendim. Objektivi i intervistës është që të konfirmojë dyshimin fillestar ose për të përcaktuar se nuk nevojiten veprime të mëtejshme.

Pyetje të hapura dhe të mbyllura

Në këtë aspekt, strategjia do të ishte që të përdoren pyetje ‘të hapura’ dhe ‘të mbyllura’ për të përcaktuar nëse janë të pranishme elementet e trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përcaktimeve ligjore, d.m.th. Veprimi, Mjeti dhe Qëllimi.

Pyetjet e hapura fillojnë me - Kush, Çfarë, Pse, Ku, Kur dhe Si.

Pyetjet e mbyllura janë ato që zakonisht marrin përgjigje ‘Po’ ose ‘Jo’, përgjigje këto që konfirmojnë apo qartësojnë atë që tashmë dihet apo dyshohet.

Intervista analizuese nuk duhet t’i referohet drejtpërdrejt një dyshimi për trafikim apo shfrytëzim.

Për shembull, kur bëhet pyetja ‘A je trafikuar’, shumë njerëz nuk e dinë se çfarë do të thotë “trafikuar”.

Pyetjet për qëllimin e udhëtimit, të prezencës së tyre në atë vend, planet e tyre për të ardhmen, kushtet e punësimit, shoqërimi me persona të tjerë, etj. kërkojnë një përgjigje që mund të zhvillohet më tej dhe/ose konfirmohet.

Linjat e pyetjes duhet të lidhen me elementet e:

- “Veprimi”: Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja dhe pritja, të cilat mund të përkufizohen si pyetje rutinë dhe në varësi të rolit të intervistuesit janë pyetje të pritshme, p.sh. punonjësi i kufirit, oficer i patrullës .
- “Mjetet” si element të veprës penale, me gjasë nuk do të përcaktohen gjatë intervistës në këtë fazë por treguesit e mjeteve mund të jenë të pranishëm në gjuhën e trupit dhe në sjelljen e personave që merren në pyetje. Ose, në gjuhën e trupit dhe sjelljen e atyre personave që shoqërojnë individin me të cilin po merreni.

Do të jetë një ndërthurje e përgjigjeve të marra për pyetjet e bëra dhe treguesit e pranishëm që do t’ju mundësojnë të bëhet një vlerësim.

Në rastet kur intervista fillestare zhvillohet si rezultat i një referimi, është e mundur që të zhvillohet një intervistë në një mjedis të kontrolluar me mundësinë që të kalohet më shumë kohë për të përcaktuar faktet.

Qëllimi, gjithësesi, mbetet i njëjtë:

Identifikimi nëse ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar që një person ka qenë apo është trafikuar

Procedurat Standarde të Veprimit shprehen në lidhje me intervistën fillestare:

Intervista: Mbledhja e informacionit për të përcaktuar nëse personi është viktime e mundshme e trafikimit

Veprimet e intervistuesve	Zhvillimi	Detaje/arsyetimi për PO, JO
	Trafikimi	
Personi është pyetur dhe u krijua dyshimi që ka patur rekrutim nëpërmjet mashtrimit...		Lloji i rekrutimit
Personi është pyetur dhe është krijuar dyshimi se personi është bindur apo i është detyruar zhvendosja me qëllim përfshirjen në punë apo veprimtari të paligjshme për përfitim apo rritje të përfitimeve të shfrytëzuesve	PO/JO	Itinerari i zhvendosjes Aktiviteti i personit para zhvendosjeve Aktiviteti i personit para zhvendosjeve
Personit i është shprehur dyshimi që është viktimë e trafikimit dhe ai/ajo ka rënë dakort me të	PO/JO	

3.5 KOMUNIKIMI ME NJË VIKTIMË TRAFIKIMI

Në fazën e hetimit, kur oficerët e policisë kontaktojnë për herë të parë me një viktimë trafikimi, ata duhet të përdorin disa masa që nxisin besimin e viktimës. Disa prej hapave bazë përfshijnë si më poshtë:

- Informohuni mbi të drejtat që gëzojnë viktimat e mundshme të trafikimit dhe shërbimet që ofrohen për këtë kategori. Njihuni me mekanizmat që ofrojnë mbrojtje dhe informohuni si mund të referoni një viktimë trafikimi pranë ofruesve të shërbimeve. Në këtë mënyrë mund t'i jepni informacionin e nevojshëm një viktime të mundshme dhe të krijoni një raport që do ndihmojë më tej bashkëpunimin tuaj për hetimin.
- Gjithmonë tregojini viktimës se kush jeni dhe cili është roli juaj në të gjithë procesin. Në rastet kur përfshihen dhe prezantohen profesionistë të tjerë me viktimën, identifikojini ata dhe shpjegoni rolet e tyre përkatëse ose kërkojuani ta bëjnë vetë këtë.
- Sigurohuni që të keni një përkthyes kompetent dhe të paanshëm, të informuar për rëndësinë e ruajtjes së konfidencialitetit për intervistën ku do të marri pjesë, në rast se nevojitet një përkthyes.
- Kurdoherë që të jetë e mundur, informojeni viktimën në lidhje me çfarë po ndodh dhe se pse kjo po ndodh. Dhënia e këtij informacioni do të rrisë besimin ndaj jush dhe do të shtojë mundësinë që viktimat të bashkëpunojnë në hetim si dhe të dëshmojnë gjatë procesit gjyqësor.
- Viktima do të informohet menjëherë mbi të drejtat e saj dhe mbështetjen që ofrohet duke i cilësuar që mbështetja në asnjë rast nuk kushtëzohet nga bashkëpunimi i saj/tij me organet e zbatimit të ligjit.

- Asnjëherë mos bëni premtime për ndihmë të cilat nuk mund t'i mbani.
- Kushdo që është i përfshirë në procesin e drejtësisë penale (përfshirë punonjësit e policisë, prokurorët, dhe oficerët e policisë gjyqësore) duhet të komunikojë në mënyrë të qartë në një gjuhë që viktima e kupton.
- Verifikoni informacionin e dhënë dhe sigurohuni që viktima e kuptoi atë që iu tha. Ftojini viktimën të bëjë pyetje për të siguruar dialog dhe mirëkuptim të ndërsjellë. Nëse nuk ka përgjigje, mos kërkoni me detyrim. Nëse është e mundur, ndërrojeni mënyrën e intervistimit. Lejoni një periudhë kohe të shkurtër rikuperimi dhe merrni në konsideratë ta verifikoni sa ka kuptuar më vonë.
- Mund të përdorni fletëpalosje informuese që mund të jenë të dobishme për viktimën. Viktima duhet të jetë në gjendje t'i lexojë dhe t'i kuptojë këto fletëpalosje.
- Tregoni kujdes se viktima mund të vuajë nga trauma. Ndërkohë që mbani parasysh ndikimet e mundshme të traumës mbi aftësinë e viktimës për të treguar saktë ngjarjet, theksoni nevojën dhe vlerën për të pasur rrëfim të detajuar, koherent, dhe të saktë të ngjarjeve që çuan në rrethanat aktuale të tij/saj.
- Çdo proces hetimor ndërhyrës që kërkon vlerësim dhe ekzaminim fizik dhe psikologjik duhet të bëhet vetëm me pëlqimin e informuar të viktimës. Viktima duhet të informohet për hapat dhe procesin e përfshirë dhe se pse kërkohet një gjë e tillë. Heshtja e viktimës nuk duhet të merret për pëlqim.
- Privatësia, identiteti i viktimës dhe informacioni i zbuluar gjatë procesit të ekzaminimit dhe vlerësimit duhet të ruhet si konfidencial. E drejta e saj ose e tij për privatësi dhe konfidencialitet në përputhje me legjislacionin tuaj duhet të ruhet gjatë gjithë kohës përgjatë hetimit.

Rekomandohet që materiale informuese të përgatiten në gjuhë të ndryshme në lidhje me të drejtat, asistencën në dispozicion dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit . Ky informacion i regjistruar duhet të mbahet në ambientet e policisë, etj., në mënyrë që viktimat ta kenë të lehtë qasjen në to.

3.6 IDENTIFIKIMI I FËMIJËS VIKTIMË E TRAFIKIMIT

Një prej aspekteve kryesore të parimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në çështjet e trafikimit është identifikimi i shpejtë dhe i saktë i tyre si viktima të trafikimit dhe sigurimi i mbrojtjes së menjëhershme. Identifikimi i një të mituri viktimë e trafikimit ose Viktimë e Mundshme e Trafikimit është një proces i gjatë dhe kompleks për shkak të natyrës komplekse që ka ky krim dhe ndërveprimet të disa personave. Identifikimi mund të bëhet nga strukturat e policisë, punonjësit socialë, etj, bazuar në një sërë treguesish, si në rastin e të rriturve dhe procedurash zyrtare si përsa i përket identifikimit dhe referimit të rastit. Procesin e identifikimit bazohet në treguesit e trafikimit, të cilët janë elemente përshkruese të procesit të trafikimit dhe reflektojnë paraqitjen e efekteve/pasojave të trafikimit tek i mituri.

Treguesit e trafikimit në vetvete nuk janë prova se trafikimi është kryer si vepër penale, por konsiderohen si pikënisje për hetime të trafikimit. Treguesit e trafikimit i shërbejnë kryesisht strukturave që kanë ballafaqimin e parë me një viktimë të mundshme trafikimi dhe duhet t'i zërthejnë këta tregues për të kryer identifikimin e një viktime trafikimi dhe/ose për të nisur hetimin e rastit. Njohja me treguesit e trafikimit dhe procesin e identifikimit fillestar të viktimës së trafikimit mund t'i shërbejë punonjësve të sistemit të drejtësisë për të kryer veprime më të thelluara në lidhje me çështjen dhe nëse përbën një rast trafikimi. Sipas dokumentit të Treguesve të Trafikimit të Qenieve Njerëzore të përgatitur nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimet treguesit kryesorë në rastin e fëmijëve të trafikuar janë si më poshtë:

- fëmijët janë shkëputur nga prindërit ose kujdestarët e tyre
- fëmijët janë të frikësuar dhe sillen në mënyra që nuk korrespondojnë me sjelljen tipike për fëmijët në moshën e tyre
- fëmijët nuk kanë shokë bashkëmoshatarë të tyre jashtë ambientit ku gjenden.
- fëmijët nuk janë në shkollë
- fëmijët nuk kanë kohë për të luajtur
- fëmijët jetojnë pa prani fëmijësh të tjerë dhe në kushte banimi jo të përshtatshme
- fëmijët ushqehen veçmas anëtarëve të tjerë të “familjes” së tyre
- U jepen për të ngrënë vetëm ushqime të mbetura nga konsumimi i të tjerëve
- fëmijët janë të angazhuar në punë që nuk janë të përshtatshme për fëmijët
- Udhëtojnë të pashoqëruar nga të rritur
- Udhëtojnë në grup me persona që nuk janë të afërm të tyre⁴¹

KUJDES!

Interesi më i lartë i fëmijës prevalon mbi balancimin e interesave të procesit të drejtësisë, identifikimin dhe sjelljen e trafikantëve para drejtësisë.. Siguria e tyre nuk duhet të vihet asnjëherë në rrezik nga veprimet e organeve të zbatimit të ligjit dhe statusi i tyre si viktimë duhet të garantohet e përmbushet. Fëmijët nuk duhet në asnjë rast të diskriminohen për shkak të statusit të tyre ligjor në vendin ku realizohet procesi i drejtësisë, shtetësisë, natyrës së veprës penale, etj.

Kini para sysh se ligji “Për policinë e shtetit”⁴² ju detyron:

- Të merrni masat e nevojshme për mbrojtjen e të miturit të braktisur nga prindi apo që është larguar nga prindi apo kujdestari i tij.
- Punonjësi i policisë e referon rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës për vlerësim.
- I mituri i rikthehet prindit, kujdestarit, pasi vlerësohet më parë mospërfshirja e tyre në abuzimin ndaj të miturit.
- I mituri dërgohet në qendrat e përkujdesjes për të miturit kur vlerësohet se është i abuzuar ose i braktisur nga prindi ose kujdestari i tij.
- I mituri mbahet në ambientet e policisë për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 10 orë. Kushtet e mbajtjes së të miturit duhet të mbajnë parasysh nevojat e moshës dhe ato psikologjike.
- Punonjësi i policisë bashkëpunon me qendrat e përkujdesjes sociale për të miturit për ofrimin e asistencës së nevojshme ndaj të miturit.

⁴¹ https://www.unodc.org/pdf/HT_indicators_E_LOËRES.pdf

⁴² Neni 123 “Masat mbrojtëse”, ligji “Për policinë e shtetit”

Sipas ligjit janë disa struktura që kanë detyra të posaçme në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë të veçantë:

- Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës; dhe
- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës.

Në bazë të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur dhe legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës luan një rol thelbësor në çdo rast kur fëmija bëhet viktimë e veprës penale.

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës funksionon në çdo bashki dhe ka për detyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Është Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki struktura që harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ia dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës.⁴³

KUJDES:

Lista e përfaqësuesve e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal përgatitet dhe rishikohet çdo vit nga ana e Njesisë për mbrojtjen e fëmijës në bashki dhe dërgohet çdo vit pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykatës së rrethit gjyqësor e të apelit përkatës. Njësia për mbrojtjen e fëmijës funksionon pranë bashkisë si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka detyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Nëse rastet kur fëmija nuk ka prind apo kujdestar, punonjësi i policisë vë në dijeni Njësinë për mbrojtjen e fëmijëve dhe organizatat e shoqërisë civile për të drejtat e fëmijëve.⁴⁴

3.6.1 IDENTIFIKIMI DHE RAPORTIMI I FËMIJËS VIKTIMË E MUNDSHME OSE VIKTIMË TRAFIKIMI NGA STRUKTURAT E POLICISË

Sipas UNICEF, masat proaktive për identifikimin e fëmijëve viktimë trafikimi përfshijnë⁴⁵:

- Procedura efektive për identifikimin e shpejtë të fëmijëve viktimë
- Bashkërendimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet strukturave shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Procedura të posaçme në kufi dhe brenda territorit për identifikimin e fëmijëve viktimë nga ana e policisë;
- Njoftimi i menjëhershëm i organeve të policisë nga shërbimet shoqërore, shëndetësore dhe arsimore, si dhe organizatat e shoqërisë civile, që kanë informacion ose dyshim se një fëmijë është në rrezik apo është i shfrytëzuar ose i trafikuar.

⁴³ Ligji 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".

⁴⁴ Neni 101 pika 2 ligji nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit"

⁴⁵ Përshtatur nga UNICEF "Reference Guide on Protecting the Rights of Child Victims of Trafficking in Europe", 2004.


Si në rastin e të rriturve, treguesit e trafikimit të fëmijëve gjenden në dokumentin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 499, datë 29.8.2018.

Identifikimi i një viktime trafikimi në Shqipëri priorizon dhënien e ndihmës pa vënë kushte që viktima të ketë kontakt me autoritetet e zbatimit të ligjit, e të bashkëpunojë për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikantëve. Identifikimi ka dy faza, faza e identifikimit të hershëm apo fillestar dhe faza e identifikimit formal apo zyrtar.

Me qëllim që të zgjerohet mundësia e kontaktit dhe të përshpejtohet aksesimi i një viktime tek ndihma, identifikimi fillestar i është ngarkuar një numri të madh institucionesh dhe agjencish. Këto agjenci apo institucione mund të arrijnë në konkluzionin se një person është viktimë e mundshme e trafikimit duke u mbështetur në tregues të identifikimit dhe duke zhvilluar një intervistë të thjeshtë që quhet intervista fillestare. Viktimë “e mundshme” ka kuptimin që “të gjitha të dhënat të tregojnë se personi është i/e trafikuar”.

Identifikimi formal apo zyrtar i është ngarkuar vetëm një grupi të kufizuar ad hoc të përbërë gjithmonë nga një punonjës i policisë antitrafik dhe një punonjës social i drejtorisë rajonale të shërbimit social shtetëror në rastin kur personi që mund të jetë trafikuar është i rritur ose një punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve kur personi që mund të jetë trafikuar është fëmijë.

FAZAT E IDENTIFIKIMIT TË VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT



Duke marrë në konsideratë se lloji i kontaktit, sjellja dhe informacioni i ndarë mes individëve dhe institucioneve është i ndryshëm, PSV-të japin tregues të ndryshëm për struktura e sektorë të ndryshëm.

Udhëzimi i posaçëm i Prokurorisë së Përgjithshme, “Për garantimin e ndihmës për viktimat dhe dëshmitarët e krimeve”, nr. 05, datë 26.10.2018.

Sipas nenit 15 të Udhëzimit prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë janë të detyruar nga ligji dhe udhëzimi të identifikojnë viktimat e krimet, t’i njoftojnë për të drejtat dhe t’u ofrojnë asistencën e përshkruar në këtë udhëzim duke mbajtur parasysh gjithsesi se viktima nuk është e detyruar t’i ushtrojë të drejtat e saj apo ta pranojë këtë asistencë dhe mund të zgjedhë, në çdo fazë të procedimit penal, të refuzojë marrjen e asistencës ose ushtrimin e të drejtave.

3.7 TRAUMA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

3.7.1 DHUNA DHE DËMTIMI NË NJË SITUATË TRAFIKIMI

Gratë u pyetën për përvojat e tyre të dhunës fizike, dhunës seksuale, kërcënimeve, dhe kufizimeve të lëvizjes së tyre ndërkohë që ishin të trafikuar. Pothuajse të gjitha gratë (95%) raportuan dhunë fizike ose seksuale, tre të katërtat e të intervistuarave ishin lënduar fizikisht, dhe 90% raportuan se ishin sulmuar seksualisht. Pjesa më e madhe e grave raportoi gjithashtu kërcënime të dhunës ndaj tyre (89%) dhe shumë raportuan kërcënime për fëmijët e tyre dhe familjen (36%). Pothuaj tre të katërtat e grave (77%) raportuan se ato nuk kishin liri lëvizjeje, dhe ato që raportuan një shkallë lirie përgjithësisht përshkruan se ishin të shoqëruara për të parandaluar arratisjen e tyre⁴⁶.

Pjesa më e madhe e studimit për shëndetin e personave të trafikuar ka qenë me gra të shfrytëzuara seksualisht. Ka më pak të dhëna për pasojat në shëndet të trajtave të tjera të trafikimit. Megjithatë, natyra shfrytëzuese e trafikimit, dhe gjasat për të punuar në kushte të rrezikshme padyshim kanë efekte kumulative për shëndetin.

Ndikimet kryesore në shëndet përfshijnë:

- Ekspozim ndaj sëmundjeve infektive
- Abuzim i përsëritur fizik, seksual dhe/ose psikologjik
- Privim kronik - p.sh. nga ushqimi, gjumi, strehimi
- Rreziqe të dëmshme - p.sh. ajrim i keq, kushte sanitare, ekspozim ndaj kimikateve, ndotës bakterial/në ajër; makineri të rrezikshme, mungesë e pajisjeve mbrojtëse, etj.
- Kushte shëndetësore para ekzistuese - marrë parasysh rrugën e ndjekur deri në trafikim, disa viktima kanë çështje shëndetësore ekzistuese që përkeqësohen nga trafikimi

Shëndeti jo i mirë mendor është një dukuri e zakonshme te viktimat e trafikimit për shkak të traumës dhe abuzimit që kanë përjetuar. Çrregullimi Kompleks i Stresit Pas Traumës (CPTSD) mund të ndodhë shpesh si pasojë e trafikimit të qenieve njerëzore. Simptomat kyçe përfshijnë ripërjetimin e ngjarjes/ve traumatike, shmangien e mendimeve/kujtimeve/situatave që sjellin në kujtesë ngjarjen/t dhe perceptimin e vazhdueshëm të kërcënimit të madh.⁴⁷

⁴⁶ *Stolen smiles: a summary report on the physical and psychological health consequences of women and adolescents trafficked in Europe – Zimmerman 2006 [Buzëqeshje të vjedhura: raport përmbledhës për pasojat e shëndetit fizik dhe psikologjik të grave dhe adoleshentëve të trafikuar në Evropë - Zimmerman 2006]*

⁴⁷ *Human trafficking and exploitation: guidance for health worker: Scottish Government October 2019 [Trafikimi dhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore: udhëzues për punonjësit shëndetësor: Qeveria skoceze tetor 2019]*

Rast i raportuar nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës

L. është një djalë 12 vjeçar, i cili lyp në Tiranë. Prindërit e tij janë të papunë në Tiranë, në kushte shumë të vështira social-ekonomike. Fëmija deklaroi se babai është i dhunshëm dhe se shpesh ai e rreh. Në kohën e identifikimit në situatë rruge, në vitin 2018, ai u gjet në gjendje intoksikimi. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës u shpreh se ai qëndron në shoqërinë e një mashkulli në moshë madhore, i njohur si trafikues i disa djemve të rinj për qëllime lypjeje. Gjatë një interviste të përbashkët nga policia, shërbimi social shtetëror dhe njësia e mbrojtjes së fëmijës, L bëhej shumë agresiv sa herë i përmendej familja, duke shfaqur nivele të larta të stresit emocional. Në mënyrë të përsëritur ai kërkonte që familja të mos njoftohej sepse i frikësohej abuzimit fizik që mund të pësonte më pas. Ai nuk donte të kthehej pranë familjes së tij. Autoritetet e klasifikuan si viktimë të mundshme të trafikimit dhe ai u referua për asistencë në shtëpinë e fëmijës në Tiranë. Rasti u referua në Prokurori⁴⁸.

3.7.2 TREGUESIT E TRAUMËS DHE ABUZIMIT

Një pjesë e madhe, në mos të gjithë personat e trafikuar kanë kaluar një përjetim traumatik. Ndërsa disa njerëz mund të duan të flasin, të tjerë nuk do të duan dhe nuk duhet të vendosen në presion. Megjithatë, të vetëdijshëm për shenjat që mund të tregojnë trauma dhe abuzim mund të ndihmojë për identifikimin dhe mbështetjen e atyre në këto situata⁴⁹.

Treguesit mund të përfshijnë:

- Gjurmë shumë i keq/makthe
- Duket i/e brengosur
- Mund të duket në fillim se është person i vështirë për ta ndihmuar - asgjë nuk duket se ndihmon shumë
- Të kujdesshëm ndaj autoriteteve
- Hezitues ose i/e shqetësuar me mjedisin rrethues
- Tregon zemërim, brengë, dobësi ose pasiguri
- Mospërputhje në tregimin e ngjarjeve
- Dhimbje koke, dhimbje mesi dhe qafe, dhe probleme gastrike

PTSD⁵⁰

Çrregullimi i stresit post traumatik (PTSD) është një çrregullim ankthi i shkaktuar nga ngjarje shumë stresuese, frikësuese apo shqetësuese.

Një person që vuan nga PTSD shpesh e çliron ngjarjen traumatike në formën e maktheve dhe rikujtesës, dhe mund të përjetojë ndjenja izolimi, irritimi dhe faji.

PTSD-ja mund të zhvillohet menjëherë pasi personi përjeton një ngjarje shqetësuese, ose mund

48 Tipologji e Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri, Prezenca e OSBEsë 2020.

49 Recognise survivors of trauma, trafficking and exploitation – Migrant Health, April 2019 [Dallo të mbijetuarit e traumës, trafikimit dhe shfrytëzimit - Shëndeti i Migrantëve Prill 2019]
http://scholar?q=Recognise+survivors+of+trauma,+trafficking+and+exploitation+%E2%80%93+Mi-grant+Health+April+2019&hl=en&as_sdt=0&as_vis=1&oi=scholar

50 UK National Health Service (NHS) PTSD Overview [Shërbimi Kombëtar i Shëndetit i MB Vështrim i përgjithshëm mbi PTSD-në]

të ndodhë javë, muaj apo edhe vite më pas.

Njerëzit që përjetojnë situata traumatike në mënyrë të përsëritur, si për shembull neglizhim, abuzim ose dhunë, mund të diagnostikohen me PTSD kompleks.

Përjetime të traumës

Disa viktime të trafikuar nuk vuajnë nivele të jashtëzakonshme abuzimi; megjithatë, sulmi, shtrëngimi, kërcënimi për të dëmtuara ata vetë dhe familjet dhe liri shumë e kufizuar janë dukuri të zakonshme. Gratë dhe vajzat ka më shumë të ngjarë të vuajnë më tepër se burrat dhe djemtë kur shfrytëzohen si prostituta me detyrim. Në të vërtetë, shumë prej taktikave kërcënuese që përdoren për të kontrolluar vajzat dhe gratë e trafikuar janë lehtësisht të krahasueshme me karakteristikat e abuzimit të përshkruara në literaturën për torturën.

Ashtu si edhe viktimat e torturës, vajzat dhe gratë në situatë trafikimi kanë pak mundësi për të parashikuar ose për të menaxhuar ngjarjet të cenojnë shëndetin dhe sigurinë e tyre. Shumë prej tyre nuk janë në gjendje, për shembull, të përcaktojnë se kur të punojnë apo të flenë, çfarë të hanë, sa klientë dhe cilët prej tyre të pranojnë, apo nëse do të mbrohen duke përdorur kondomë, dhe një numër domethënës i tyre janë subjekt i ndëshkimit të beftë fizik. “Paparashikueshmëria” dhe “pamundësia për kontroll” përshkruhen në teori se parashikojnë reagime më intensive apo të zgjatura psikologjike ndaj abuzimit⁵¹.

Efektet dhe pasojat e traumës

Viktima mund të shfaqë sjelljen e mëposhtme⁵²:

- Sjellje jomiqësore ndaj oficerit të policisë gjyqësore ose prokurorit (Viktima mund të ketë mësuar se çdo gjë që vë në rrezik dominancën e trafikantëve mund të çojë në dhunë të menjëhershme. Ata mund të shmangin bashkëpunimin me autoritetet ligjzbatuese ose gjyqësore);
- Mosbashkëpunim me hetimin ose ndjekjen penal
- Humbje e kujtesës, përhumbje, mospërputhje, që rezultojnë në:
- Ndryshime në rrëfimin e ngjarjes në kohë të ndryshme Pamundësi për të rikujtuar detaje
- Aftësi për të rikujtuar detaje qendrore të një incidenti traumatik, por jo detaje periferike si përshkrime të veshjeve, dhomave ose automjeteve
- Bllokim i ngjarjeve më kërcënuese për jetën (p.sh. veçimi njohur si disociimi)
- Shpërthime në dukje pa arsye
- Çorientim pas largimit nga një situatë traume dhe kontrolli të vazhdueshëm
- Vijimi i ankthit pavarësisht se duket që të jenë “të sigurt”
- Nevojë për më shumë pushime, prehje dhe gjumë nga sa mund të pritët
- Rindërtimi dhe kujtesa Për shumë viktime, ka një periudhë rindërtimi ndërsa ata përpunojnë se çfarë u ka ndodhur. Viktimat ri-interpretojnë ngjarjet dhe përpiqen të përballen me përjetimin e tyre, në mënyrë që të gjejnë mundësisht një shpjegim për atë që ka ndodhur apo për të vlerësuar ngjarjen.

⁵¹ *The Relationship of Trauma to Mental Disorders Among Trafficked and Sexually Exploited Girls and Women – American Public Health Association*

⁵² *Manuali i UNODC për antitrafikimin*

Tre elemente të traumës - Ngjarja, Përjetimi i Ngjarjes dhe Efekti.⁵³

Ngjarjet dhe rrethanat mund të përfshijnë kërcënimin aktual ose ekstrem të dëmit fizik apo psikologjik neglizhim që përbën kërcënim të jetës për një fëmijë që vë në rrezik zhvillimin e shëndetshëm. Këto ngjarje dhe rrethana mund të ndodhin një herë të vetme ose të përsëriten përgjatë kohës.

Përjetimi i këtyre ngjarjeve dhe rrethanave nga individi ndihmon për të përcaktuar nëse është një ngjarje traumatike. Një ngjarje e veçantë mund të përjetohet si traumatike për një individ të caktuar ndërsa një tjetër mund të mos preket në të njëjtën mënyrë. Ngjarjet traumatike, për nga natyra që kanë, krijojnë një diferencial pushteti, ku një subjekt (qoftë individ apo ngjarje e forcës së natyrës) ka pushtet mbi një tjetër. Ato ngrenë një pyetje të thellë “pse mua?”

Efektet negative të ngjarjes të zgjatura në kohë janë komponentë me rëndësi kritike për traumën. Këto efekte negative mund të ndodhin menjëherë ose mund të shfaqen në një kohë të mëvonshme. Kohëzgjatja e efektit mund të jetë afatshkurtër deri në afatgjatë. Në disa situata, individi mund të mos e kuptojë lidhjen midis ngjarjeve traumatike dhe efekteve.

Disa shembuj të efekteve negative përfshijnë pamundësinë e individit:

- për t'u përballur me strese normale dhe sforcime të jetës së përditshme;
- për të besuar dhe përfituar nga marrëdhëniet;
- për të menaxhuar procese kognitive, të tilla si kujtesa, vëmendja dhe të menduarit;
- për të rregulluar sjelljen; ose
- për të kontrolluar shprehjen e emocioneve.

Katër elemente të qasjes së mirëinformuar ndaj traumës

- Punonjësi arrin të dallojë gjërat bazë rreth traumës dhe e kupton se si trauma mund të prekë individët.
- Punonjësi arrin të njohë shenjat e traumës.
- Reagimi ndaj traumës është i mirinformuar.
- Shmang ritraumatizimin.

Qasja e mirë informuar për traumën është ajo që arrin të dallojë se viktimat e trafikimit kanë përjetuar trauma në të shkuarën dhe mund të preken ende prej tyre.

Përvetësimi i një qasjeje të mirë informuar për traumën nuk realizohet nëpërmjet një teknike apo listë kontrolli të vetme të veçantë. Ajo kërkon më shumë vëmendje, vetëdije për kujdesin, ndjeshmëri dhe mundësisht një ndryshim kulturor në nivel organizate.

⁵³ U.S. Department of Health and Human Services Substance Abuse and Mental Health Services Administration [Departamenti i Shtetit dhe Shërbimeve Njerëzore Administrata për Abuzimin me Substancat dhe Shërbimet Shëndetësore]

3.8 MBROJTJA E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

3.8.1 SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR, SHËNDËTËSOR DHE PSIKOLOGJIK PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI

Kuadri ligjor ofron një gamë të gjerë procedurash dhe përgjegjësish të institucioneve të përfshira në ofrimin e shërbimeve shoqërore, shëndetësore dhe psikologjike për viktimat e trafikimit në Shqipëri.

Në këtë drejtim, hapat e detajuar të ndihmës së menjëhershme për viktimat e rritura dhe fëmijë parashikohen në Procedurat Standarde të Veprimit për Viktimat e Mundshme dhe Viktimat e trafikimit, të cilat garantojnë masa që parashikojnë vlerësimin e thelluar të nevojave të personave të trafikuar për ndihmë dhe mbrojtje. Këto masa merren me pjesëmarrjen e personit dhe të prindit apo kujdestarit nëse viktima është e mitur.

3.8.2 MASA TË POSAÇME MBROJTJEJE PËR FËMIJËT VIKTIMA

Legjislacioni shqiptar në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës 1990 i përkufizon fëmijët si persona nën moshën 18 vjeç.

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut - Parime dhe Udhëzime të Rekomanduara për të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore, Udhëzimi 8 trajton Masat e Posaçme për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve viktimat të trafikimit.

“Dëmi i veçantë fizik, psikologjik dhe psiko-social i pësuar nga fëmijët e trafikuar dhe rritja e vulnerabilitetit të tyre ndaj shfrytëzimit kërkojnë që ata të trajtohen veçmas nga personat e trafikuar në moshë madhore për sa u takon ligjeve, politikave, programeve dhe ndërhyrjeve.

Interesat më të larta të fëmijës duhet të jenë konsiderata parësore në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijë të trafikuar, të ndërmarra këto nga institucione publike apo private të mirëqenies sociale, gjykata, autoritete administrative ose organe legjislative.

3.8.3 PERIUDHA E REFLEKTIMIT

‘Periudha e reflektimit’ u mundëson viktimave të trafikimit të rikuperohen nga përjetimet e tyre dhe /ose të marrin një vendim të mirinformuar për të ndihmuar dhe bashkëpunuar [me autoritetet kompetente] në procedime penale.

Periudha e reflektimit njihet tashmë si një praktikë e mirë e efektshme dhe masë humanitare që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar.

Për shumë viktimat të trafikimit që kanë statusin e imigrantit të parregullt, periudha e reflektimit siguron që atyre mund t’u jepet asistencë dhe mbështetja e duhur si sigurimi i strehimit, këshillim psikologjik, shërbime mjekësore dhe sociale dhe konsultim ligjor.

Kjo mbrojtje e viktimës shërben për të rritur besimin e tij apo të saj te Shteti dhe aftësinë e këtij të fundit për të mbrojtur interesat e tij apo të saj. Pas rikuperimit, personi i trafikuar me besim te Shteti ka më shumë gjasë të marrë një vendim të mirinformuar dhe të bashkëpunojë me autoritetet për mbledhjen e informatave dhe procedimin e trafikantëve.

Gjatë periudhës së reflektimit, personave të prezumuar të trafikuar u jepet status ligjor dhe mbrojtje

ndaj ndalimit dhe dëbimit në vendet e destinacionit.

Gjatë kësaj periudhe, personat e trafikuar kanë qasje në disa shërbime mbështetjeje, si strehim i duhur dhe i sigurt, këshillim psikologjik, shërbime sociale dhe kujdes shëndetësor, si dhe këshill profesionale, përfshirë këshillim ligjor.

Këto masa synojnë t'i ndihmojnë ata që rikuperojnë nga trauma që kanë përjetuar duke qenë të trafikuar dhe të mbeten të sigurt nga trafikantët. Periudha e reflektimit ka për synim që personat e trafikuar të rikuperuar mjaftueshëm nga përjetimet e tyre që ata të jenë të gatshëm dhe në gjendje që ata të flasin për këtë dhe të marrin vendime të mirë informuara nëse duan të ndërmarrin veprime ligjore kundër trafikantit dhe të ndjekin procedime ligjore në lidhje me pretendime për kompensim.

Meqenëse këto vendime kanë pasoja serioze dhe me shtrirje të gjerë si për jetën e personit në fjalë edhe për sigurinë e anëtarëve të familjes në vendin e origjinës, personi i trafikuar nevojitet të ketë kohë për të peshuar të gjitha rrjedhojat e mundshme që lindin nga zgjedhja e tyre.

Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2005 (ratifikuar nga Shqipëria në 2007, hyri në forcë më 1 shkurt 2008), e trajton dhënien e një periudhe rikuperimi dhe reflektimi në nenin 13 të saj. Periudha e rikuperimit dhe reflektimit

1. “Çdo Palë do të sigurojë në legjislacionin e saj të brendshëm një periudhë rikuperimi dhe reflektimi prej të paktën 30 ditësh, kur ka shkaqe të arsyeshme të besojë se personi i interesuar është viktimë. Kjo periudhë do të jetë e mjaftueshme për personin e interesuar që të rikuperohet dhe largohet nga ndikimi i trafikantëve dhe/ose të marrë një vendim të mirinformuar për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente. Gjatë kësaj periudhe, nuk do të ketë mundësinë të zbatojë asnjë urdhër dëbimi kundër tij ose saj. Kjo dispozitë nuk cenon aktivitetet e kryera nga autoritetet kompetente në të gjitha fazat e procedimit përkatëse të brendshëm dhe në veçanti kur kjo vepër penale po hetohet dhe ndiqet penalisht. Gjatë kësaj periudhe, Palët do të autorizojnë personat e interesuar të qëndrojnë në territorin e tyre.
2. Gjatë kësaj periudhe, personat e referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të kenë të drejtën e gëzimit të masave të përfshira në nenin 12, paragrafët 1 dhe 2.
3. Palët nuk janë të detyruara të respektojnë këtë periudhë nëse situata e rendit publik e parandalon atë ose nëse zbulohet se statusi i viktimës është pretenduar në mënyrë të padrejtë.”

3.8.4 PERIUDHA E REFLEKTIMI NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

Periudha e reflektimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit u njihet shtetasve të huaj në Shqipëri sipas Legjislacionit për të Huajt. Ligji 108/2013 “Për të Huajt” u njeh të drejtën viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit të pajisen me leje të përkohshme qëndrimi të tipit “A”, për një afat 3-mujor, pavarësisht nga vullneti i tij/saj për të bashkëpunuar me drejtësinë.⁵⁴

Leja jepet nga autoritet e kufirit dhe migracionit kur plotësohen dy kushte: Kushti i paqë është që duhet të ketë shkaqe të arsyeshme për të besuar se i huaji është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit; dhe kushti i dytë që viktima të jetë e identifikuar si e tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit.

Ligji e njeh periudhën e lejes së përkohshme si periudhë reflektimi, me qëllim që viktima apo viktima e mundshme të rimarrë veten, të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë.

3.9 PARIMET E PUNËS ME VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Mos dëmto

Parimi bazë në identifikimin dhe trajtimin e një personi si viktimë e mundshme apo aktuale e trafikimit është që të mos dëmtosh. Është shumë e rëndësishme që viktima e trafikimit të mos vendoset në një rrezik më të madh apo të ekspozohet ndaj rrezikut për shkak të veprimeve të personit që përpiqet t'i asistojë.

Vendimmarrja në këtë proces duhet të jetë objektive. Bazuar në njohuri, vetëdije, informacion, informata dhe përvojë. Vlerat, kodi moral, bindjet, kultura, traditat, etj të një oficeri nuk duhet të luajnë rol në vlerësimin nëse një person tjetër është trafikuar apo po trafikohet.

Mos marrja parasysh e Treguesve bazuar në stereotipe dhe bindje personale për shembull, mund sjellin si rezultat që viktima të mos identifikohet dhe të mos shpëtohet nga duart e trafikantëve.

Thënë këtë, është e rëndësishme që të ‘analizohen’ viktimat e trafikimit për të siguruar se janë në të vërtetë viktima të trafikimit dhe nuk janë migrantë të kontrabanduar apo të parregullt që vetë ata mund të kenë nevojë për një lloj tjetër mbrojtjeje.

⁵⁴ Ligj Nr 108/2013 “Për të Huajt”, Neni 54 “Lëshimi i lejes së qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzor”.



KAPITULLI 4.



MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT

4.1 PËRKUFIZIMI I MEKANIZMIT KOMBËTAR I REFERIMIT. KUADRI LIGJOR

Manuali për mekanizmat kombëtare të referimit i publikuar nga OSBEja, shprehet se:

“Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) është një kornizë bashkëpunuese nëpërmjet së cilës aktorët shtetërore plotësojnë detyrimet e tyre për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, duke i koordinuar përpjekjet e tyre në partneritet strategjik me shoqërinë civile.”

Qëllimet themelore të një MKR-je janë sigurimi i respektimit të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar dhe sigurimi i një mënyre të efektshme për referim të viktimave të trafikimit të shërbimet. Në të njëjtën kohë, MKR-të mund të punojnë për të ndihmuar për përmirësimin e politikave dhe procedurave kombëtare në lidhje me një spektër të gjerë çështjes që kanë të bëjnë me viktimat, siç janë rregulloret e qëndrimit dhe riatdhesimit, kompensimi i viktimave dhe mbrojtja e dëshmitarëve. MKR-të mund të krijojnë plane kombëtare veprimi dhe mund të vendosin standarde referuese për të vlerësuar nëse janë duke u arritur qëllimet.

MKR-të nuk janë struktura të ngurta, por mekanizma fleksibël, të krijuar sipas rastit për t’u përshtatur modeleve të trafikimit të secilit vend si dhe mjedisit të tij social, politik, ekonomik dhe ligjor. Për këtë arsye MKR-ja nuk ndërtohet mbi bazën e një plani të vetëm të përgjithshëm, por ndërtohet mbi një vlerësim të kujdesshëm të nevojave dhe kushteve specifike për atë shtet.

Elemente kyçe: identifikimi dhe bashkëpunimi

Në thelb të çdo MKR-je është procesi i identifikimit të viktimave të mundshme të trafikimit, të cilët njihen në përgjithësi si “presona të prezumuar të trafikuar”. Ky proces përfshin të gjitha organizatat e mundshme të përfshira në MKR, të cilat duhet të bashkëpunojnë për t’u siguruar ndihmë viktimave nëpërmjet referimit të shërbimeve të specializuara.

Identifikimi i personave të trafikuar është një problem themelor në të gjitha strategjitë antitrafik. Për një mori arsyes, ata që janë të bllokuar në trafikimin e qenieve njerëzore, shpesh nuk dëshirojnë t’ua tregojnë statusin apo përjetimet autoriteteve shtetërore.

Viktimat mund të kenë ndjenja të thella mosbesimi ndaj organeve zyrtare, që rrjedhin nga përvoja në shtetin e tyre të origjinës. Shpeshherë, viktimat kanë frikë nga një hakmarrje e mundshme nga trafikantët kundër atyre vetë dhe anëtarëve të familjes në vendin e origjinës.

Këto kërcënime për dhunë pas kthimit në atdhe e rrisin frikën e viktimave për dëbimin e tyre për shkak të statusit të paligjshëm. Duke qenë se viktimat e trafikimit ngurrojnë shpeshherë ta identifikojnë veten si të tillë, përdoret përgjithësisht termi “presona të prezumuar të trafikuar” për të përshkruar person që me gjasë janë viktimat të trafikimit dhe që për rrjedhojë duhet të klasifikohen në objektin e përgjithshëm të programeve dhe shërbimeve antitrafik.

4.2 MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT NË SHQIPËRI

Marrëveshja e bashkëpunimit për “Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit” rregullon funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit,

Palë në marrëveshje janë:

- Ministria e Brendshme
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Rinisë,
- Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale
- Prokuroria e Përgjithshme
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
- Organizata Ndërkombëtare “World Vision”-Tiranë
- Organizata jofitimprurëse “Arsis”
- Organizata jofitimprurëse “Të ndryshëm dhe të barabartë”-Tiranë
- Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit -Tiranë
- Organizata Jofitimprurëse Qendra Psiko Sociale “Vatra” Vlorë
- Organizata jofitimprurëse “Tjetër Vizion”-Elbasan

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshje është siguri i zbatimit të procedurave standard të Veprimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen, ndihmën dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit si dhe përforsimi i partneritetit të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në funksion të mbështetjes së viktimave që prej identifikimit e deri në riintegrimin e plotë të tyre.

Çdo palë në marrëveshje merr angazhimet sipas fushës së përgjegjësisë në funksion të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave e viktimave të mundshme të trafikimit.

Palë e kësaj marrëveshje mund të bëhet çdo organizëm shtetëror dhe jo shtetëror që shpreh interesin për antarësim dhe që plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 10 të saj.

4.3 PUNA NDËR SEKTORIALE

Parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore nuk është përgjegjësi vetëm e organeve të zbatimit të ligjit.

Cilësia dhe shkalla e bashkëpunimit midis agjencive të autorizuara janë faktorë kyç për veprimtari antitrafik, përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit për trafikimin e qenieve njerëzore.

Shqipëria e Ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Masat Kundër trafikimit të Qenieve Njerëzore 2005 më 6 shkurt 2007. Neni 1 përkufizon “Qëllimet e Konventës”

- a) parandalimi dhe lufta e trafikimit të qenieve njerëzore
- b) ndërtimi i një kuadri gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe dëshmitarët, duke garantuar barazinë gjinore, si dhe duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale efektive;

- c) nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Mund të shihet se këto masa kërkojnë një qasje që përfshin shumë disiplina dhe agjenci për të siguruar që të ketë një përgjigje gjithëpërfshirëse me në qendër viktimën dhe për të siguruar që rrjetet ndërkombëtare të trafikimit, që qëndrojnë shpesh pas trafikimit të qenieve njerëzore të luftohen në mënyrë të efektshme.

Bashkëpunimi midis agjencive ligjzbatuese dhe ofruesve të shërbimeve të specializuara ka vërtetuar se është një përgjigje e efektshme ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në shumë vende, i përforcuar në instrumente të ndryshme ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh natyrën e problemit të trafikimit dhe krimeve që përfshin, ekspertizën e kërkuar për ta trajtuar atë në mënyrë të efektshme dhe nevojat e shumfishta të viktimave të tij, është thelbësore që të ndërmerret një qasje me përfshirjen e shumë agjencive në çdo nismë për ta luftuar, me qëllimin për të siguruar që të përmbushen nevojat e viktimave dhe që të mbështeten masat e ligjzbatimit⁵⁵.

⁵⁵ UNODC, *Toolkit to Combat Trafficking in Persons [Udhëzues për luftën kundër trafikimit]*. <https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/HT-toolkit-en.pdf>



KAPITULLI 5.



HETIMI I TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Në hetimin e veprave të trafikimit të qenieve njerëzore ndërthuren një sërë çështjesh komplekse, përfshirë vështirësitë në lidhje me viktimat që shpesh nuk mundën apo nuk kanë dëshirë të bashkëpunojnë me oficerët e policisë apo të denoncojnë ata që i kanë trafikuar. Në rastet e trafikimit ndërkombëtar, është e nevojshme mbledhja e provave nëpërmjet bashkëpunimit të ndërsjellët juridik me autoritetet e një shteti tjetër, hetime të përbashkëta apo marrëveshje për ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore. Probleme të bashkëpunimit hasen dhe në rastet e trafikimit të brendshëm, ku është i nevojshëm bashkëpunimi me struktura të tjera brenda policisë ose struktura jo policore.

Duke qenë se vepra penale e TQNj ndryshon dhe shfaqet në trajta të reja edhe teknikat hetimore duhet t'i përshtaten situatave të reja të shfrytëzimit dhe tendencave të reja të këtij fenomeni.

Hetimet ndaj TQNj kërkojnë struktura të specializuara dhe teknika të avancuara hetimore që të përballojnë barrierat e lartpërmendura. Më e rëndësishme është se identifikimi i viktimave të trafikimit është përgjegjësi e strukturave ligjzbatuese.

5.1 HETIMI ME NË QENDËR TË DREJTAT E VIKTIMËS

Çdo hetim i TQNj duhet të ketë në fokus viktimën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sigurisht një qasje e tillë nuk është e lehtë në praktikë dhe mund të pengojë teknikat hetimore.

Të kuptuarit dhe trajtimi i nevojave të viktimave të trafikimit është me rëndësi kyçe për këdo që është i përfshirë në luftën kundër këtij fenomeni . Të drejtat dhe nevojat e viktimave nuk janë shtesë e hetimeve apo e proceseve gjyqësore; në të vërtetë, ato janë në thelb të të gjithë procesit.

Mostrajtimi i një viktime të trafikimit si duhet mund të ndikojë të gjithë procesin e ndjekjes penale, për shkak se sjell mungesën e bashkëpunimit nga ana e dëshmitarit kryesor.

Bashkëpunimi i viktimave është një faktor kyç për sukses në çdo hetim dhe ndjekje penale të çështjeve të trafikimit të personave. Nëse nuk ka një viktimë për të dëshmuar, mund të mos ekzistojnë fare asnjë çështje për ta paraqitur në gjykatë. Duhet theksuar se kjo mbështetje, ndihmë dhe mbrojtje nuk duhet të kushtëzohet nga aftësia apo gatishmëria e viktimave për të bashkëpunuar me organet e zbatimit të ligjit.

Të drejtat e viktimave parashikohen në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar (UNOTC) dhe Protokollin e saj shtesë për Trafikimin e Personave. Ndonëse Protokollin parashikon se disa të drejta të viktimave janë të detyrueshme, një pjesë domethënëse e tyre janë në diskrecion të autoriteteve. Kështu, në praktikë, të drejtat në dispozicion të viktimave ndryshojnë në varësi të juridiksionit.

Kushtet e një viktime të trafikuar mund të paraqesin një spektër unik sfidash për oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe gjyqësorin. Procesi i viktimizimit në trafikim është kompleks,

shumëfaqësh dhe shpesh i zgjatur në kohë. Për të luftuar efektet e këtij procesi, qasja e bazuar te të drejtat/nevojat për trajtimin e problemeve të viktimave duhet të jenë sa gjithëpërfshirëse edhe të efektshme.

Të gjitha hetimet duhet të kenë në qendër viktimën dhe gjatë gjithë kohës duhet të respektohen të drejtat e njeriut për viktimën. Në praktikë, kjo mund të shkaktojë vështirësi dhe të pengojë teknikat hetimore. Nuk duhet të ndërmerret asnjë veprim që mund ta vendosë në rrezik viktimën. Për këtë arsye, nevojiten teknika të reja hetimore. Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe prokurorët nevojitet të marrin në konsideratë mundësinë e ndjekjes penale pa viktimë dhe vlefshmërinë e ndërprerjes së një strategjie hetimi nëse kjo është në interesin më të lartë të viktimës⁵⁶.

Nuk mund të hetohet apo procedohet një çështje e trafikimit të qenieve njerëzore, nëse shqetësimi parësor nuk është viktima dhe/ose mbrojtja e dëshmitarit. mbrojtja e pamjaftueshme ose e kufizuar e viktimës, dhe frika e viktimës për siguri të kufizuar apo mungesë e plotë e saj mund të cenojë sjelljen e tyre dhe të ndikojë faktin nëse do të japin prova apo mënyrën si i japin këto prova në një procedim të mëpasshëm.

Në praktikë kjo do të thotë që në çdo hetim, përparësi kanë të drejtat dhe përmbushja e nevojave bazë të viktimës, të cilave u sigurohet mbrojtje dhe nuk detyrohen të japin dëshmi apo të bashkëpunojnë me strukturat ligjzbatuese nëse është jashtë vullnetit të tyre.

5.2 TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT GJATË HETIMIT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

Detyrimi për të njohur dhe respektuar të drejtat e viktimave, si edhe për t'u ofruar atyre asistencë buron nga aktet ligjorë të mëposhtëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë, KPP-ja);
- ligji n. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”
- Ligji “Për policinë e shtetit ”
- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;
- Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji nr. 10192, dt. 03.12. 2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjerë nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
- Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

⁵⁶ OSBE, “Trafikimi i qenieve njerëzore: Identifikimi i viktimave potenciale dhe të prezumuara. Një qasje e policimit në komunitet” [OSCE Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims A community Policing approach].

Parimet e zbatimit për të miturit:

Organet kompetente, në çështjet me të mitur viktime dhe/ose dëshmitarë, bëjnë kujdes të veçantë, me qëllim që:

- i mituri viktimë ose dëshmitar i veprës penale të trajtohet me përkujdesje, në mënyrë miqësore dhe të ndjeshme, të tilla që respektojnë dinjitetin e tij gjatë gjithë procesit, duke marrë në konsideratë gjendjen e tij personale, nevojat e menjëhershme dhe të veçanta, moshën, gjininë, aftësitë e kufizuara, nëse ka, dhe nivelin e pjekurisë;
- të mbrohet jeta private e të miturit viktimë ose dëshmitar. Ndërhyrja në jetën private të të miturit, nëse është e nevojshme, të jetë në nivelin më të ulët të mundshëm të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që të sigurohen provat e nevojshme të procesit penal;
- të marrin të gjitha masat që çdo pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë për të mitur, i cili ka të dhëna lidhur me të miturin viktimë ose dëshmitar, të jetë i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit të marrë për shkak të detyrës ose/dhe gjatë kryerjes së detyrës;
- bërja publike e informacionit lidhur me identitetin e të miturit dëshmitar ose viktimë bëhet vetëm me leje të gjykatës.
- Të drejtat i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit.
- Në çdo vendim dhe procedurë lidhur me drejtësinë penale për të mitur mbahet në konsideratë e drejta e të miturit për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
- çdo vendim apo veprimtari që lidhet me viktimën e mitur duhet të mbajë parasysh interesin më të lartë të saj.
- Oficeri i policisë gjyqësore duhet të argumentojnë ose të jenë në gjendje të argumentojnë në çdo rast se si është siguruar respektimi i interesit më të lartë të fëmijës;
- viktime ose dëshmitari i mitur gëzon, për aq sa është e mundur, të njëjtat të drejta të parashikuara për të pandehurin e mitur;
- Oficerët e policisë gjyqësore që caktohen në çështjet penale me të pandehur apo viktime të mitura duhet të jenë trajnuar në këtë fushë.

Parimet e zbatimit për të rriturit:

- viktime e veprës penale është subjekt me status të posaçëm në procedurën penale, pasi KPP i njih një pozicion dhe të drejta që e dallojnë në mënyrë thelbësore nga të gjithë pjesëmarrësit e tjerë në proces;
- KPP-ja i ka njohur viktimës të drejtën për të marrë pjesë në proces dhe për t'u përfaqësuar me avokat, por, megjithatë, prokurori duhet të marrë parasysh edhe mendimin e interesat e viktimës gjatë vendimmarrjes së tij në lidhje me çështjen;

Të drejtat e viktimës së veprës penale përcaktohen në nenet 58, 58/a, 58/b të KPP si më poshtë:
 Udhëzuesi i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme⁵⁷, udhëzon prokurorët, punonjësit e policisë gjyqësore dhe punonjës të tjerë të prokurorisë që gjatë ndërveprimit të tyre me viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale të respektojnë të drejtave që u njihen viktimave të veprave penale dhe ofrimin e shërbimeve që u takojnë atyre me ligj.

Viktima e trafikimit - veçanërisht vulnerabël

Prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë **konsiderojnë veçanërisht vulnerabël dhe tregojnë kujdes të posaçëm** për viktimën që i përket një apo me shumë prej kategorive të mëposhtme:

- Fëmijët
 - Viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual dhe përndjekjes
 - Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore
 - Viktimat me paaftësi fizike dhe intelektuale
-

Përsa i përket rolit të Oficerit të Policisë Gjyqësore⁵⁸, Udhëzuesi shprehet se:

Gjatë fazës së hetimeve paraprake, punonjësi i policisë gjyqësore respekton dhe zbaton të drejtat e viktimës, bazuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në këtë udhëzim. Për ushtrimin e kësaj përgjegjësie, punonjësi i policisë gjyqësore vepron vetë ose nën udhëzimet e prokurorit. Në mënyrë të veçantë, punonjësi i policisë gjyqësore:

- a) merr kontaktin e parë me viktimën e mundshme dhe sigurohet që asaj, veçanërisht nëse u përket kategorive vulnerabël, t'i plotësohen nevojat urgjente dhe t'i garantohet siguria fizike. Për këtë qëllim, policia gjyqësore bashkëpunon me shërbimet sociale dhe organizata jo qeveritare, sipas rastit;
- b) i jep viktimës së mundshme informacionin e parë lidhur me të drejtat e saj dhe me mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë penale dhe e vendos në kontakt me shërbimin social në nivel vendor, si edhe me ofrues joqeveritarë të shërbimeve, nëse është rasti;
- c) merr kallëzimin ose deklaratimet e viktimës, duke respektuar rregullat e parashikuara në KPP;
- ç) i raporton prokurorit lidhur me kontaktin me viktimën, si edhe periodikisht ose me kërkesën e prokurorit për aktivitetin e tij të mëvonshëm lidhur me viktimën. Raportimi është i detyrueshëm dhe i menjëhershëm në rastet kur viktima u përket kategorive veçanërisht vulnerabël, gjendet në situatë rreziku apo kur ka të dhëna për ekzistencën e viktimave të tjera;
- d) mbledh informacion të vlefshëm për identifikimin dhe njoftimin e viktimës'. Në rast se ka të dhëna për viktima të tjera, merr masa për identifikimin dhe njoftimin e tyre, duke i raportuar prokurorit apo kërkuar udhëzime prej tij;
- dh) trajtohet dhe merr njohuri të posaçme në fushën e drejtësisë penale për të miturit, nëse është caktuar për të hetuar çështje që i përkatësin seksionit për të miturit në prokurorinë përkatëse.

⁵⁷ Prokuroria e Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm, Nr.5, datë 26/10/2018 "Për "Garantimin E Asistencës ndaj Viktimave dhe Dëshmitarëve të Veprave Penale".

⁵⁸ Po aty, Neni 11 "Roli i punonjësit të policisë gjyqësore".

5.3 FORMAT E HETIMIT TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

5.3.1 HETIMI PROAKTIV

- Përgjithësisht, për shkak të kompleksitetit të hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore, hetimi i veprës penale të trafikimit shtrihet në kohë dhe duhet të jetë i bazuar në mbledhjen dhe analizën e informacionit si dhe bashkëpunim midis shumë strukturave. Gjatë procesit të trafikimit, trafikantët mund të lenë gjurmë të ndryshme të ilustruara më poshtë: Reklamimi (si pjesë e procesit të rekrutimit apo shfrytëzimit)
- Marrja me qira e mjediseve (shtëpi të sigurta, lokale, fabrika pa kushte, etj.)
- Transportimi (sigurimi i dokumenteve të identitetit dhe udhëtimit dhe rregullimi i transitit)
- Komunikimi (me qëllim rekrutimin dhe shfrytëzimin)
- Transaksione financiare (gjen zbatim në të gjitha rastet e mësipërme)

Në çdonjërin prej këtyre fazave në procesin e trafikimit mund të ekzistojnë prova materiale dhe oficerët e policisë duhet të gjejnë mënyrën për t'i shfrytëzuar në maksimum këto mundësi me qëllim që të shpëtojnë viktimat, të kapin autorët dhe të kontribuojnë në ndjekjen penale dhe dënimin e tyre, si dhe në konfiskimin e pasurive të tyre kriminale.

Si rrjedhojë e informacionit të mbledhur mund fillohen hetime në mënyrë proaktive - informacione me njohuri për trafikantët - të cilat kanë në nevojë për hetim të mëtejshëm. Strategjitë dhe taktikat e përdorura në hetim mund të përfshijnë teknika të specializuara hetimi nëse ato janë metoda më efektshme përmblyes së një hetimi.⁵⁹

Hetimi proaktiv ndërmerret si reagim ndaj informacionit për një rast trafikimi që po ndodh apo që mund të ndodhë, informacion i marrë në rrugë operative apo nga raportime të dëshmitarëve. Në këto situata, mund të mos ketë një kërcënim të menjëhershëm apo të dukshëm të personave, që do të thotë se oficerët e policisë nuk është e domosdoshme të reagojnë menjëherë. Ata mund t'i planifikojnë veprimet e tyre për të mbledhur prova sipas planeve operacionale dhe burimeve.

Në reagimet proaktive, oficerët e policisë mundet që:

- Të vendosin se ku dhe kur të fillojnë veprimet hetimore
- Të kontrollojnë drejtimin e hetimit, p.sh. ku mund të rikuperohet prova që kërkohet, cila strukturë duhet të udhëheqë hetimin, ku duhet të bazohet hetimi
- Të synojnë të menaxhojnë hetimin sipas strategjisë së dakordësuar
- Të planifikojnë një reagim me përfshirjen e shumë agjencive, shpesh i nevojshëm për të mbështetur viktimat e shpëtuar.

Hetimi proaktiv është më i efektshëm sepse oficerët e policisë, nën drejtimin e prokurorisë, e bazojnë hetimin në një strategji, p.sh. shërbimet mbështetëse, logjistika, bashkëpunimi midis strukturave. Nëse hetimi kryhet në mënyrë të suksesshme, trafikantët nuk do ta dinë se kur, si apo ku do të hetohen, p.sh. përgjimi i komunikimeve, vëzhgimet me vendosjen e mjeteve përgjuese.

⁵⁹ Udhëzues trajnimi i OSBEsë për policinë – Trafikimi i qenieve njerëzore (2013). [OSCE Police Resource Training Guide - Trafficking in Human Beings (2013)] <https://www.osce.org/secretariat/109935>.

Përparësitë e hetimit proaktiv

Nëse e lejojnë rrethanat dhe koha, planifikohet dhe kryhet kontrolli i objektit sipas një vlerësimi të mjedisëve, numrit të personave të pranishëm si dhe planimetrinë e objektit, si mënyrat e hyrjes, prezenca e dyerve të blinduara, apo numri i dhomave. Më pas mund të bëhet një vlerësim i duhur i rreziqeve që paraqet operacioni policor dhe burimet që kërkohen për t'i kapërcyer ato.

- Përfshirja e një oficeri të infiltruar apo përdorimi i teknikave speciale të hetimit mund të konsiderohet si një mjet për mbledhjen e të dhënave për rastin e dyshuar të trafikimit, por vetëm në ato raste kur veprimi nuk çon në rrezikimin apo dëmtimin e personave të tjerë. Ky është një instrument themelor hetimi, i cili nuk është në dispozicion të oficerëve që realizojnë hetim reagues. Duke ndërthurur informacionet, vëzhgimin me burime njerëzore dhe mjete teknike, infiltrimin (në rastet kur është autorizuar, sipas ligjit) dhe teknikat standarde të hetimit, oficerët mund të identifikojnë trafikantët dhe të sigurohen që këta të fundit të ndiqen penalisht. Kryerja e hetimit pa përfshirjen e viktimës shërben si një njohje nga ana e agjencive ligjzbatuese të vështirësive reale me të cilat përballen viktimat e trafikimit, të cilët mund të mos jenë në gjendje apo mund të mos dëshirojnë të dëshmojnë kundër shfrytëzuesve të tyre. Hetimi proaktiv ofron edhe mundësinë që të ndërmarren hapat për të gjurmuar trafikantët pa pasur denoncim apo dëshmi nga viktimat, ose për të siguruar që çdo dëshmi e një viktime të mbështetet me burime të tjera provash.

Kujdes! Viktima nuk duhet lënë në situatë shfrytëzimi ndërkohë që mbledhen prova.

Duke njohur e pranuar faktin se viktimat e trafikimit për shumë e shumë arsye mund të mos jetë në gjendje të mbështesë plotësisht ndjekjen penale, dëshmia e viktimës mund të jetë e vetmja provë kundër trafikantëve. Prova e një viktime mbetet 'prova më e mirë', por nuk ka arsye që ajo të mbetet e vetmja provë.

5.3.2 HETIMI REAGUES

Kur viktimat janë në rrezik të menjëhershëm ose nëse përfshihen fëmijë, prioritet është shpëtimi i viktimave dhe jo ndërtimi i një themeli të fortë me prova për ndjekjen penale në një fazë të mëvonshme.

Është e domosdoshme që strukturat e policisë të reagojnë në mënyrë të menjëhershme pas marrjes së informacionit dhe pas vlerësimit të rrezikut, pas marrjes dëgjimit për kryerjen e një vepre penale apo kërkesës për të shpëtuar një viktimë, veçanërisht nëse viktimat e mundshme është fëmijë.

Praktika ligjore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e konsideron detyrim pozitiv të shteteve masat për hetimin e menjëhershëm të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të sigurimit të mbrojtjes për viktimat⁶⁰.

Forma më e zakonshme e një hetimi reagues të TQNJ-së është reagimi pas marrjes së njoftimit për një rast të dyshuar trafikimi. Edhe nëse nuk çon gjithmonë në një veprim të suksesshëm sa i takon arrestimit dhe ndjekjes penale të autorëve, sepse rrethanat diktojnë që autoritetet të reagojnë në kohë, hetimi reagues është shpesh i domosdoshëm, nevoja për një ndërhyrje të menjëhershme është parësore për të mbrojtur viktimat dhe për t'i shpëtuar nga trafikantët.

⁶⁰ OSCE Police Resource Training Guide - Trafficking in Human Beings (2013). [Udhëzues trajnimi i OSBE-së për policinë – Trafikimi i qenieve njerëzore 2013]. <https://www.osce.org/secretariat/109935>

Shembull i referuar nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës

F. është një vajzë 16 vjeçare nga Tirana, por u identifikua si viktimë e mundshme e trafikimit në Shkodër në vitin 2016 dhe u referua pranë një Punonjëseje për Mbrojtjen e Fëmijës në Tiranë. Familja e vajzës kishte kryer denoncim për largimin e saj nga banesa. Ajo u kap gjatë një operacioni policor në një klub nate në Shkodër dhe iu referua Punonjëses së Mbrojtjes së Fëmijës. Gjatë intervistës me Punonjësen e Mbrojtjes së Fëmijës, ajo shfaqti tregues se ishte shfrytëzuar seksualisht ndërsa punonte si kameriere në një klub nate. Në kohën e identifikimit, ajo u shpreh se i ati e kishte abuzuar seksualisht.

Ajo ishte larguar nga shtëpia dhe kishte qëndruar në një apartament me qira në Tiranë bashkë me shoqe të tjera. Para se të shkonte në apartamentin me qira, ajo kishte qëndruar larg familjes për pjesën më të madhe të kohës, në shoqërinë e grupeve apo individëve të dyshuar si të përfshirë në veprimtari të paligjshme. Ajo është më e madhja e pesë fëmijëve, njëri prej të cilëve nuk jetonte më. Familja jetonte në kushte të varfërisë ekstreme, duke u mbështetur tek ndihma nga shërbimet sociale. Pas identifikimit si viktimë e mundshme e trafikimit, F. u transferua në një strehëz për viktimat e trafikimit, që drejtohej nga një OJF, jashtë Tiranës.

Hetimi reagues është metoda më e zakonshme e hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore, por njëkohësisht më e dobët se sa hetimi proaktiv për disa arsye:

- Viktimat mund të japin informacion fillimisht, por më vonë mund të zgjedhin të mos bashkëpunojnë apo të mos jenë në gjendje ta mbështesin më tej hetimin
- Viktimat mund të japin informacion të pjesshëm apo të largojnë hetimin nga i dyshuari kryesor pasi e perceptojnë si personi që i ka ndihmuar, ose japin informacionin që gjykojnë se është i rëndësishëm, apo që mendojnë se nuk i fajëson ato për veprimin e kryer.
- Viktimat, informatorët apo dëshmitarët, mund të japin informacion që kërkon një reagim të menjëhershëm por se veprimi i ndërmarrë nuk mund të sigurojë që të zbulohen dhe të ndalohen nivele më të larta të kriminalitetit
- Masat reaguese mund të çojnë vetëm në sigurimin e një numri të kufizuar provash.

Janë tri përgjigje reaguese që duhet të zbatohen kur situata e një viktimit krijon nevojën për një përgjigje reaguese:

Ndërhyrje e menjëhershme

- Për të shpëtuar viktimën
- Për të parandaluar shfrytëzimin ose dëmin ndaj të tjerëve
- Për të siguruar prova që mund të dëmtohen apo të humbasin

Përdorimi i informacionit

- Për të kryer hetime proaktive të fokusuara në lidhje me një hetim
- Për të ndalur veprimtarinë e trafikimit si një strategji alternative ndaj arrestit
- Për të zhvilluar njohuri dhe të kuptuarit e një situatë trafikimi

Përdorimi i informacioneve

- Për të planifikuara dhe filluar operacione për mbledhjen e informacioneve shtesë
- Për të planifikuar dhe filluar hetime për mbledhjen e provave
- Për të vlerësuar kushtet për mbledhjen e informacionit për një veprim të planifikuar dhe për të identifikuar të dyshuarit
- Për të minimizuar risqet me të cilat mund të përballeni gjatë operacioneve vijuese për arrestime

Në rastet kur vlerësimi i rrezikut për viktimat tregon qartësisht nevojën për ndërhyrje të menjëhershme, nevojitet të ndërmerret veprim i menjëhershëm.

Në rastet kur rreziku për viktimat që mbeten apo nevoja për të siguruar të dhëna jetësore kërkon një ndërhyrje të menjëhershme, rasti duhet të lëvizë shpejt në fazën e arrestit.

5.4 KËQYRJA E VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT

Sipas UNODC, përparësi duhet të jetë garantimi i sigurisë personale të personit ndaj të cilit kryhet këqyrja.

KËQYRJA ANALIZUESE

Këto bëhen kur gjeni një viktimë të dyshuar në një vendndodhje të veçantë. Objektivi i parë i tyre nuk lidhet drejtpërdrejt me këqyrjen e vendngjarjes; objektivi është të përcaktohet se nuk ka lëndime apo sëmundje që kanë nevojë për trajtim të menjëhershëm mjekësor.

Objektivi në vendngjarje është që të identifikohet çdo provë që mund të humbasë, dhe për të cilën nevojiten hapa të menjëhershëm për ta regjistruar dhe/ose ruajtur. Këto janë këqyerje 'jo intime' në terren. Në përgjithësi, ato kërkojnë pak kohë.

KËQYRJA EVIDENCIALE

Këto ka më shumë gjasë të zhvillohen në një rajon policie, klinikë mjekësore, sipas natyrës së rastit dhe rregullave dhe procedurave të secilit vend. Objektivi kryesor i tyre është të rikuperojë gjurmë të krimin në një standard evidencial. Në përgjithësi, prova për të cilën kërkohet do të lidhet me një formë të abuzimit fizik apo seksual në lidhje me shfrytëzimin apo masa kontrolli. Kjo lloj këqyrjeje do të jetë më intime se sa këqyrja analizuese'. Ajo përfshin heqjen e rrobave dhe, në rastin e shfrytëzimit seksual, mund të jenë të nevojshme ekzaminime të jashtme dhe të brendshme të organeve seksuale.

Përgjithësisht ka rregulla shumë strikte për këqyrjet intime personale. Ato përfshijnë, për shembull:

- rregullore që u lejojnë vetëm profesionistëve të mjekësisë ta bëjnë këqyrjen
- lejimin e këqyrjes vetëm nga persona të të njëjtit seks, dhe
- rregullore që përkufizojnë saktësisht se ku mund të zhvillohet këqyrja.

Është shumë e rëndësishme si për integritetin e rastit edhe për nevojat e viktimave të dyshuara/ të mundshme që këto rregullore të respektohen e zbatohen me korrektësi.

Mund të jetë tashmë informacion i njohur ose viktimat mund të bëjnë të ditur informacion që ka të bëjë me ngjarje që kanë ndodhur shumë kohë më parë. Në këto rrethana, mund të mos ketë

mundësi realiste për të rikuperuar ndonjë provë gjurmësh. Në konsultim me specialistët, ju duhet të vendosni nëse ia vlen stresi dhe trauma e mundshme shtesë që mund të shkaktojë këqyrja te viktima e dyshuar, nëse ka shumë pak gjasë që të ketë vlerë prove.

Në një rast që përfshin një industri të veçantë, merrni në konsideratë të punoni me specialistë nga industria përkatëse me qëllim identifikimin e praktikave të punës dhe se si kjo mund të shfaqet nëpërmjet dëmtimeve dhe shenjave të tjera në trupin e një personi.

Viktimat e trafikimit ka gjasë të shfaqin shenja si trauma psikologjike, dëmtime nga dhuna, infeksione të transmetuara seksualisht, HIV dhe AIDS, apo shqetësime të tjera të shëndetit riprodhues.

Këto rreziqe shëndetësore janë të pranishme gjatë gjithë fazave të trafikimit me qëllim shfrytëzimin dhe përfshijnë lëvizje, brenda dhe jashtë vendit dhe shtrëngim për të realizuar një gamë praktikash shfrytëzuese. Trafikantët përdorin më së miri dhunën dhe kërcënimin për përdorimin e dhunës si një mjet i efektshëm kontrolli. Viktimat e trafikimit mund të rrihen, torturohen, ekspozohen ndaj dhunës seksuale, të mbahen në izolim, dhe të privohen nga ushqimi, uji dhe nevojat sanitare. Dihet që trafikantët ju japin substanca narkotike viktimave me qëllim krijimin e varësisë prej tyre.

Mbledhja e provave është tejet e rëndësishme për të mbështetur deklaratimet e viktimës në lidhje me shfrytëzimin dhe trajtimin nga trafikantët.

Ndonëse dëmtimet mund të jenë jospecifike, i ashtuquajtur 'modeli i dëmtimit' përshkruan shenjën për instrumentin apo mjedin që është përdorur për ta shkaktuar. Lista e 'instrumenteve' është e pafund. Më të përdorurit janë, duart, këmbët, rripi i mesit, shkopi i bejsbollit, mjete kuzhine dhe cigare të ndezura. Secili prej këtyre instrumenteve lë një gjurmë në lëkurë që reflekton formën e tij duke qenë kështu unike për atë instrument. Modelet e dëmtimit riprodhohen vazhdimisht. Ato mund të kategorizohen në tri kategori kryesore, sipas burimit të forcës: jodepërtuese, e mprehtë dhe termale.

Njohuria për modelin e dëmtimeve dhe dokumentimi i tyre i saktë lidhur me anatomicën e secilit dëmtim do ta ndihmojë mjekun dhe oficerin e policisë gjyqësore për të përcaktuar se çfarë mjete, instrumenti, apo armë është përdorur për të shkaktuar një plagë të caktuar.

Dijenia se cili instrument apo armë është përdorur do ta ndihmojë hetuesin të përcaktojë nëse dëmtimi përputhet apo nuk përputhet me trajtën apo konfigurimin unik, kur ushtrohet presion i mjaftueshëm, do të lërë një gjurmë që është pasqyrim i vetvetes në lëkurë. Disa shembuj përfshijnë shenja e gishtave të dorës të lëna nga një shpullë, shenja rrethore ose të sheshta nga rripi i mesit apo kordona, mavijosje nga presioni i majës së gishtave, gërvishnje nga thonjtë, mavijosje paralele nga kontakti me një objekt liënar, dhe mavijosje nga takat apo shualli i këpucës⁶¹.

⁶¹ Ekzaminimi mjeko-ligjor i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore - Këshillit Ndërkombëtar për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës [Forensic medical examination of victims of trafficking in human beings – International Rehabilitation Council for Torture Victims]

PËLQIMI:

Një parim themelor etik në praktikën mjekësore është se asnjë ekzaminim, diagnozë, apo trajtimi i një personi të aftë dhe në moshë madhore nuk duhet të ndërmerret pa pëlqimin e personit. Detyrimi etik për të kërkuar pëlqimin gjatë zbatimit edhe në rastet kur kjo nuk është një kërkesë ligjore.

Me qëllim që pëlqimi të jetë 'i vlefshëm', individit duhet t'i jetë dhënë informacion i mjaftueshëm, i saktë dhe me lidhje përkatëse; individit duhet të ketë aftësinë për të shqyrtuar çështjet dhe për të arritur një vendim; dhe që vendimi duhet të jetë me dëshirë në kuptimin që të mos jetë prej shtrëngimit⁶².

Ka një numër mënyrash në të cilat aftësia për të dhënë pëlqimin mund të kompromentohet:

- aftësia e individit për të marrë një vendim mund të cenohet nga sëmundja, frika, lodhja, stresi apo nga efektet e alkoolit apo drogave
- mungesa e privatësisë gjatë konsultimit mund të cenojë gatishmërinë e individit për të bërë pyetje në mënyrë që të marrë informacion të mjaftueshëm për të marrë një vendim të bazuar në informacion
- individit mund të japë pëlqim të përgjithshëm për çdo gjë që propozohet me shpresën se do të lirohet shpejt pa marrë në konsideratë procedurën aktuale që duhet të ndiqet
- fakti që refuzimi për të lejuar një kontroll intim mund të shihet se nënkupton faj, mund të jetë si presion mbi pacientin për të dhënë pëlqimin
- në rrethana të kufizuara, individit nuk ka zgjedhje në lidhje me faktin nëse kontrolli fizik do të vijojë, vetëm zgjedhjen nëse ky kontroll fizik do të bëhet nga një profesionist i mjekësisë apo nga një oficer i policisë.

Viktimit duhet t'i tregohet se çfarë përmban këqyrja evidenciale dhe pse kërkohet një këqyrje që para se ai/ajo të japë pëlqimin. Pëlqimi nuk është i mirëfillt nëse viktimi nuk e kupton se për çfarë ai/ajo ka dhënë dakordësinë.

Shumë viktime me gjasë mund të dëshirojnë të lahen, ose për shkak të krimit seksual që është kryer ndaj tyre ose për shkak se trafikantët nuk i kanë lejuar të lahen për ca kohë. Larja mund të largojë provat dhe viktimat duhet të dekurajohen duke u thënë që të mos lahen deri sa të ketë përfunduar ekzaminimi. Kjo duhet shpjeguar në mënyrën më mirëkuptuese dhe të ndjeshme të mundshme.

Viktimat duhet të lejohet të lahen nëse këmbëngulin, pasi t'u jetë shpjeguar që ky proces mund të rezultojë në humbjen e provave⁶³.

Këqyrja mjekësore e një viktime trafikimi është me rëndësi themelore në rastet kur është përdorur forca si metodë kontrolli, gjatë shfrytëzimit apo kur shfrytëzimi ka rezultuar në lëndim, sëmundje apo në një gjendje mjekësore.

⁶² Udhëzuesi Mjekësor për Mjekët në Britani – Këqyrja e pjesëve intime, shtator 2020. [British Medical Guidance for Doctors – Intimate Body Searches September 2020].

⁶³ UNODC, Toolkit to Combat Trafficking in Persons [Udhëzues për luftën kundër trafikimit]. <https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/HT-toolkit-en.pdf>

Këqyerja e personit sipas Kodit të Procedurës Penale

Kodi i Procedurës Penale, nenet 201-201/a, parashikon se këqyerja e personave bëhet në vende të përshtatshme duke respektuar, me sa është e mundur, dinjitetin dhe integritetin personal të atij që këqyret.

Kodi parashikon mundësnë e personit ndaj të cilit bëhet këqyerja për të kërkuar praninë e një të besuari, me kusht që ky të mund të gjendet menjëherë dhe të jetë i përshtatshëm.

Kodi njih dhe mundësinë e këqyerjes nga mjeku dhe në këtë rast organi procedues mund të mos marrë pjesë në veprimin e këqyrjes.

Pëlqimi për kryerjen e këqyerjes jepet me shkrim dhe në rast mospëlqimi mund të urdhërohet nga gjykata,

Për personin e mitur pëlqimin e jep prindi ose kujdestari ligjor dhe në rast të marrjes së kampionit biologjik ose kryerjes së procedurës mjekësore mbi të miturin, prania e prindit, kujdestarit ligjor ose e një personi të besuar prej tij është e detyrueshme.

5.5 VLERËSIMI I RREZIKUT

5.5.1 ÇFARË ËSHTË "RREZIKU"?

Vlerësimi i niveleve të rrezikut ka rëndësi të madhe në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore. Çdo person i përfshirë në TQNJ duhet të jetë i vetëdijshëm për procesin në mënyrë që të japin një kontribut bazuar në informacion dhe të dobishëm kur kërkohet një gjë e tillë.

Është përgjegjësi e agjencive ligjzbatuese që hetojnë rastet e trafikimit të qenieve njerëzore që të vlerësojnë rreziqet e mundshme për viktimat në të gjitha fazat e hetimit. Nëse ekziston një rrezik që kërcënon sigurinë e viktimës atëherë është detyrë ligjore minimizimi irrezikut duke identifikuar dhe duke iniciuar përgjigjen e duhur.⁶⁴

Realizimi i vlerësimit të rrezikut në fushën e TQNJ mund të jetë një detyrë komplekse për profesionistët e drejtësisë penale. Mundet që të jenë të përfshirë shumë individë, shpesh të përhapur në një zonë gjeografike të gjerë (përfshirë në shtete të huaja), që kërkojnë të shfrytëzojnë njerëzit e intimiduar dhe të frikësuar, të cilët, për këtë arsye, mund të mos duan të bashkëpunojnë me autoritetet dhe të vënë në rrezik sigurinë e tyre.

Kush ose çfarë është në rrezik?

- Viktimat e identifikuar të trafikimit të qenieve njerëzore ose familjet dhe miqtë e tyre
- Viktima të tjera të paidentifikuara
- Cilido tjetër i përfshirë në hetim, p.sh. oficerë policie, prokurorë, dëshmitarë
- Suksesi i ndjekjes penale
- Besimi i viktimave tek institucionet për të raportuar trafikimin

64 OSCE Police Resource Training Guide – Trafficking in Human Beings 2013

Çfarë është rreziku?

- Sulmimi apo intimidimi i viktimave, familjeve apo miqve të tyre nga ana e trafikantëve ose e bashkëpunëtorëve të tyre
- Intimidimi i dëshmitarëve, oficerëve të policisë, prokurorëve
- Kriminelët do të vazhdojnë të viktimizojnë njerëz nëse nuk identifikohen dhe ndalohen.
- Nuk ka dëshmi nëse viktimat/dëshmitarët e humbin besimin në sistem
- Mohim ose izolim nëse viktimat kthehen në shtëpi pa mbështetje apo kontakt
- Teknikat hetimore mund të zbulohen dhe të komprometohen

Çfarë është niveli i rrezikut?

- A janë kriminelët në gjendje të arrijnë viktimën, familjen ose miqtë?
- Sa të dhunshëm/të aftë janë kriminelët?
- Si është shëndeti fizik i viktimës/ave?
- Si është shëndeti psikologjik i viktimës/ave?
- Nëse zbulohet një teknikë hetimore, sa të rënda do të jenë pasojat për të ardhmen?

Çfarë veprimesh duhen ndërmarrë?

Kjo varet nga të gjithë faktorët e përmendur më lart dhe me mundësi edhe më shumë dhe përfshin:

- Vendosjen e viktimave të dyshuara/të identifikuara në akomodim të sigurt në strehëz ose masa për mbrojtjen e dëshmitarit.
- Dhënien e këshillimit dhe trajtimit mjekësor për viktimat e traumatizuara/të lënduara.
- Aplikimi për paraburgimin e të dyshuarve.
- Dhënien e mbështetjes për viktimat që të kthehen në shtëpi.
- Sigurimin e lehtësive për dëshmitarët/viktimat që të japin prova me anë të videos ose në mënyrë anonime, për shembull.
- Përdorimi i metodave për mbajtjen të fshehtë të teknikave hetimore të përdorura, për shembull, rikuperimin e viktimave të dyshuara në atë që duket të jetë një operacion rutinë ligjzbatues.

Vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut është identifikimi i atyre faktorëve të rrezikut, vendimi për sa të rënda janë pasojat dhe vendimi për një plan rreziku.

Vlerësimi i rrezikut ka katër faza:

- Identifikimi i rrezikut
- Vlerësimi i rrezikut
- Gjykimi profesional
- Administrimi i rrezikut

Ai duhet të jetë një proces dinamik që do ta rregullojë vlerësimin e rrezikut për dëm në kahun lartë ose poshtë në varësi të ndryshimit të rrethanave.

Vlerësimi i rrezikut duhet të bëhet në bashkëpunim me çdo viktimë që perceptohet se është në

rrezik të një kërcënimi apo dhune në të ardhmen. Viktima duhet të ndihet komode dhe të kuptojë qëllimin e vlerësimit dhe arsyeën pse bëhen disa pyetje, çfarë është e rëndësishme për të fituar besimin për ndarjen e informacionit në lidhje me shfrytëzimin e tyre si dhe për të ndihmuar në adresimin e frikërave.

Ashtu si edhe me intervistat e tjera, është me rëndësi thelbësore që oficerët e Policisë të ndjekin udhëzimet/PSV-të dhe të tregojnë ndjeshmëri kur të bëjnë pyetje për llojin e abuzimit apo të sulmit. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm edhe për vulnerabilitetin e të mbijetuarve dhe për mënyrën se si mund të cenohet siguria e tyre nga çështje të tilla si statusi i pabarabartë social dhe familjar, diskriminimi dhe pengesa të tjera që lidhen me shfrytëzimin e tyre, rrethanat e tyre personale dhe/ose statusi i migracionit.



KAPITULLI 6.



INTERVISTA E NJË VIKTIME TRAFIKIMI PËR SIGURIMIN E PROVAVE

6.1 QËLLIMI I NJË INTERVISTE

Qëllimi i një interviste është të merret informacioni i vërtetë rreth asaj që i ka ndodhur viktimës. Punonjësi i policisë që kryen intervistën duhet të jetë i vetëdijshëm për vështirësitë që ka intervista në mënyrë që të maksimizojë mundësitë për të marrë një rrëfim të historisë që pasqyron plotësisht atë që ka ndodhur, ose sa më shumë që viktima të jetë në gjendje të kujtojë.

Intervistimi i një viktime trafikimi është i ngjashëm me intervistimin e viktimave të përdhunimit, formave të tjera të abuzimit seksual, rrëmbimit, marrjes me forcë dhe rasteve të rënda të veprimeve seksuale me dhunë. Këto intervista zakonisht realizohen nga oficerë të trajnuar dhe me përvojë, të cilët i kuptojnë efektet e traumës dhe janë të përgatitur për ta realizuar procesin me një qasje që fokusohet tek viktima, dhe jo vetëm në marrjen e provave për të ndjekur penalisht autorin e veprës penale.

Intervistimi i viktimave të trafikimit kërkon durim dhe mirëkuptim. Duke qenë se viktimave u kërkohet të kujtojnë një përvojë traumatike, me gjasë do të duhet kohë që ata të tregojnë historinë e tyre të ngjarjeve. Intervistat e kësaj natyre mund të kërkojnë edhe pushime të rregullta, më shumë se në çdo intervistë tjetër, veçanërisht kur kemi të bëjmë me fëmijë viktima.

Prania e psikologut është e detyrueshme sa herë që pyetet viktima e mitur⁶⁵. Psikologu luan rolin e mbështetësit emocional të fëmijës dhe jo të ekspertit. Kur është e mundur, këshillohet që pyetja e viktimës së mitur të bëhet nga persona të trajnuar për këtë qëllim dhe regjistrohet, për t'u përdorur në seancë gjyqësore.

Sipas nenet 58/a dhe 361/a të Kodit të Procedurës Penale, pyetja e fëmijës dhe ekzaminimi mjeko- ligjor i tij mund të jenë të vetmet prova që mbështesin akuzën, veçanërisht në rastet e abuzimit me fëmijë. Ekzaminimi mjeko-ligjor dokumenton ngjarjen dhe dëmin fizik, kurse pyetja mbledh informacion faktik nga fëmija, për të vërtetuar nëse fëmija ka qenë viktimë e një vepre penale. Pyetja duhet të jetë e përshtatshme për moshën e fëmijës dhe zhvillimin e tij, por nuk duhet të ngatërrohet me pyetjen terapeutike që bëhet me qëllimin për të përcaktuar trajtimin që i nevojitet fëmijës.

Në këtë aspekt, intervista e një viktime të trafikimit kërkon planifikim dhe përgatitje dhe duhet të ndjekë një strukturë.

⁶⁵ Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, Neni 18.

6.2 INTERVISTA E STRUKTURUAR

ÇFARË ËSHTË INTERVISTA?

Intervista e që një punonjës policie kryen qoftë me një dëshmitari apo një të dyshuar, është në thelb një bisedë. Ndonëse ka disa ndryshime kyçe nga bisedat në të cilat merrni pjesë çdo ditë, ka shumë më shumë ngjashmëri sesa ka dallime me to.

Një bisedë vijon si më poshtë:

- Shkëmben informacion
- Përfaqëson një marrëdhënie midis njerëzve që përfshihen në të
- Përfshin më shumë sesa thjesht fjalët e thëna, duke qenë se përfshin edhe komunikimin jo verbal

Ajo ka një strukturë. Çdo bisedë ka të njëjtat karakteristika:

- Hapja
- Shkëmbimi i informacionit
- Mbyllja

Në një bisedë të përgjithshme, ka disa 'rregulla' bazë

- Kërkohe bashkëpunim
- Niveli i bashkëpunimit është bërë i qartë
- Sapo të nisë, ekziston një detyrim për të vazhduar
- Mbyllja nuk duhet të ofendojë ose sjellë pështjellim

Konceptet formale të një bisede janë:

- Respektimi i radhës - pjesëmarrësit dëgjojnë dhe flasin me radhë.
- Kontrolli dhe shqetësimi - të jesh i vetëdijshëm për kohën, temën dhe si ndikon tek pjesëmarrësit e tjerë
- Përzgjedhja e temës - prezantohet duke bërë koment, duke ftuar një këndvështrim ose duke bërë një pyetje
- Marrëdhënia e pushtetit - struktura e një bisede mund të tregojë një 'marrëdhënie pushteti'

MARRËDHËNIA E PUSHTETIT

Struktura e një bisede shpesh pasqyron marrëdhënien e pushtetit midis pjesëmarrësve. Ajo madje mund të përdoret (me ose pa vetëdije) për të forcuar një marrëdhënie 'pushteti'.

Në mënyrë stereotipe, një pjesëmarrës 'i pushtetshëm' realizon shumicën dërrmuese të bisedës, kontrollon kalimin e 'radhës' te tjetri dhe vendos se cilat tema diskutohen. Të marra së bashku, kjo ka të ngjarë të nxisë sjellje të nënshtruar te pjesëmarrësi më pak i 'fuqishëm'.

Në rastin e Policisë, përfshihen një numër çështjesh. Edhe atje ku nuk ka sjellje aktive 'të pushtetit' nga ana e një intervistuesi të Policisë, fakti i thjeshtë që ata janë anëtarë të forcës së Policisë do të thotë se ka gjasë të konsiderohen të pushtetshëm nga personi që intervistohet. Ky person mund të përgjigjet në mënyrë të nënshtruar.

Disa oficerë policie mund ta shohin veten si 'të pushtetshëm' dhe ta kërkojnë kontrollin në mënyrë aktive duke folur më shumë, etj. Në të vërtetë, disa mund të besojnë se kjo qasje ku tregohet shumë siguri është rruga drejt së vërtetës.

Por, kjo qasje mund të ketë potencialisht pasoja serioze. Sa më shumë të flasë intervistuesi, aq më pak ka mundësinë të flasë personi që intervistohet. Nëse një intervistues flet pjesën më të madhe të kohës, ka më pak të ngjarë që ai ose ajo të jetë duke dëgjuar në çastin kur i intervistuari të përgjigjet.

Sa më shumë të flasë intervistuesi, aq më të shumta janë mundësitë që ai ose ajo të imponojë pikëpamjen e vet për atë që ka ndodhur, në vend që ta zbulojë këtë nga i intervistuari. Në këtë situatë, i intervistuari merr një mesazh të fortë se vendi i tij ose i saj është të dëgjojë dhe të mos flasë. Efekti i përgjithshëm është se tkurr ose eliminon informacionin që vjen nga personi që intervistohet.

Prandaj, kontrolli duhet të ushtrohet duke pasur parasysh kohën e të folurit dhe përzgjedhjen e temës dhe ecurinë e bisedës. Gjithashtu, intervistuesit duhet të jenë shumë të ndjeshëm ndaj dukurisë së 'marrëdhënies së pushtetit' dhe të marrin të gjitha masat e mundshme për të zvogëluar ndikimin e saj.

RIKUJTESË E LIRË

Ky sistem mund të përdoret në intervista për të inkurajuar të intervistuarit të kthehen në situatën kur ishin dëshmitarë të incidentit.

Intervista për rikujtesën e lirë përfshin:

- Kërkesën që dëshmitari të tregojë ngjarjen (et) përkatëse me fjalët e veta (p.sh. 'Më herët sot më thatë se keni parë diçka javën e kaluar, ju lutem më tregoni për atë ngjarje me fjalët tuaja')
- Marrja e një qëndrimi për dëgjimin aktiv, lejimi i dëshmitarit për të bërë një pushim dhe përdorimi i sa më pak udhëzuesëve sugjerues që nuk shkojnë përtej historisë së treguar të dëshmitarit.
- Reflektimi më pas për atë që ka thënë dëshmitari, sipas rastit
- Shmangia e ndërprerjes
- Identifikimi i temave ose episodeve të menaxhueshme në deklarin e dëshmitarit për t'u zgjeruar dhe sqaruar më tej
- Shqyrtimi sistematik i secilës temë ose episod, duke filluar me pyetje të hapura e duke përdorur fjalë të tilla si më tregoni, shpjegoni, përshkruani, para se të kaloni në pyetje specifike të mbyllura (p.sh., çfarë, ku, kur, si dhe pse)
- Shmangia e kapërcimit të temave (lëvizja me shpejtësi nga një temë në tjetrën dhe kthimit përsëri te e para)
- Shmangia e pyetjeve të shumëfishta
- Përdorimi i pyetjeve me zgjedhje të detyruar dhe pyetjeve drejtuese vetëm në rastet e domosdoshme
- Shqyrtimi sistematik i çdo informacioni të rëndësishëm për hetimin që dëshmitari nuk e ka trajtuar mjaftueshëm.

Për shembull, në rastin kur ka ndodhur një incident ndërsa dëshmitari po shkonte për në punë, hetuesi mund t'u kërkojë të kujtojnë se si ndiheshin kur hynë në automjetin e tyre atë mëngjes, çfarë panë kur u nisën nga shtëpia, si ishte moti, dhe trafiku.

Duke e ndihmuar dëshmitarin të rikujtojë hollësi të tilla do t'i mundësojë të rikujtojë më saktë kushtet që ekzistonin në kohën e incidentit.

Intervistuesi duhet të ndërmarrë një numër detyrash njëkohësisht kur zhvillon intervista rikujtuese të lira. Për këtë arsye, duhet të ketë një strukturë për marrjen e shënimeve në mënyrë të efektshme.

INTERVISTË PËR SIGURIMIN E PROVAVE

Intervistat për sigurimin e provave janë biseda që zhvillohen për një qëllim të caktuar - për të marrë një deklaram të saktë të një incidenti (ose një serie incidentesh) ose ngjarjeje nga viktimat, dëshmitarët ose të dyshuarit. Informacioni nga kjo intervistë përdoret së bashku me informacione të tjera për të vendosur për një mënyrë veprimi, siç është ngritja e akuzës ndaj një personi për një krim, kryerja e intervistave të mëtejshme apo realizimi i hetimeve të mëtejshme.

Edhe në rastet kur një intervistë nuk është e pranueshme drejtpërdrejt si provë (për shembull, disa hetime të fazës së parë të Policisë në disa juridiksione ose intervista nga agjenci të tjera pa një rol të drejtpërdrejtë ligjzbatues), është praktikë e mirë që të ndiqet një model ose plan interviste siç është modeli PEACE.

Një intervistë për sigurimin e provave nuk është përpjekje për të nxjerrë një rrëfim, për të marrë një histori që 'përshtatet' me prova të tjera, ose për të konfirmuar paragjykimet apo stereotipet e intervistuesit.

6.3 METODOLOGJIA E INTERVISTËS PEACE⁶⁶

Praktika e mirë për intervistimin e dëshmitarëve vulnerabël dhe të frikësuar (si të rriturit ashtu edhe të miturit) u mundëson atyre që të japin provat e tyre më të mira në procedimet penale.

PEACE është një model intervistimi i përdorur në disa vende në botë që zbatohet për intervistimin e të dyshuarve, të dëshmitarëve dhe të viktimave.

PEACE është një shkurtime fjalësh në gjuhën angleze i fjalëve të mëposhtme:

Planifikim dhe Përgatitje

Angazho dhe Shpjego

Rrëfimi i historisë

Mbyllje

Vlerëso

Më poshtë jepet një përmbledhje themelore e termave.

⁶⁶ Kolegji i Policimit i Mbretërisë së Bashkuar.

Planifikimi dhe përgatitja

Planifikimi dhe përgatitja mbulojnë shumë aspekte të intervistave. Në krahasim me intervistat e tjera, rastet e trafikimit të personave mund të kërkojnë planifikim shtesë për aspekte si gjetja dhe vënia në dispozicion e përkthyesve, ofruesit e shërbimeve sociale dhe akomodimi.

Angazhohu dhe shpjego

Në këtë fazë, vendoset raporti. Angazhimi nënkupton krijimin e një marrëdhënieje ose raporti me personin që intervistohet. Shpjegimi mund të jetë shumë i gjerë, sidomos në rastet e trafikimit. Në mënyrë tipike, viktimës duhet t'i tregohet se çfarë do të ndodhë gjatë intervistës, si mund të përdoren informacionet e marra si dhe të drejtat e viktimës.

Rrëfimi i historisë

Faza fillestare është ajo ku merret një rrëfim i pandërprerë nga personi që intervistohet. Ndonjëherë, njihet si "rikujtesë e lirë". Intervistuesit e ndjekin këtë qasje duke zgjeruar dhe duke qartësuar rrëfimin e treguar. Në shumë intervista, faza përfundimtare shqyrton dhe sqaron çdo mospërputhje në deklarin e dhënë.

Mbyllje

Në këtë fazë, përmbajtja e intervistës mund të përmbliidhet, viktimës i jepet mundësia të shtojë çdo gjë, dhe i thuhet se çfarë do të ndodhë më pas.

Vlerësimi

Kur përfundon intervista, ajo duhet të vlerësohet për të përcaktuar nëse janë arritur qëllimet dhe objektivat e saj, si ndikon në hetim informacioni i ri i marrë në intervistë, dhe si shkoj intervista në përgjithësi dhe çfarë përmirësimesh mund të bëhen.

Në rastet kur intervistuesit janë pjesë e një ekipi më të madh, vlerësimi duhet të bëhet me anëtarët përkatës të këtij ekipi.

6.3.1 PLANIFIKIMI DHE PËRGATITJA PËR INTERVISTA

Intervistimi i dëshmitarëve është një proces njerëzor, jo diçka që mbështetet në teknologji të tilla si aparatura për video dhe regjistrim kasetash. Këto makineri mund të ndihmojnë për ta bërë më të lehtë intervistimin, për të zvogëluar sfidat ligjore në gjykatë dhe për të përmirësuar cilësinë e dëshmisë së dëshmitarit. Por, ato nuk janë aspekti më i rëndësishëm i intervistimit. Ju jeni aspekti më i rëndësishëm.

Duhet t'i kushtohet vëmendje e kujdes planifikimit të intervistimit të dëshmitarëve vulnerabël. Koha e kaluar gjatë fazës së planifikimit do të rrisë mundësitë për të gjeneruar provat më të mira duke minimizuar mundësinë e gabimeve dhe mospërputhjeve në një fazë të mëvonshme.

Cila është historia deri më tani?

Ju nuk mund ta planifikoni një intervistë nëse nuk dini asgjë për rrethanat e çështjes. Hapi i parë duhet të jetë që të nisni të mësoni sa më shumë për rastin para se të filloni ta planifikoni intervistën.

Në rastet e trafikimit të personave kjo mund të jetë e vështirë, sidomos nëse intervista zhvillohet në fazat e hershme të një hetimi. Sfida tipike përfshijnë mospasjen e një gjuhe të përbashkët me viktimën, dhe faktin se viktimat e rikuperuar gjenden në rrethana që sugjerojnë se është trafikuar, por se viktimat nuk është e gatshme të flasë me ju.

Përkthyesit (Interpretët)

Në shumë raste, ka të ngjarë që të keni nevojë për një përkthyes (interpret) që herët kur jeni duke planifikuar për një intervistë.

Masa të tjera

Suksesi në intervista nuk varet vetëm nga ajo që ndodh në dhomën e intervistës. Duhet të trajtohen edhe çështje të tjera. Këto përfshijnë rreziqet për viktimën dhe të tjerët, shëndetin e viktimës, veshjen, ushqimin, akomodimin, statusin e qëndrimit dhe riatdhesimin e mundshëm.

Sa më shpejt që të jetë e mundur, bëni një vlerësim të rrezikut për viktimën dhe të tjerët. Në disa raste mund t'ju duhet të bëni pyetje të drejtpërdrejta dhe specifike në një fazë shumë të hershme me qëllimin për të vlerësuar rrezikun. Në varësi të rrethanave, paraqitja e këtyre pyetjeve mund të marrë përparësi në krahasim me vendosjen e raportit.

Plan i shkruar

Para realizimit të intervistës, është e rëndësishme të keni një plan të shkruar për intervistën. Intervistat e viktimave të trafikimit kanë gjasë të jenë komplekse për shkak të natyrës së procesit të trafikimit, numrit të njerëzve dhe vendndodhjeve që mund të referohen dhe efektit të viktimizimit të dëshmitari.

Renditja e pikave kryesore që do të trajtohen në një intervistë ndihmon për të ruajtur fokusin e intervistës. Kjo mund të jetë e dobishme sidomos në rast se viktimia rrëfen një histori shumë të gjerë që përmban tepër detaje që nuk janë të rëndësishme për hetimin. Nëse intervistuesi ka një listë, atëherë ai apo ajo nuk do të humbasin në detaje.

Planet e shkruara nuk nevojiten të jenë komplekse. Është e rëndësishme të jeni fleksibël që sapo të fillojë intervista, pasi mund t'ju tregojnë gjëra që e ndryshojnë plotësisht planin

Mbledhje planifikimi

Mund të jetë e këshillueshme një takim midis Policisë dhe prokurorisë për të diskutuar çështjet në fjalë. Për të vendosur nëse një dëshmitar vulnerabël do të intervistohet formalisht, duhet të ruhet baraspesha midis nevojës për të marrë provat më të mira dhe interesit më të lartë të dëshmitarit. Gjithashtu, duhet të arrihet një marrëveshje në lidhje me formën në të cilën do të merret deklarata.

Vlerësimi i dëshmitarit

Vlerësimi i hershëm individual nga një ekspert mund të jetë diçka e vlefshme për të identifikuar ndonjë vështirësi të veçantë që dëshmitari mund ta përjetojë në dhënien e një deklaratë të kënaqshme gjatë intervistës.

Vlerësimi duhet të bëhet në kohën midis herës së parë që viktimia vjen në vëmendje të Policisë, por para intervistës së parë. Intervistat para vlerësimit duhet të kufizohen në një numër të vogël fushash në mënyrë që të mbrojnë jetën e viktimës apo të viktimave të tjera ose të parandalojnë arratisjen e të dyshuarit.

Vendndodhja e intervistës

Në shumë juridiksione, vendndodhja e intervistës përcaktohet me ligj. Nëse në juridiksionin tuaj nuk ka një kërkesë ligjore të tillë, pyetja është: Ku duhet ta zhvilloni intervistën? A duhet që dëshmitari të vijë në një mjedis të njohur për intervistuesin, por i huaj për dëshmitarin apo është e mundur që dëshmitari të intervistohet në një mjedis të cilin e njeh dhe ndihet komod në të?

Si do të regjistrohet intervista?

Intervistat mund të regjistrohen në tri mënyra bazë: video, audio dhe me shkrim.

Nuk është gjithmonë aq e thjeshtë sa mund të duket të përcaktosh llojin e formatit që do të përdoret. Në disa situata, zgjedhja bëhet për ju: nëse nuk keni pajisje video në dispozicion, natyrisht që ky nuk qëndron si opsion. Faktorë të tjerë që mund të përcaktojnë formatin e regjistrimit përfshijnë zgjedhjen e dëshmitarit, politikat dhe legjislacionin lokale si dhe konsideratat taktike.

Kush duhet ta intervistojë viktimën?

Shumë juridiksione kanë legjislacion dhe praktikë të mirpërcaktuar se kush duhet t'i intervistojë viktimat. Nëse është e pranueshme, një praktikë e mirë është që të jenë dy intervistues, një për të zhvilluar rrëfimin e historisë nga viktimja dhe për të bërë pyetjet, tjetri për të vepruar si vëzhgues (vëren gjuhën e trupit për shembull) dhe për të marrë shënime të përgjithshme.

Në rast se intervistuesi i zgjedhur nuk është në gjendje të krijojë një raport me viktimën, parapëlqehet që intervistuesi të ndërrohet menjëherë.

Një ekip special me kohë të plotë për intervistimin e çështjeve të trafikimit të personave mund të ofrojë mundësinë më të mirë për të pasur sukses në intervistimin e një viktime. Megjithatë, kjo ka të ngjarë të jetë një burim i kushtueshëm që pak agjenci ligjzbatuese mund ta përballojnë. Njësi të tjera të specializuara kanë disa nga aftësitë e kërkuara, por jo të gjitha.

Hetuesit pa përvojë ose trajnim të mëparshëm në intervistimin e dëshmitarëve vulnerabël do të merreshin me viktimën si me çdo dëshmitar tjetër. Është vërejtur dhe raportuar se disa hetues e sfidojnë historinë e rrëfyer të një viktime më herët se duhet dhe në faza të papërshtatshme.

Gjinia e intervistuesve

Gjinia e një intervistuesi nuk garanton cilësi të veçanta. Si burrat edhe gratë mund të shfaqin dhembshuri, të jenë të motivuar dhe profesionistë; po ashtu, si burrat edhe gratë mund të shfaqin mungesë interesi, të jenë të vrazhdë dhe të paaftë. Ajo që duhet të konsiderohet si faktor kritik është kërkesa e viktimës. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të përmbushur një kërkesë specifike për një intervistuese femër ose intervistues mashkull.

Mbështetja sociale/përdorimi i ndërmjetësve në intervistë

Roli i “mbështetësit social” ose ndërmjetësit me gjasë përcaktohet nga legjislacioni. Në disa juridiksione, ndërmjetësuesit janë për të ndihmuar dëshmitarin që të kuptojë intervistuesin, dhe intervistuesin për të kuptuar dëshmitarin. Ky nuk është një rol përkthimi por për të ndihmuar komunikimet ku një person mund të mos jetë në gjendje të kuptojë për shkak të dëmtimit mendor ose fizik ose për shkak se viktimja është e re.

Ndërmjetësuesit mund të kufizohen në mbështetjen që mund të japin. Cilido që të jetë roli i saktë, ndërmjetësit nuk duhet të ndërhyjnë në intervistë, të ndryshojnë atë që thuhet apo të bindin të intervistuarit të ndryshojnë historinë e tyre.

Kohëzgjatja e intervistës

Seksionet “Ritmi” dhe “Kohëzgjatja” (më poshtë) japin disa udhëzime për çështje të veçanta që hasen në intervistat me dëshmitarë-viktima të trafikimit. Një tipar domethënës është se këto intervista me gjasë zgjasin shumë më tepër se intervistat në shumë hetime të tjera. Kjo duhet të merret parasysh në fazën e planifikimit, sidomos kur vendoset se kush do të jetë në gjendje ta zhvillojë intervistën. Po ashtu, duhet parë disponueshmëria e përkthyesve, etj., si dhe se sa shpesh dhe sa gjatë duhet të jenë periudhat e pushimit.

Intimidimi

Nëse dyshohet se provat e dëshmitarit mund të ndikohen negativisht nga kërcënimet dhe intimidimi, duhet t'i kushtohet vëmendje e kujdesshme mbështetjes së nevojshme për t'u marrë me këto intimidime.

6.3.2 ZHVILLIMI I INTERVISTËS

Sjellja gjatë intervistës

Kur takoni njerëz që nuk i njihni, silleni ndryshe nga sjellja e zakonshme. Njerëzit vulnerabël shpesh mund ta ndiejnë sjelljen e pazakontë dhe mund ta identifikojnë këtë sjellje si shenjë sikleti.

Në pjesën më të madhe të rasteve të trafikimit me gjasë nuk e keni takuar më parë personin që po intervistoni; gjithashtu ka shumë mundësi që personi të vijë nga një kulturë tjetër, madje edhe nga një kulturë të cilën e njihni fare pak. Ata mund të flasin një gjuhë tjetër dhe të kenë pak përvoja jete që kanë të përbashkëta me ju. Është e kuptueshme që mund to ndiheni disi në siklet në këto situata.

Të gjitha viktimat vulnerabël mundet që të jenë të traumatizuara dhe të shqetësuara. Viktimat e trafikimit mund t'i kenë abuzuar për një periudhë të gjatë kohore, shumë njerëz, dhe në mënyra intime. Mund t'u kenë marrë kontrollin mbi jetën e tyre për muaj apo edhe vite më parë. Si pasojë, ka një traumatizim jashtëzakonisht të thellë, afatgjatë dhe i fuqishëm, çka mund të bëjë që viktimat të sillen në një numër mënyrash që hetuesit mund ta kenë të vështirë për ta kuptuar dhe trajtuar.

Gjithmonë duhet të mbahet parasysh se viktimat e trafikimit janë edhe të mbijetuar; për të mbijetuar ata do të kenë zhvilluar mënyra për ta përballuar situatën, njëra prej të cilave ka të ngjarë të jenë dyshues për atë që u thotë dikush, përfshirë intervistuesin.

Sjellja në të cilën çon ky kombinim i rrethanave mund të përfshijë reagimin në mënyrë të paparashikueshme, të zemëruar ose agresive ndaj jush dhe cillitdo prej profesionistëve të tjerë të përfshirë.

Ritmi

Shumë dëshmitarë vulnerabël mund të kërkojnë që intervistat e tyre të zhvillohen me një ritëm më të ngadaltë se të tjerë. Si studimet edhe praktika më e mirë kanë gjetur se intervistuesit do të duhet:

- të ngadalësojnë shpejtësinë e të folurit;
- të lejojnë kohë shtesë që dëshmitari të kuptojë atë që sapo është thënë;
- të sigurojnë kohë të mjaftueshme që dëshmitari të përgatisë një përgjigje;
- të jenë të durueshëm nëse dëshmitari përgjigjet ngadalë, veçanërisht nëse po përdoret një ndërmjetës;

- të shmangë parashtimin e pyetjes tjetër menjëherë;
- të lejojë hapësirë për periodha heshtjeje - kjo ju lejon edhe të përgatisni intervistën më tej.
- të mos e ndërpresë viktimën.

Intervista duhet të zhvillohet me ritmin e përcaktuar nga dëshmitari.

Në rastet kur zhvillohet me ndihmën e një përkthyesi, duhet të përdorni fraza të shkurtra. Këto fraza duhet të jenë pjesë e pyetjeve koncize.

Lejoni kohë të mjaftueshme që pyetja dhe përgjigja të përkthehen para se të bëni pyetje të tjera.

Pushimet gjatë intervistës

Intervistat me dëshmitarë vulnerabël zakonisht kryhen me një ritëm më të ngadaltë sesa ato me dëshmitarë të tjerë. Për më tepër, këto intervista zakonisht përfshijnë edhe më shumë pushime dhe pauza. Shumë dëshmitarë vulnerabël nuk do të jenë në gjendje të përqendrohen aë gjatë sa të tjerë, dhe disa prej tyre do të kërkojnë edhe pushime të rregullta për të qenë më rehat. Intervistuesi duhet të dakordësohet me dëshmitarin për një shenjë të thjeshtë (p.sh. përdorimi i një karte të veçantë) të cilën dëshmitari mund të përdorë për të kërkuar pushim. Pushimi mund të jetë një mundësi për freskim. Pushimet e tilla nuk duhet të përdoren në asnjë mënyrë si joshje për dëshmitarët.

Pushimet duhet të lejohen edhe për qëllime të respektimit të riteve fetare.

Kohëzgjatja

Intervistat e viktimave-dëshmitarëve të dyshuar të trafikimit mund të zgjasin më shumë sesa ato në rastet e përgjithshme për shkak të efekteve të traumës dhe kompleksitetit të çështjeve. Intervistat e gjata mund të bëhen shumë stresuese për viktimat. Nevoja për një rëfzim të plotë dhe të saktë të historisë duhet të baraspeshohet me nevojën që kanë viktimat për t'u rikuperuar. Intervistat duhet të zhvillohen sa më të shkurtra duke mbajtur parasysh rrethanat.

Vendosja e raporteve

Fazat e hapjes së intervistës kanë një rëndësi kritike për suksesin e saj.

Një fazë ku vendosen raporte të rëndësishme u krijon mundësinë intervistuesve që të kenë kohë të mjaftueshme të njihen më shumë me metodën të komunikimit që parapëlqen dëshmitari dhe të bëhet më kompetent me këtë metodë. Gjithashtu, kjo fazë duhet të lejojë që të rishikohen sipas nevojës vendime të mëparshme të marra gjatë fazës së planifikimit.

Një tjetër qëllim i rëndësishëm i fazës së vendosjes së raporteve është ndihma për dëshmitarin, dhe në të vërtetë intervistuesin, të ndihet i çliruar dhe sa më komod. Ndërkohë që intervistuesit ndihen më familjar dhe komod me intervistimin e dëshmitarëve vulnerabël, ata mund të tundohen të shkurtojnë fazat e vendosjes së raporteve. Ky tundim duhet luftuar, sepse ndonëse intervistuesi mund të ndihet më komod me intervista të tilla, dëshmitarët nuk do të ndihen në të njëjtën mënyrë.

Në një moment të përshtatshëm në fazën e vendosjes së raporteve, nëse dëshmitari nuk e ka përmendur në mënyrë spontane, intervistuesi duhet të diskutojë me dëshmitarin shkurtimisht qëllimin e intervistës në atë mënyrë që nuk i referohet drejtpërdrejt një shkeljeje të pretenduar. Intervistuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se ndonëse disa të intervistuar, që nga fillimi, mund të jenë shumë të qartë në lidhje me intervistën, ka të intervistuarit tjerë që mund të mos jenë të qartë.

Disa dëshmitarë mund të mendojnë se bashkëpunimi i tyre i hershëm, i ligjshëm me një person që më pas ka kryer një vepër penale mund t'i bëjë ata persona të dyshuar . Intervistuesi duhet të mbajë parasysh edhe faktin se disa dëshmitarë vulnerabël mund të presupojnë se për shkak se po intervistohen, ata kanë bërë diçka të gabuar. Intervistuesit mund t'i duhet ta sigurojë dëshmitarin në këtë pikë, por nuk duhet të bëhen premtime ose parashikime për rezultatin e mundshëm të intervistës.

Për aq sa të jetë e mundur, intervista duhet të zhvillohet në një atmosferë “neutrale”, ku intervistuesi kujdeset të mos prezumojë, apo të duket se prezumon, fajësinë e një individi, sjellja e pretenduar e të cilit mund të jetë objekt i intervistës.

Përveç kësaj, për individë që ndoshta nuk janë mësuar të bisedojnë me dikë që ngre pyetje mbi thelbin e deklaratave të viktimës, intervistimi mund të jetë diçka e pazakonshme. Kjo ndodh sidomos në rastin e një intervistë me një person të panjohur, që është njëkohësisht edhe një autoritet. Dëshmitari mund të hyjë në intervistë i paqartë për qëllimin e saj, në ankth për procesin dhe rezultatin e saj, dhe ndoshta i stresuar nga ngjarjet e mëparshme. Për më tepër, disa dëshmitarë mund të mos e kuptojnë arsyen se pse po intervistohen për përvoja të sikletshme dhe të dhimbshme. për të cilat mund t'u jetë thënë të mos flasin.

Intervistuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se t'i kërkosh dikujt të japë informacion në mënyrë të hapur dhe të hollësishme në lidhje me çështjet personale (p.sh. ku përfshihet seksi) do të thotë t'i kërkosh personit të diskutojë diçka në një mënyrë të tillë që ata kanë mësuar ta shmangin. Intervistuesi duhet t'u tregojë dëshmitarëve se atyre nuk do t'u bëhen pyetje thjesht për kureshtje, por sepse është i nevojshëm një përkrahim i hollësishëm i krimit.

Dhënia e hollësive të tilla në këtë situatë nuk do të thotë shkelje e privatësisë . Gjithashtu, intervistuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se disa të intervistuar mund të preferojnë që fillimisht më shumë t'i shkruajnë sesa t'i thonë me zë fjalë ose fraza të ndjeshme.

Disa dëshmitarë mund të mos ndihen komod, ose ndihen në siklet apo edhe të nxehur kur merren në pyetje, sidomos për çështje personale. Në fazën e vendosjes së raporteve dhe gjatë gjithë intervistës, intervistuesi duhet t'i përcjellë dëshmitares/it se ajo/ai ka respekt, simpati dhe mirëkuptim për mënyrën se si ndihet dëshmitari.

Dëshmitari mund të ndihet në ankth për atë që mund të ndodhë pas intervistës nëse ajo/ai tregon atë që ka ndodhur. Shqetësime tilla duhet të trajtohen.

Mund të ndodhë që disa dëshmitarë vulnerabël nuk e perceptojnë nevojën për ta treguar historinë e përvojave të tyre në mënyrë të plotë dhe të hollësishme. Prandaj duhet të shpjegohet pse lind nevoja për një histori të plotë, pa ushtruar presion të panevojshëm mbi dëshmitarin.

Kur diskutohen ngjarje “neutrale”, i intervistuari mund të inkurajohet, nëse është e përshtatshme, të rikujtojë lirshëm dhe të çmojë faktin se është i intervistuari ai që ka informacionin. Përpjekja për të vijuar me intervistën pa krijuar një raport me të intervistuarin mund të rezultojë problematike.

Disa dëshmitarë nuk janë mësuar të vendosin raporte me të panjohur. Në të vërtetë, shumë prej tyre janë mësuar të mos e bëjnë këtë. Nëse vendosja e raporteve rezulton të jetë e vështirë, mund të preferohet që intervista të shtyhet për një moment tjetër sesa të vazhdohet më tej pa rezultat.

6.3.3 RRËFIMI I HISTORISË

Deklarimi i lirë

Nëse nuk kështë arritur të vendoset një raport me dëshmitarin, nuk ka shumë kuptim të vazhdoni dhe duhet të konsideroni ndërprerjen e intervistës. Arsye të tjera për ndërprerjen e intervistës përfshijnë shëndetin (fizik dhe mendor) e viktimës, rreziqet që keni identifikuar për viktimën dhe të tjerë, ose pamundësinë apo ngurrimin e viktimës t'ju japë ndonjë informacion të dobishëm.

Pas mbylljes së intervistës duhet të vlerësoni se çfarë ka ndodhur, të identifikoni çdo veprim që duhet të ndërmerret, dhe të rishikoni se si duhet të vijohet më tej me rastin.

Nëse vendosni se është e përshtatshme të vazhdohet me intervistën, dëshmitarit duhet t'i kërkohet, kurdoherë që të jetë e mundur, të paraqesë me fjalët e saj/tij një rrëfim të ngjarjes(eve) përkatëse.

Dëshmitarët ka të ngjarë të presin që ju, si figurë apo autoritet, të kontrolloni intervistën. Megjithatë, intervista me dëshmitarët kërkon që fluksi i informacionit të kalojë nga dëshmitari te intervistuesi. Disa dëshmitarë vulnerabël mund të mendojnë se ju tashmë dini shumë ose gjithçka rreth asaj që ka ndodhur dhe se ata pritët thjesht të konfirmojnë versionin tuaj të ngjarjeve.

Është shumë e rëndësishme që t'u tregoni dëshmitarëve, në atë mënyrë që ata ta kuptojnë, se ju nuk e dini se çfarë ka ndodhur me ta dhe do ta merrni vesh kur ata t'ju tregojnë.

Në këtë fazë, ju duhet të bëni vetëm pyetjet më të përgjithshme, të hapura. Këto pyetje duhet të kenë të bëjnë me fushat e përgjithshme të përvojës jetësore që kanë lidhje me hetimin (p.sh. "A ka ndonjë gjë që dëshironi të më tregoni?"). Kjo lloj pyetjeje është ajo që e kërkon informacionin në një mënyrë jo specifike.

Nëse dëshmitari nuk ka thënë asgjë të rëndësishme për hetimin, duhet të shqyrtoni faktin nëse duhet të vazhdoni më tej në fazën tjetër të intervistës (p.sh. marrjen në pyetje) apo jo. Për ta marrë këtë vendim, duhet të merren parasysh si nevojat e dëshmitarit edhe të drejtësisë; në disa raste të jashtëzakonshme, mund të vendosni ta ndërprisni intervistën duke kaluar drejtpërdrejt në fazën e Mbylljes. Pasi të keni mbyllur intervistën, duhet të kaloni në fazën e Vlerësimit.

Pajtueshmëria

Disa të intervistuar vulnerabël mund të përpiqen të pajtohen me atë që mendon ose dëshiron intervistuesi, sidomos dëshmitarët që e shohin intervistuesin si autoriteti. Gjithashtu, disa dëshmitarë mund të tremben nga autoriteti. Duhet të përpiqeni sa të mundeni që të mos paraqiteni si autoritet.

Shumë persona vulnerabël preokupohen që ta paraqesin veten në 'optikën' më të mirë të mundshme. Ndonëse mund të mos e kuptojnë pyetjen, dëshmitarët vulnerabël mund të preferojnë më shumë t'i përgjigjen gjithsesi sesa të thonë që nuk e kuptojnë. Të thuhet se nuk e kuptojnë pyetjen mund të konsiderohet se ose intervistuesi ose dëshmitari ka faj. Disa të intervistuar vulnerabël do të preferojnë të shmangin situata të tilla. Është konstatuar se të intervistuarit që mendojnë se kanë një farë kontrolli mbi jetën e tyre shfaqin më pak pajtueshmëri sesa ata që mendojnë se nuk kanë asnjë kontroll. Për këtë arsye, kur dëshmitari lejohet të ketë një masë kontrolli mbi intervistën me gjasë mund ta përmirësojë cilësinë e saj.

Dakordësimi dhe konformimi

Dëshmitarët vulnerabël gjithmonë mund të përgjigjen “Po” kur u bëhen pyetje me përgjigje “po/ jo”, edhe në rastet kur u bëhet një pyetje pothuajse identike “po/jo” më vonë, por me kuptimin e kundërt. Kjo nuk është vetëm për shkak se viktima është viktimë: nëse pyetjet janë të komplikuara ose bëhen në mënyrë autoritare, dëshmitarët thjesht mund ta kenë më të lehtë dhe më pak stresuese të vazhdojnë të thonë “po”.

Gjithashtu mund të hasni se dëshmitari gjithmonë thotë “Jo” ndaj një pyetjeje që kërkon përgjigje “po/jo”. Një arsye e zakonshme për këtë përgjigje është se po pyeten për sjellje që nuk janë të pranueshme në kulturën e tyre.

Edhe pse pyetjet e mbyllura që kërkojnë thjesht përgjigje “po/jo” përdoren shpesh në bisedat e përditshme, mundohuni ta shmangni përdorimin e tyre, kur të intervistoni viktima vulnerabël. Shpesh është e mundur që një pyetje “po/jo” të ndryshohet në një pyetje “ose/ose”, dhe studimet kanë konstatuar se kjo prodhon përgjigje më të besueshme sesa një qasje me pyetjet “po/jo”. Edhe kur përdoret qasja “ose /ose”, një numër i vogël i njerëzve gjithmonë do të pajtohen me opsionin e dytë. Një teknikë që mund të përdorni për të zbuluar nëse po ndodh kjo gjë është të mendoni se cili opsion ka më shumë të ngjarë të jetë i saktë dhe herë ta vendoseni të parin dhe herë të dytin. E njëjta metodë është praktikë e mirë nëse nuk mund të shmangni përdorimin e pyetjeve “po/jo”.

Stilet e pyetjeve - Qasja e përgjithshme

Gjatë fazës së tregimit të lirë të një interviste, pjesa më e madhe e dëshmitarëve nuk do të jenë në gjendje t’i kujtojnë të gjitha informacionet përkatëse që kanë në kujtesë. Në fazën e tregimit të lirë, dëshmitarit i kërkohet të përpiqet të kujtojë çfarë ka ndodhur dhe t’ju tregojë për këtë. Shumë njerëz vulnerabël e kanë të vështirë ta bëjnë këtë për një sërë arsyesh të mundshme: ata mund të mos mbajnë mend, mund të jenë përpjekur shumë për t’i harruar kujtimet e dhimbshme ose mund të ndjehen të frikësuar ose të stresuar.

Parashtrimi i pyetjeve të përshtatshme që ndihmojnë në rikujtimin e mëtejshëm mund të ndihmojë shumë në rrëfimin e historisë. Sidoqoftë, si hulumtimi edhe praktika më e mirë kanë konstatuar se të intervistuarit vulnerabël mund të hasin vështirësi të mëdha me pyetjet në rastet kur:

- Pyetjet nuk janë të thjeshta
- Përmbajnë zhargon
- Pyetjet përmbajnë fjalë abstrakte dhe/ose ide abstrakte
- Pyetjet trajtojnë disa tema njëkohësisht
- Janë shumë udhëzuese ose sugjeruese.

Është e rëndësishme të kuptohet se ekzistojnë lloje të ndryshme pyetjesh që ndryshojnë për nga mënyra se sa udhëzuese janë. Për sa është e mundur, faza e pyetjeve duhet të fillojë me pyetje të hapura dhe pastaj të kalojë, nëse është e nevojshme, në pyetje specifike dhe pyetje të mbyllura. Pyetjet udhëzuese duhet të përdoren vetëm si një mundësi e fundit.

Kur merret në pyetje një dëshmitar, intervistuesit mund të bëjnë lloje të ndryshme pyetjesh për një çështje para se të vazhdojnë të bëjnë pyetje për një çështje tjetër; kjo është praktikë e mirë për sa i përket mënyrës së organizimit të kujtesës. Pyetjet për secilën çështje duhet të fillojnë si rregull me një pyetje të hapur.

Pyetje të hapura

Pyetjet e hapura janë ato që formulohen në mënyrë të tillë që i mundësojnë dëshmitarit të japë një përgjigje të pakufizuar. Gjithashtu, ato i mundësojnë dëshmitarit të kontrollojë fluksin e informacionit. Këto lloj pyetjesh minimizojnë rrezikun që intervistuesit të imponojnë pikëpamjen e tyre për çfarë ka ndodhur. Pyetje të tilla zakonisht specifikojnë një temë të përgjithshme, e cila i mundëson dëshmitarit liri të konsiderueshme për të vendosur se çfarë do të përgjigjet.

Nëse dëshmitari u përgjigjet pyetjeve të hapura, mos e ndërprisni edhe nëse dëshmitari nuk po jep llojin(et) e pritur të informacionit. Ndërprerja e dëshmitarit ia merr pushtetin asaj ose atij dhe sugjeron se kërkohen vetëm përgjigje të shkurtra. Nëse një dëshmitar ju tregon diçka që nuk e kuptoni, mos e ndërprisni. Prisni derisa të mbarojë dhe pastaj përpuni të sqaroni ato që kanë thënë.

Pyetje të mbyllura

Pyetjet e mbyllura i japin të intervistuarit një numër të kufizuar përgjigjesh alternative. Për sa kohë që pyetja ofron një numër alternativash sa sensible dhe të mundshme, nuk do të konsiderohej sugjestionuese. Disa dëshmitarë vulnerabël mund t'i konsiderojnë pyetjet e mbyllura shumë ndihmuese. Megjithatë, në fillim të përdorimit të pyetjeve të mbyllura, përpuni të shmangni ato që përmbajnë vetëm dy alternativa (veçanërisht pyetjet po/jo) përveç rastit kur këto dy alternativa përmbajnë të gjitha mundësitë (p.sh. "A ishte ditë apo natë?"). Nëse përdoren pyetje që përmbajnë vetëm dy alternativa, atëherë ato duhet të formulohen në mënyrë të tillë që disa herë të rezultojnë në zgjedhjen e alternativës së parë dhe herë të tjera të alternativës së dytë.

Disa dëshmitarë të prekshëm mund të jenë në gjendje t'u përgjigjen vetëm pyetjeve të mbyllura që përmbajnë dy alternativa. Madje edhe në rrethana të tilla, përsëri duhet të jetë e mundur që të shmangni një intervistë hetimore ku kryesisht bëhen pyetje drejtuese. Megjithatë, intervista të tilla mundet të kërkojnë ekspertizë të veçantë dhe planifikim të gjerë, sidomos në lidhje me pyetjet që duhet të bëhen.

Nëse përdorni pyetje të mbyllura, është tejet e rëndësishme t'i kujtoni dëshmitarit se përgjigjet "Nuk e di", "Nuk e kuptoj", ose "Nuk mbaj mend" janë të mirëseardhura dhe se ju nuk e dini se çfarë ka ndodhur. Nëse një dëshmitar përgjigjet, "Nuk e di" në një pyetje "ose-ose" (p.sh. "A ishte makina e madhe apo e vogël?") përpuni atëherë ta shmangni duke ofruar një pyetje kompromisi "po-jo" (p.sh. "Nëse nuk ishte e madhe apo e vogël, a do të thoshit se ishte mesatare? ") me të cilën dëshmitari mund të pajtohet.

Pyetje drejtuese

Pyetje drejtuese është ajo që e nënkupton përgjigjen ose që presupozon se diçka është një fakt. Nëse një pyetje është drejtuese apo jo varet nga natyra e pyetjes si dhe nga çfarë ka thënë dëshmitari tashmë në intervistë. Mbrojtja mund të kundërshtojë provat nga një pyetje drejtuese duke rezultuar në moslejimin e tyre për t'u dëgjuar në gjykatë.

Studimet psikologjike sugjerojnë se përgjigjet e të intervistuarve ndaj pyetjeve drejtuese priren të përcaktohen nga mënyra se si dëshmitarët merren në pyetje më shumë sesa nga ato që mbajnë mend.

Nëse bëni një pyetje drejtuese në lidhje me fakte të rëndësishme të çështjes që nuk janë përshkruar më herët nga dëshmitari, intervista ka të ngjarë të ketë shumë pak vlerë në një çështje gjyqësore.

Të kuptosh se çfarë po përpiqet të thotë dëshmitari

Disa dëshmitarë vulnerabël mund të shprehen me fjalë ose forma të tjera të komunikimit që njerëzit e zakonshëm e kanë të vështirë të kuptojnë. Në çaste të duhura në intervistë, sidomos në fazën e mbylljes (shih më poshtë), duhet t'i reflektoni dëshmitarit atë që intervistuesi beson se ka komunikuar dëshmitari. Kur domethënia e komunikimit të dëshmitarëve është e paqartë, atij/asaj mund t'i kërkohet, për shembull, duke i thënë “ta themi ndryshe” ose “A mund të mendoni për të ma treguar në një mënyrë tjetër?”

Objekte për të ndihmuar rikujtesën

Për të rikujtuar ngjarjen, mund të vijë në ndihmë përdorimi i objekteve të ngjashme me ato të përfshira në ngjarjen përkatëse. Nga ana tjetër, ato mund të shkaktojnë edhe shqetësim të dëshmitari. Më tej, mund të mos jetë e sigurt se cilat objekte janë përfshirë në të vërtetë, dhe futja e objekteve të pasakta mund të çorientojë dhe/ose hutojë dëshmitarin. Po ashtu, modelet ose objektet e lodrave mund të jenë çorientuese nëse objektet që ato përfaqësojnë nuk kanë qenë pjesë e ngjarjes që përshkruhet.. Disa dëshmitarë vulnerabël mund të mos e kuptojnë lidhjen midis një lodre apo modeli dhe objektit të jetës reale që supozohet të përfaqësojë.

Mbyllja e intervistës Përmbledhja

Gjatë mbylljes së intervistës, intervistuesi mund të duhet të kontrollojë me dëshmitarin se i ka kuptuar saktë pjesët e rëndësishme për qëllime të provave (nëse ka) nga historia e treguar nga dëshmitari. Kjo duhet të bëhet duke përdorur atë që dëshmitari ka komunikuar, jo një përmbledhje të dhënë nga intervistuesi (i cili mund të gabohet, por që dëshmitari mund të pajtohet gjithsesi). Duhet pasur kujdes që të mos përcillet mosbesim.

6.3.4 MBYLLJA

Intervistuesi duhet të përpiqet gjithmonë të sigurohet që intervista të përfundojë në mënyrë të duhur.

Megjithëse mund të mos jetë gjithmonë e nevojshme të kaloni nëpër secilën nga fazat e mësipërme para se të kaloni në fazën e radhës, duhet të ketë arsye të mjaftueshme për të mos vepruar në këtë mënyrë. Çdo intervistë duhet të ketë një fazë përmbylljeje. Në këtë fazë, mund të jetë e vlefshme që të diskutohen përsëri disa nga temat “neutrale” të përmendura në fazën e vendosjes së marrëdhënieve.

Në këtë fazë, pavarësisht nga rezultati i intervistës, duhet bërë çdo përpjekje për të siguruar që dëshmitari të mos jetë i dëshpëruar dhe të jetë në gjendje mendore pozitive. Edhe nëse dëshmitari ka dhënë pak ose aspak informacion, ajo/ai nuk duhet të ndihet se ajo/ai ka dështuar ose ka zhgënjyer intervistuesin.

Dëshmitari duhet të falënderohet për kohën dhe përpjekjen e saj/tij dhe të pyetet nëse ka diçka tjetër për të shtuar. Dëshmitarit duhet të informohet çfarë mund të ndodhë më pas.

Nuk duhen bërë premtime që nuk mund të mbahen në lidhje me zhvillimet në të ardhmen. Duhet treguar kujdes i veçantë për të mos bërë premtime në lidhje me statusin e qëndrimit, se viktimat nuk do të duhet të japë prova ose se një person do të akuzohet.

Dëshmitari gjithmonë duhet të pyetet nëse ajo/ai ka ndonjë pyetje, dhe këto pyetje duhet të marrin përgjigje sa më të përshtatshme. Është praktikë e mirë t'i jepet dëshmitarit një emër kontakti dhe numër telefoni në rast se dëshmitari më vonë vendos që ajo/ai të ketë çështje të tjera që dëshiron të diskutojë me intervistuesin.

Jo vetëm në mbylljen e intervistës, por edhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, intervistuesi duhet të jetë i përgatitur për ta ndihmuar dëshmitarin të përballojë efektet e rrëfimit të një historie që mund të ketë qenë një ngjarje shumë shqetësuese (dhe për të cilën dëshmitari mund të ketë ndonjë ndjenjë faji)

Në përfundim të intervistës, dëshmitarëve në moshë madhore, vulnerabël ose të intimiduar, dhe që janë viktimë duhet t'u jepet mundësia të bëjnë një deklaratë personale të viktimës për të shprehur se çfarë efekti ka pasur krimi mbi ta, si dhe për të ndihmuar në identifikimin e nevojës që kanë për informacion dhe mbështetje.

Deklarata duhet të merret në të njëjtin format si deklaratat e dëshmitarit, pra, kur është dhënë një intervistë e regjistruar në video, deklarata personale e viktimës duhet gjithashtu të regjistrohet me video. Dhënia e deklaratës personale të viktimës (e regjistruar video ose e shkruar) është krejtësisht mbi baza vullnetare.

Dëshmitarëve duhet t'u ofrohet informacion se ku mund të merret mbështetje e menjëhershme. Për dëshmitarët, duhet të jetë e disponueshme edhe një fletëpalosje me emrat, adresat dhe numrat e telefonit të individëve dhe ofruesve të shërbimeve mbështetëse. Kur është e mundur, punonjësit e forcave të zbatimit të ligjit duhet të jenë familjar me mënyrën e referimit të viktimave/dëshmitarëve tek ofruesit e shërbimeve, apo ti tregojnë se si mund ti gjejë ato.

6.3.5 VLERËSIMI

Në këtë fazë, intervistuesi duhet të gjykojë nëse janë arritur qëllimet dhe objektivat e intervistës apo jo, si ndikojnë në hetim njohuritë e zbuluara gjatë intervistës, sa mirë e kanë kryer intervistën dhe çfarë mund të përmirësohet në të ardhmen.

Intervista të mëtejshme

Një prej qëllimeve kryesore të regjistrimit video në intervistat e hershme hetimore është që dëshmitarëve t'u kërkohet ta tregojnë sa më pak herë historinë e saj/tij. Sidoqoftë, edhe me një intervistues me përvojë dhe i aftë, dëshmitari mund të japë më pak informacion se sa ai ose ajo është në gjendje të zbulojë. Për këtë arsye, mund të jetë e nevojshme intervista plotësuese dhe ajo duhet të regjistrohet me video, nëse është e mundur.

Gjithmonë duhet të mbahet parasysh nëse mbajtja e një interviste të tillë do të ishte në interesin më të lartë të dëshmitarit. Arsyet për intervistat plotësuese duhet të shprehen qartë dhe të regjistrohen me shkrim.

Në rastin e dëshmitarëve tejet vulnerabël, mund të merret një vendim që në fazën e planifikimit për ta ndarë intervistën në disa pjesë që zhvillohen nga i njëjti intervistues në ditë të ndryshme, ose në kohë të ndryshme në të njëjtën ditë, ku në çdo rast arrihet vendosja e raportit dhe mbyllja.

Gjithmonë ekziston mundësia që në një kohë të mëvonshme viktimat të mendojnë se ndikimi i përvojës ka qenë i tillë sa që të kërkohet një deklaratë e dytë. Është praktikë e mirë të pyetet dëshmitarin nëse ai/ajo dëshiron të bëjë një deklaratë të dytë ndikimi menjëherë para seancës gjyqësore ose në periudhën midis seancës dhe dhënies së vendimit. Kjo i mundëson gjykatës të

marrë parasysh çdo traumë afatgjatë që ka pësuar viktimat dhe nuk e lejon mbrojtjen që të mohojë vlerësimin e ndikimit fillestar duke sugjeruar se viktimat nuk ndihet më në të njëjtën mënyrë muaj më vonë.

6.4 INTERVISTIMI I VIKTIMAVE FËMIJË

Për çdo veprim viktimë ose viktimë të mundshme trafikimi fëmijë, duhet të merret në konsideratë interesi më i lartë të fëmijës. Kjo është 'një qasje e praktikës më të mirë ndërkombëtare' e cila bazohet në të drejtën ndërkombëtare si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (UNCRC) 1989, ratifikuar nga Shqipëria më 11 dhjetor 1991.

Praktikisht, kjo do të përfshinte:

- Pas kontaktit të parë, menjëherë referojini fëmijët viktimat të mundshme te punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve (PMF) ose pranë një ofruesi shtetëror ose jo shtetëror shërbimesh që ofron ndihmë për fëmijët.
- Kur është e mundur, fëmijët viktimat duhet të intervistohen nga oficerë të trajnuar posaçërisht të të njëjtit seks.
- Ndaj fëmijës në asnjë moment nuk duhet të ushtrohet dhunë psikologjike apo fizike për ti detyruar të flasin, , për shembull, duke u bërtitur, duke i detyruar të flasin, duke i abuzuar verbalisht ose duke i qëlluar.
- Fëmija duhet të ndihet komod dhe i sigurt kur tregon historinë e vet.
- Fëmija duhet të kuptojë se si ai/ajo do të ndihmohet dhe do të mbrohet.
- Fëmijët viktimat nuk duhet të ndalohen ose të ndjehen sikur janë ndaluar.
- Fëmija viktimë duhet të transferohet në një vend të sigurt dhe të përshtatshëm si strehëza apo vende të tjera akomodimi, sa më shpejt të jetë e mundur.
- Të gjithë fëmijët viktimat duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pavarësisht nga klasa, gjinia, aftësia/aftësia e kufizuar, gjuha, feja, raca, etnia apo kombësia.
- Të gjithë fëmijët viktimat të mundshme të trafikimit duhet të marrin ndihmë, mbrojtje dhe mbështetje që është e përshtatshme për moshën e tyre.

Në rastet kur ka dyshime në lidhje me moshën e viktimës, derisa sa të vërtetohet ose verifikohet mosha, viktimat do të prezumohet e mitur dhe do të trajtohet si e tille.

Çështja e dhënies së pëlqimit është po aq e rëndësishme. Meqë pëlqimi i një fëmije në veprën penale të trafikimit nuk merret para sysh, atëherë pyetjet në lidhje me këtë element duhet të shmangen. Informacioni i mbledhur gjatë marrjes në pyetje të fëmijës viktimë për çështje të tjera nuk mund të përdoret në asnjë rrethanë kundër fëmijës.

Shumë nga parimet e intervistimit të të rriturve vulnerabël zbatohen edhe në rastin e fëmijëve. Fëmijët viktimat të trafikimit mund të jenë më vulnerabël se viktimat e trafikimit në moshë madhore. Disa nga arsyet për këtë janë:⁶⁷

- Viktimat fëmijë mund të tregojnë bindje më natyrshëm: një udhëzim nga një i rritur mund të ndiqet pa u vënë në diskutim;
- Duke mos pasur përvojë jetësore, fëmijët mund ta konsiderojnë sjelljen anormale si

⁶⁷ UNODC Anti-trafficking manual & UNICEF Guidelines on the Protection of Child Victims of Trafficking

normale, po ashtu fëmijët mund të mos i dinë fjalët për të përshkruar atë që u ka ndodhur;

- Fëmija mund të mos ketë asnjë vend ose asnjë person tek i cili të kthehet. Shumë fëmijë viktima të trafikimit janë të pashoqëruar kur rikuperohen. Mund të jetë e pamundur të gjenden të afërmit ose ata mund të kenë ndërruar jetë ose janë zhvendosur;
- Edhe kur gjenden, prindërit mund të mos e duan fëmijën të kthehet. Fëmijët mund të shihen si barrë për prindër shumë të varfër ose prindi mund të jetë i sëmurë. Në disa vende, konsiderohet turp nëse jeni migrant i dështuar. Fëmija mund të jetë i vetëdijshëm se nuk e duan në shtëpi;
- Fëmija mund të mos dojë të kthehet te familja e tij ose saj. Në disa raste, fëmijët kanë përjetuar zhgënjim që i ka çuar drejt humbjes së besimit: zhgënjimi nga një anëtar i familjes së tyre, ndonjëherë madje nga prindërit e tyre, kur fëmija u është dhënë trafikantëve.



KAPITULLI 7



TEKNIKAT SPECIALE TË HETIMIT

Neni 20 i Konventës Kundër Krimit të Organizuar i detyron Shtetet që të përdorin teknika speciale hetimore për të hetuar rastet e trafikimit të personave. Teknikat speciale të mbledhjes së provave janë pjesë thelbësore e hetimeve kryesisht dhe synojnë gjetjen e provave me cilësi të lartë për të arritur objektivat hetimorë. Ato përdoren për të identifikuar viktimat, autorët e veprave penale dhe modus operandin, si dhe vendin ku ka ndodhur shfrytëzimi.

Duke qenë se kanë natyrë ndërhyrëse, ato duhet të ndërmerren vetëm kur janë të nevojshme dhe proporcionale si dhe vetëm nga punonjës të trajnuar të forcave të zbatimit të ligjit. Ato mund të përdoren individualisht ose të ndërthurura, në varësi të objektivit të hetimit⁶⁸.

7.1 PËRSHKRIM I TEKNIKAVE

Teknikat Speciale të Hetimit që pritet të përdoren gjatë hetimit të trafikimit të qenieve njerëzore përfshijnë si më poshtë:

- Përgjimi i komunikimeve (përgjues)
- Analiza e të dhënave të komunikimeve (tabulatet celulare)
- Vëzhgimi e fshehtë (fizike dhe teknike)
- Dërgimi i agentëve të infiltruar dhe informatorëve

Disa nga aspektet ku mund të përdoren këto “teknika” hetimore” janë:

- Identifikimi i trafikantëve
- Identifikimi i viktimave
- Identifikimi dhe zbulimi i ambienteve
- Identifikimi i elementeve të trafikimit, p.sh. rekrutimi, transportimi, reklamimi
- Pasuria dhe burimet financiare të trafikantëve
- Mbledhja e informacionit operativ dhe provave
- Planifikimi i veprimeve taktike dhe strategjike
- Vërtetimi i provave të mbledhura apo të krijuara nga burime të tjera, p.sh. dëshmia e viktimës dhe e dëshmitarit.

Veprimet më të zakonshme në praktikë janë:

Vëzhgimi

Qëllimi i vëzhgimit është marrja e informacionit privat për personin, ose duke e ndjekur, ose duke marrë informacion nga vendbanimi i tij.

⁶⁸ OSBE Manuali i Trajnimit për Burimet Policore – Trafikimi i Qenieve Njerëzore 2013.

Agjenti i infiltruar

Objektivi është që një agjent i infiltruar të hiqet si kriminel për qëllimin e marrjes së informacionit operativ dhe i të dhënave kriminale.

Agjenti i fshehtë

Personi i cili, nën udhëzimet e një oficeri të policisë gjyqësore, krijon ose mban në mënyrë të maskuar marrëdhënie me një tjetër preson, me qëllim që të shfrytëzojë këtë marrëdhënie ose për të marrë informata operative ose sekret, ose për të pasur qasje në informacion dhe të dhëna sekrete për veprën penale.

Shitja ose blerja e simuluar

Oficeri i policisë gjyqësore ose një person i autorizuar mund të ngarkohet të marrë informata operative ose sekret duke u hequr si blerës potencial i shërbimeve ose si punëmarrës. Objektivi është që të konstatohet nëse kemi të bëjmë me një situatë të shfrytëzimit të viktimave.

Dorëzimi i kontrolluar

Kur marrja e informacionit për trafikimin e personave kërkon lëvizjen e viktimave, kjo lejohet bazuar në disa masa sigurie dhe oficerët e policisë gjyqësore nuk ndërhyjnë. Viktimat dhe autorët e veprës penale mbahen në vëzhgim dhe vlerësimi i rrezikut bëhet në vazhdimësi. Objektivi është që të merren informata operative dhe të dhëna për personat e përfshirë në trafikim, që nga ata që merren me rekrutimin deri te personat që merren me transportimin dhe shfrytëzimin.

7.2 PËRGJIMI I KOMUNIKIMEVE⁶⁹

Përgjimi i ligjshëm i komunikimeve për të marrë të dhëna që ofrojnë informata operative ose sekrete që mund të përdoren gjatë hetimit.⁷⁰

Përdorimi i Teknikave Speciale të Hetimit (TSH) i përfshijnë oficerët e policisë gjyqësore në aktivitet kriminal në 'kohë reale', gjë që sjell rreziqet e veta. Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe prokurorët duhet të jenë të aftë të bëjnë identifikimin, vlerësimin dhe adresimin e këtyre rreziqeve.

Përdorimi i TSH-ve në rastet e trafikimit të personave ka shumë gjasa të sjellë sfida që nuk shfaqen gjatë hetimit të veprave të tjera penale. Trafikimi i personave shpesh nënkupton hetim të 'krimit në proces'. Rastet e trafikimit të personave mbartin përherë rrezikun e dëmtimit të viktimës në formën e përdhunimit apo të sulmit fizik, apo edhe rrezikun e një 'dëmtimi në punë'. Hetuesit duhet ta mbajnë parasysh këtë gjatë gjithë kohës dhe të planifikojnë ndërhyrjet me qëllim që të mbrojnë viktimën dhe të arrijnë objektivin e përdorimit të një TSH-je.

Përgjimi i komunikimeve nënkupton dëgjimin e telefonatave ose hapjen dhe leximin e përmbajtjes së letrave dhe e-maileve të personit që konsiderohet si objektivi.

7.2.1 PRAKTIKA NDËRKOMBËTARE PËR PËRGJIMET

Si shembull për Përgjimin e komunikimeve, kemi marrë përkufizimin nga Kodi i Praktikës së Përgjimit të Komunikimeve nga Ministria e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar (2017).

Komunikimi përgjohet gjatë transmetimit të tij me anë të një sistemi telekomunikimi, nëse kryejnë një akt relevant në lidhje me sistemin. Efekti i këtij veprimi është që çdo përmbajtje komunikimi

⁶⁹ Shërbimi Sekret i Mbretërisë së Bashkuar MI5, Kolegji i Policimit, Agjencia Kombëtare kundër Krimit (NCA), Këshilli i Evropës (KiE), Konferenca për teknikat e posaçme të hetimit - 14/15 maj 2013

⁷⁰ OSBE Manuali i Trajnimit për Burimet Policore – Trafikimi i Qenieve Njerëzore

të vihet, në një kohë relevante, në dispozicion të një personi që nuk është dërguesi ose marrësi i synuar i komunikimit. Përgjimi mund të kërkojë ndihmën e një ofruesi të shërbimeve të komunikimit.

“Akt relevant” do të thotë:

- modifikim ose ndërhyrje në sistem apo në funksionimin e tij;
- monitorim i transmetimeve që bëhen nëpërmjet sistemit;
- monitorim i transmetimeve që bëhen përmes telegrafisë pa tel (wireless) drejt aparatit që është pjesë e sistemit apo prej tij.

“Kohë relevante” do të thotë:

- çdo kohë kur po transmetohet komunikimi; dhe
- çdo kohë kur komunikimi ruhet në sistem ose nga sistemi (qoftë para ose pas transmetimit të tij).

“Ofrues i shërbimeve të telekomunikimit” do të thotë;

- personi që u ofron ose u jep shërbime telekomunikimi personave ose që kontrollojnë ose ofron një sistem telekomunikimi; dhe
- operator postar që i ofron shërbime postare një personi.

“Shërbime telekomunikimi” do të thotë:

- çdo shërbim që ka të bëjë me dhënien e qasjes apo pajisjeve që mundësojnë përdorim të sistemeve të telekomunikimit (pavarësisht nëse ofrohen nga ofruesi i shërbimeve të telekomunikimit).

“Sistem telekomunikimi” do të thotë:

- çdo sistem (bashkë me aparatet që përfshin) që ekziston për lehtësimin e transmetimit të komunikimeve përmes çdo mjeti që përfshin përdorimin e energjisë elektronike apo elektromagnetike.

Sistemet e komunikimit që zakonisht hetuesit synojnë të përgjojnë janë:

- Posta e dërguar dorazi, p.sh. letra, pako
- Telefonata nga telefoni fiks
- Telefonata nga telefoni celular
- E-mail
- Mesazhe me tekst

Rezultati i Përgjimit zakonisht referohet si “të dhënat e përftuara” dhe është në formën e regjistrimit audio të një komunikimi të përgjuar, zbardhje e një komunikimi, ose imazh pamor apo kopje e një komunikimi.

Përgjimi përdoret për të mbledhur informatë sekrete dhe/ose me qëllim që të dhënat e përftuara të përdoren si provë për të mbështetur procedimin penal.

7.2.2 LEGJSLACIONI SHQIPTAR PËR PËRGJIMET

Sipas legjislacionit shqiptar “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, “Përgjim” është ndërhyrja e fshehte për të kapur, dëgjuar e regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të ndërmjet pikës së nisjes e pikës së mbërritjes. Objekt i përgjimit parandalues sipas këtij ligji janë sinjalet ose lloj tjetër informacioni, për të marre ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit.

Rezultatet e përgjimit, të marra në bazë të ligjit “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, nuk kanë vlerën e provës në një proces penal, me përjashtim të atyre të marra sipas Kodit të Procedurës Penale.

Përgjimet e kryera sipas ligjit “Për përgjimin e komunikimeve elektronike” nuk shërbejnë si prova por më së shumti për mbledhjen e informacionit të nevojshëm që krijon dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale.

Përgjimet që marrin vlerën e provës janë përgjimet që kryhen sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Përgjimi i çdo komunikimi është një veprim që kërkon shkallë të lartë ndërhyrjeje dhe, si mjet hetimi, zakonisht rregullohet nga legjislacioni ose një kod i praktikës. Përgjimi miratohet me anë të një urdhri ose mandati që lëshohet nga organi gjyqësor përgjegjës, në bazë të një kërkesë për përgjim që paraqitet përmes një kanali të njohur.

Sipas legjislacionit të brendshëm, përgjimi parandalues miratohet nga Kryetari i Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari. Vendimet për lejimin e përgjimit janë të vlefshme për komunikimin nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit Brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj kur ka marrëveshje ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.⁷¹

Në rastin e përgjimeve të kryera sipas Kodit të Procedurës Penale, autoriteti për miratimin e përgjimit është gjykata e cila autorizon përgjimin me vendim të arsyetuar, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një veprë penale.⁷²

Zakonisht, përgjimin e kryen një specialist dhe mbikëqyret nga oficeri i policisë gjyqësore ose prokurori, i cili është i njohur me praktikat hetimore dhe i jep specialistit(ëve) udhëzime të qarta për qëllimet e përgjimit.

Çështje kryesore për oficerin e policisë gjyqësore apo prokurorin në një hetim për trafikimin e qenieve njerëzore përfshijnë si më poshtë:

- kur/në cilat orare duhet të bëhet përgjimi

⁷¹ Ligji nr.9157, date 4.12.2003 “Për Përgjimin e Telekomunikimeve” i ndryshuar, neni 9.

⁷² Kodi i Procedurës Penale, neni 222.

- vlerësimi i rrezikut fillestar dhe rishikimi i tij pas çdo zhvillimi të ri
- plan ndërhyrjeje në përgjigje të informacionit të përftuar se një person ndodhet në rrezik me pasoja të rënda. Plani duhet të synojë mbrojtjen e individit në rrezik dhe duhet treguar kujdes që procesi i përgjimit të mos kompromentohet
- përkthimi, kur përdoren gjuhë të tjerë dhe në këtë proces të ndjeshëm përfshihen përkthyes të miratuar
- njohuri për rregullat dhe udhëzimet për mjedise të tjera gjyqësore, nëse të dhënat e përftuara do të ndahen me të tjerë
- dijeninë se edhe kur përftohen të dhëna nga përgjimi, vlera e përdorimit të tyre duhet të baraspeshohet me pasojat e zbulimit të tyre, pra, me dëmin që mund t'u kanoset të tjerëve dhe me zbulimin e teknikave hetimore.

Objektivat e përgjimit të telekomunikimeve mund të përfshijnë si më poshtë:

- Konstatimin nëse po trafikohen persona
- Planifikimi i përgjimit, shpëtimit/rikuperimit të viktimave të trafikimit
- Evidentimi i të dyshuarit, automjeteve, mënyrës së veprimit të trafikantëve, vendndodhjet dhe ambientet e përdorura
- Evidentimi /mbledhja e provave kundër të dyshuarve
- Evidenton mundësi shtesë për hetimin, p.sh. sisteme financiare, lëvizjet të fundit të të dyshuarve, kanalet e komunikimit.

7.2.3 SHQYRTIMI I TË DHËNAVE TË KOMUNIKIMIT

Të dhënat e komunikimit do të thotë informacion për komunikimin më tepër sesa vetë përmbajtja e komunikimit.

Disa shembuj të të dhënave të komunikimit janë:

- Të dhënat se cili telefon është përdorur për të kontaktuar të tjerët
- Detaje se nga janë bërë telefonatat, nga telefoni fiks apo celular, duke shfrytëzuar të ashtuquajturën “analizën e qelizave telefonike”
- Informacion se kush paguan për një telefon të caktuar
- Informacion kush është pajtimtari i një telefoni fiks apo celular
- Të dhënat e komunikimit me e-mail.
- Adresat postare për objekte fizike.

Të dhënat mund të merren nga:

- Celularët
- Kartat SIM
- Kartat e memories
- Hard-disku i kompjuterit.

Shpesh është më e lehtë të kesh qasje në të dhënat e komunikimit sesa të organizosh përgjimin e komunikimit. Disavantazhi kryesor është se nuk mund të lexosh apo të dëgjosh komunikimin.

Për të hyrë në të dhënat e komunikimit, duhet një kërkesë pranë ofruesit të shërbimeve të

komunikimit, si Vodafone, Telekom, Abissnet, AMC, Posta Shqiptare.

Me shumë gjasë, detyra e oficerit të policisë gjyqësore dhe prokurorëve është të bëjnë kërkesë për urdhrin ose mandatin e duhur për autorizim. Pas kësaj, zyrtarë të caktuar ose një pikë kontakti janë ata që administrojnë procesin derisa të sigurohet informacioni.

Të drejtën për të hartuar kërkesën për përgjimin parandalues e kanë:

- Drejtori i SHISH-it,
- Ministri i Brendshëm,
- Ministri i Mbrojtjes,
- Ministri i Drejtësisë ose Ministrit të Financave,

si dhe çdo ministri, që ka në varësi shërbime informative/policore të krijuara me ligj.⁷³

Kërkesa për përgjimin procedural sipas Kodit të Procedurës Penale hartohet nga prokurori në rastet kur procedohet:

- për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet;
- për çdo vepër penale me dashje kur kryhet me anën e mjeteve të telekomunikimit apo përdorimit të teknologjive informatike ose telematike.
- për veprat penale të parashikuara nga shkronja "a", paragrafi 1, i nenit 75/a, "Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar".⁷⁴

Të dhënat e kërkesës për urdhër/autorizim zakonisht përfshijnë:

- Numrat e telefonit që kontaktojnë mes tyre
- Detaje të vendndodhjes se nga ku janë bërë telefonatat, duke analizuar „qelizat celulare“ të telefonit që përdoren për t'u lidhur me rrjetin, p.sh. „analiza e qelizave celulare“
- Mbajtësi i secilit numër telefoni të identifikuar, pra, kush paguan faturën
- Pajtimtari i celularit, pra, kush e përdor telefonin
- Të dhënat e komunikimeve me e-mail që identifikojnë adresat e-mail
- Adresa e shkruar në një objekt postar fizik.

Këto të dhëna mund të përdoren me qëllim që:

- Të identifikohet vendndodhja e një telefoni ose telefoni fiks
- Të identifikohet ku ka qenë një celular në një moment të caktuar
- Të identifikohen rrjetet e telefonave që po komunikojnë mes tyre
- Të identifikohen telefonat dhe lidhjet që janë më aktive
- Të identifikohen se ku mund të jenë të dyshuarit në kohë reale dhe të hartëzohen lëvizjet e tyre rutinë
- Të identifikohet ofruesi i shërbimeve të komunikimit të pajisjeve të reja.

⁷³ Neni 8, Ligji "Për përgjimin e telekomunikimeve".

⁷⁴ Nenet 221, 222 Kodi I Procedurës Penale.

Kur planifikohet përdorimi i të dhënave të komunikimit duhen mbajtur parasysh disa konsiderata si për shembull:

- Kur celularët lëvizin nga një vend në tjetrin, ato mund të përdorin rrjetin e më shumë se të një ofruesi të shërbimit. Ky roaming ndodh sidomos kur telefoni përdoret jashtë shtetit në të cilin është regjistruar. Kjo do të thotë që mund të duhet të kontaktohen disa ofrues shërbimesh celulare, çka kërkon bashkëpunim ndërkombëtar nëse telefoni është përdorur jashtë shtetit.
- Me përdorimin e gjerë të celularëve në të gjithë globin, mund të keni qasje në të dhëna në të gjitha fazat e procesit të trafikimit.
- Në mjaft raste, viktimave u janë dhënë ose u administrohen celularë, çka ka çuar në rikuperimin e tyre.
- Analiza e të dhënave të komunikimit ndihmon shpejt në përqendrimin e hetimit në vendndodhje të caktuara, që mund t'i bëjë hetimet më efikase dhe mundëson veprime kritike që të bëhen më herët, si rikuperimi i viktimave.
- Shumë autoritete veprave penale e dinë që agjencitë ligjzbatuese përdorin përgjimin e telekomunikimeve dhe përdorin teknika kundër përgjimi/vëzhgimis. Këto janë të thjeshta si ndërrimi i shpeshtë i celularëve, përdorimi i një celulari të pastër dhe një celulari të pisët, dhënia e celularit një personi tjetër, apo vendosja e tij në një automjet apo lënia në transport publik.
- Në shumë juridiksione, hetuesit tashmë kanë përvojë në paraqitjen e kërkesave dhe përdorimin e të dhënave të komunikimit. Edhe pse ndonjëherë kërkon kohë, në rrethana urgjente mund të sistemohet shumë shpejt.
- Kur kërkohet autorizim urgjent, duhet theksuar rreziku potencial që u kanoset viktimave.

Marrja dhe trajtimi i pajisjeve të sekuestruara:

- Nga shumica e pajisjeve të komunikimit është e mundur të nxirren të dhëna.
- Këshilla kryesore është që pajisjet e komunikimit të mos fiken, nëse është e mundur. Problemi është se të dhënat mund të fshihen, nëse pajisja e komunikimit fiket dhe përdoret sërish.
- Mos harroni që të administroni pajisjet në mënyrë të tillë që të mos prishen provat fizike si p.sh. shenjat e gishtërinjve.
- Gjatë kontroleve të vendeve apo personave, regjistroni se ku janë gjetur pajisjet e komunikimit dhe personin që e kishte në posedim.
- Kërkoni fjalëkalimet. Shpesh nuk jua japin, por nëse i japin, kjo ju kursen shumë mundim më vonë.

Neni 222 i Kodit të Procedurës Penale:

“Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa mund t'i vijë një dëm i rëndë hetimeve dhe plotësohen kushtet e paragrafit 1, të këtij neni, prokurori vendos përgjimin me akt të motivuar dhe njofton gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e vendimit. Kur vleftësimi nuk bëhet në afatin e caktuar, përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren.”

Ligji “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, neni 17:

Për situata emergjente, me kërkesë verbale të drejtuesit të institucionit shtetëror përkatës, sipas nenit 6, të ligjit, Kryetari i Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari urdhëron me shkrim realizimin teknik të procesit të përgjimit. Urdhri i gjykatës regjistrohet menjëherë në evidencat e bërthamës komanduese elektronike të prokurorisë kompetente dhe te specialistët e strukturës përgjegjëse të përgjimeve në SHISH ose seksionit të përgjimeve të Policisë së Shtetit, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike. Me regjistrimin e urdhrit, specialistët e sektorit të përgjimeve ose të seksionit të përgjimeve të Policisë së Shtetit, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike realizojnë procesin e përgjimit.

Brenda 8 orëve nga fillimi i përgjimit, institucioni shtetëror që ka bërë kërkesën, i paraqet Kryetarit të Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetarit kërkesën e rregullt me shkrim, e cila përmban arsyet e veprimeve emergjente së bashku me komunikimin e përgjuar të zbardhur. Mbi këtë bazë, brenda 24 orëve nga fillimi i përgjimit, merret vendimi për vazhdimin ose ndërprerjen e përgjimit”

7.3 VËZHGIMI

Mbikëqyrja është një taktikë që oficerët e policisë gjyqësore e përdorin shpesh. Për disa lloje vëzhgimi ekziston ideja se mund të kryhen nga kushdo. Por, si me të gjitha TSH-të, vëzhgimi duhet të kryhet vetëm nga persona me trajnimin e duhur. Vëzhgimi mund të menaxhohet dhe të drejtohet nga oficerë të policisë gjyqësore që punojnë ngushtë me specialistët e trajnuar.

Meqë trafikimi i personave ndryshon nga veprat e tjera penale, është e rëndësishme që drejtuesit e hetimeve dhe prokurorët t'i udhëzojnë punonjësit që kryejnë vëzhgimin për problematikat, p.sh. të kuptojnë kur dikush është në rrezik dhe çfarë masash kontrolli të marrin për viktimën.

Vëzhgimi ka disa forma:

- Pikat statike të vëzhgimit (PV)
- Vëzhgimi në këmbë
- Vëzhgimi në lëvizje
- Vëzhgimi nga ajri
- Vëzhgimi në zona rurale
- Vëzhgimi elektronik
- Vëzhgimi në ambiente të mbyllura (psh vendosja e përgjuesve në banesë, në automjet etj)

Pikat statike të vëzhgimit

Siç e thotë edhe emërtimi, këto janë pika fikse të vëzhgimit. Këto pika janë zakonisht brenda apo mbi ndërtesa, pasi sigurojnë pamje më të mirë të veprimtarisë që hetohet. Këtë operacion e bëjnë pjesëtarët e grupit vëzhgues, ose përdoren pajisje monitorimi apo regjistrimi në distancë.

Vëzhgimi në këmbë

Nënkupton thjesht ndjekjen e dikujt në këmbë dhe zakonisht kryhet nga një grup vëzhguesish të trajnuar.

Vëzhgimi në lëvizje

Nënkupton përdorimin e automjeteve për të ndjekur dikë. Zakonisht, edhe personi që ndiqet është me automjet, por mund të jetë edhe në këmbë.

Vëzhgimi nga ajri

Nënkupton vëzhgimin nga një platformë ajrore, d.m.th., mjet fluturues me krahë që lëviz ose qëndron në pozicion fiks, dron.

Vëzhgimi rurale e maskuar

Kjo ngjason me mbikëqyrjen statike, por kryhet në ambiente të hapura si lulishte, fusha, pyje apo mjedise të tjera rurale dhe zakonisht është afatgjatë dhe fokusohet te mbledhja e informacionit operativ.

Vëzhgimi elektronike

Vendosja e një pajisjeje transmetimi në automjete dhe gjurmimi/ndjekja e sinjalit.

Vëzhgimi në ambiente të mbyllura

Kjo përfshin vendosjen e maskuar të një pajisjeje dëgjimi, pamjeje, regjistrimi apo filmimi, në një vend ku të dyshuarit jetojnë apo frekuentojnë.

Disa çështje që duhen pasur parasysh kur planifikohet vëzhgimi:

- A është vërtet i nevojshëm vëzhgimi? Për disa detyra bazë, mund të përdoren veprimtaritë rutinë të Policisë. Për shembull, patrullave mund t'u kërkohen gjëra të caktuara siç është të verifikojnë leje qarkullimi të caktuara, apo të ndalojnë automjetet gjoja për kontroll rutinë. Kriminelët e të gjitha llojeve janë mësuar me kontrollet rutine të Policisë dhe mund të mos e kuptojnë që janë nën shënjestër. E njëjta gjë vlen edhe për njësitë ajrore të Policisë, diçka kjo që praktikohet shpesh.
- Në kohët e sotme është e mundur që të përdoren pamje me qark të shkurtër (CCTV) për të monitoruar në kohë reale. Kjo nuk vihet në dyshim nga 'objektivi' dhe redukton përdorimin e teknikave që mund të bien në sy më lehtë.
- Mbrojtja e detajeve rreth vendndodhjes së një pike vëzhgimi është gjithmonë shumë e rëndësishme, aq më tepër në rastet e trafikimit të personave krahasuar kjo me veprat e tjera penale, sepse ka shumë gjasa që të nevojitet një operacion rikuperimi/shpëtimi. Qytetarët nuk duhet të ekspozohen ndaj ndonjë rreziku.
- Agjentët e angazhuar në vëzhgim nuk duhet të përfshihen në aksionin e rikuperimit/shpëtimit, përveç se në situata emergjence.
- Në disa raste mundet që të vendosen "shënime" ose paralajmërime në sisteme kompjuterike që mbajnë informacion për lejet e qarkullimit dhe targat. Kjo do të thotë që hetuesit mund të vihen në dijeni haptazi apo fshehurazi kur po kontrollohet një automjet apo person. Në rastin e automjeteve, këto sisteme po lidhen gjithnjë e më shumë me sisteme që njohin targën automatikisht.
- 'Shënimi' elektronik (vendosja e një GPS) i automjeteve mund të përdoret për të reduktuar nevojën e ndjekjes fizike të automjeteve, apo për t'i ndjekur në distancë më të madhe.

- Shtimi i numrit të pajisjeve GPS (Sistemi Global i Pozicionimit) rrit potencialin për gjurmim elektronik. Imazhet e hapura satelitore apo tokësore si Google Earth apo Google Street View mund të ofrojnë informacion të vlefshëm për vendndodhjen.
- Të gjitha taktikat më lart duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi rreziku në rastet kur ekziston potenciali për dëmtimin e të tjerëve.
- Vëzhgimi i çfarëdo lloji është i kushtueshëm dhe kërkon nivel të lartë logjistike dhe numër të lartë personeli.

7.4 HETIMI FINANCIAR DHE PASUROR

Një nga aspektet kryesore të luftës kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar është fokusimi te pasuritë kriminale, me qëllim që aktiviteti i paligjshëm të bëhet më pak fitimprurës dhe më pak tërheqës për kriminelët. Për më tepër, hetimet financiare synojnë t'i privojnë kriminelët, veçanërisht grupet kriminale, nga burimet e nevojshme për të kryer veprimtari kriminale të mëtejshme.⁷⁵

Hetimi financiar është çdo hetim në çështjet financiare të një personi. Mund të bëhet për rikuperim pasurish, por edhe për arsye të tjera si p.sh. hetim për pastrim të parave të fituara nga krimi ose qëllime të tjera si p.sh. gjetja e personave të zhdukur, gjurmimi i dëshmitarëve dhe rritja e cilësisë së hetimeve të tjera, si p.sh. për vrasje, rrëmbim, përdhunim apo trafikim personash.

7.4.1 SI PËRDOREN FITIMET PREJ TRAFIKANTËVE?

Është e rëndësishme të merren njohuri se si trafikantët i përdorin fitimet nga trafikimi i qenieve njerëzore, ku i përdorin këto fitime dhe çfarë metodash shfrytëzojnë, pasi kjo është baza e një hetimi të bazuar mbi informacion. Oficerët e policisë gjyqësore duhet të jenë të vetëdijshëm për përfitimet financiare të grumbulluara prej trafikantëve dhe se si i disponojnë fitimet e paligjshme.

Më poshtë janë disa metoda që trafikantët i shfrytëzojnë për vënien në përdorim të fitimeve:⁷⁶

- Paraja kthehet në vendin e origjinës së trafikantit dhe ri-investohet në veprimtari si të ligjshme edhe kriminale;
- Paraja kthehet në vendin e origjinës së trafikantit ku përdoret për të krijuar simbolikë pasurie dhe/ose për të treguar fuqinë e trafikantit. Kjo është e theksuar në kultura të caktuara, p.sh. kriminelët romë investojnë në shtëpi të mëdha që të tregojnë fuqinë e tyre;
- Paraja mbështet stilin luksoz të jetesës – më e përhapur në trafikantë individualë;
- Paraja mbetet në vendin e destinacionit dhe ri-investohet si në veprimtari të ligjshme edhe kriminale;
- Aktivitete terroriste.

Hetimi financiar mund të përcaktojë origjinën e parasë, si qarkullohet dhe si përdoret paraja. Objektivat kryesorë mund të jenë:

- Identifikimi i pasurive kriminale, gjurmimi i pasurive dhe inicimi i procedurave për konfiskimin e pasurive, duke përdorur masa të përkohshme si bllokimi/sekuestroja sipas rastit.

⁷⁵ <https://www.coe.int/en/web/moneyval>

⁷⁶ OSBE Manuali i Trajnimit për Burimet Policore – Trafikimi i Qenieve Njerëzore

- Fillimi i hetimeve për pastrimin e parave, sipas rastit.
- Zbulimi i strukturave financiare dhe ekonomike, çmontimi i rrjeteve ndërkombëtare dhe mbledhja e njohurive mbi modelet/rutinat e krimit.

Hetimi financiar përfshin mbledhjen, sistemimin dhe analizën e të gjithë informacionit me qëllim që të ndihmohet procedimi i veprave penale dhe të privohen autorët e veprave penale nga produktet dhe mjetet e veprës penale.

7.4.2 LEGJSLACIONI NDËRKOMBËTAR

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar 2000, neni 12 – Konfiskimi dhe marrja e sendeve, parashikon që:

1. Shtetet Palë duhet të adaptojnë, në shkallën më të madhe të mundshme dhe brenda sistemeve të tyre ligjore, masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar konfiskimin e:
 - (a) të ardhurave nga krimi, që rrjedhin nga veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë ose pasurisë, vlera e së cilës i korrespondon asaj të të ardhurave nga krimi;
 - (b) pasurisë, pajisjeve ose mjeteve të përdorura ose të destinuara për t'u përdorur në veprat penale që mbulohen nga kjo Konventë.
2. Shtetet Palë duhet të adaptojnë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të mundësuar identifikimin, zbulimin, bllokimin ose marrjen e çdo sendi që përmendet në paragrafin 1, me qëllim konfiskimin e mundshëm.

Hulumtimet e kryera për llogari të Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar⁷⁷ konstatuan se, edhe pse hetimet financiare luajnë rol të rëndësishëm për identifikimin dhe zbulimin e veprave penale (dhe jo vetëm ato financiare) ato - dhe ky është konstatim i rëndësishëm - nuk janë thelbësore në mendjen dhe praktikën e oficerëve të Policisë. Gjithashtu, edhe pse oficerët dhe drejtuesit e Policisë perceptojnë disa dobi të metodave të hetimit financiar, prapëseprapë janë përgjithësisht të pavetëdijshëm për avantazhet që ofrojnë këto metoda. Kjo mungesë ndërgjegjësimit shihej si për rolin e hetuesve financiarë posaçërisht të trajnuar, ashtu edhe me përdorimin e teknikave të hetimit financiar nga oficerët e vijës së parë për të mbështetur një sërë strategjish për mbledhje informacioni operativ dhe hetimesh.

7.4.3 HETIMI FINANCIAR DHE PASUROR SIPAS LEGJSLACIONIT SHQIPTAR

Veprat penale të trafikimit janë një prej objektivave të Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i cili përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese kundër pasurisë së personave, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për kryerjen e veprave penale, përfshirë dhe “Trafikimi i personave të rritur” parashikuar në nenin 110/a të Kodit Penal dhe “Trafikimi i personave të mitur”, neni 128/b i Kodit Penal.

⁷⁷ “Journal of Financial Crime”, Brown, R., Evans, E., Webb, S., Holdaway, S., Berry, G., Chenery, S., Gresty, B., Jones, M. (2012) *Impact of Financial Investigation on Organised Crime*. (Ndikimi i Hetimit Financiar te Krimit i Organizuar).

Hetimi financiar është kontrolli i hollësishëm në lidhje me sendet/mjetet e kryerjes së veprës penale ose produktet e veprës penale, i pasurive në pronësi dhe/ose që kanë kontroll një individ apo kompania dhe një analizë e plotë e burimeve dhe shpenzimeve të fondeve që i përkasin një individ apo kompanie, në kuadrin e procedimit penal për sekuestrimin dhe konfiskimin sipas nenit 36 të Kodit Penal, ku përfshihen dhe pasuri të palëve të treta.

Vlen të theksohet se hetimi financiar është një nga metodat e specializuara hetimore

Në shumë shtete, hetimi financiar shihet si një teknikë hetimore ashtu si edhe ekzaminimi mjekoligjor, përgjimet telefonike, dorëzimi i kontrolluar, operacionet e fshehta dhe mbikëqyrja. Në ngjasim me parimin se shkenca mjekoligjore udhëhiqet nga teoria e Locard-it se “çdo kontakt lë gjurmë”, **hetimi financiar udhëhiqet nga teoria se çdo transaksion lë gjurmë.**

Në të gjitha procedimet penale të regjistruara, prokurorët vlerësojnë kryerjen e hetimeve (paralele) financiare me qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale sipas parashikimeve të nenit 36 të Kodit Penal “Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale”.

Në funksion të këtyre hetimeve prokurorët vlerësojnë përdorimin e të gjitha mjeteve të kërkimit të provës sipas Kodit të Procedurës Penale për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale.

Rezultatet e hetimit financiar integrohen me ato të hetimit pasuror

Hetimi pasuror është procedura për verifikimin, hetimin dhe sekuestrimin e pasurisë ku përfshihen mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, nivelin ekonomik, si dhe për burimet e të ardhurave të tyre (Neni 6 I Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”).

Kontributi i hetimit financiar është tejet i vlefshëm, sepse është metodë hetimore e specializuar që agjencitë ligj zbatuese e përdorin ndaj krimit të organizuar. Hetimi financiar mund të përdoret për të gjitha aspektet e rasteve të krimit të organizuar, nga identifikimi i kriminalitetit, zhvillimi i informatave dhe ndërtimi i akuzës, deri te procedimi penal dhe ekzekutimi i urdhrave të konfiskimit.

Kur përdoret, hetimi financiar mund të kontribuojë në procesin e ndërtimit të akuzës, sepse:

- Identifikon krimin e organizuar që në fillim;
- Identifikon shtrirjen e një grupi të strukturuar kriminal;
- Gjen pasuritë në pronësi apo në përdorim të pjesëtarëve të grupit të strukturuar kriminal;
- Identifikon pronësinë dhe përdorimin e pronave;
- Zbulon prova të mënyrës së jetesës që bëjnë personat objekt i hetimit;
- Ndjek lëvizjet e individëve;
- Konstaton vendndodhjen e njerëzve në vende të caktuara në momente të caktuara, duke i lidhur me krimin apo grupe të caktuara kriminale; dhe
- Identifikon vepra penale dhe autorë veprash penale shtesë.

7.4.4 HETIMI FINANCIAR NË RASTET E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Trafikimi i qenieve njerëzore është, në thelb, një krim i motivuar financiarisht. Pjesa më e madhe e rasteve të trafikimit, pavarësisht nga lloji, kryhet nga kriminelët me një shtysë financiare në mendje dhe gjeneron fitime rreth 150 miliardë dollarë amerikanë çdo vit nga shfrytëzimi i personave. Objekti dhe shtrirja e trafikimit është globale, sepse prek çdo vend në botë dhe praktikisht çdo sektor ekonomik të shoqërisë.

Aspektet financiare të veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore njerëzor shfaqen në të paktën dy mënyra kryesore:⁷⁸

- Krimi bëhet për para. Përveç investimit fillestar për të krijuar infrastrukturën dhe për të siguruar personat për shfrytëzim, menaxhimi i vazhdueshëm i të ardhurave nga shfrytëzimi dhe, në fund, pastrimi dhe qarkullimi i fitimeve duhet të bëhen pjesë e veprimtarive të trafikantëve.
- Trafikimi është një krim që kërkon kohë të ngrihet dhe të zhvillohet. Prandaj, bën që edhe stili i jetesës të kriminalizohet. Ky stil jetese përfshin udhëtime, shpenzime për sende luksoze si makina dhe bizhuteri, si edhe zbavitjen në kohën e lirë si frekuentimi i restoranteve dhe kazinove; të gjitha këto kërkojnë mjete dhe metoda blerjeje.

Për të siguruar konfiskimin e produkteve të veprës penale, është thelbësore të sigurohet identifikimi në kohë i fondeve të tilla dhe zbatimi i masave të përkohshme, në mënyrë që rrjeti kriminal të mos fshehë pasuritë në fjalë.

Këshillohet kryerja e hetimit financiar kryesisht, si gjatë fazës hetimore para arrestimit ashtu edhe në fazën pas arrestimit.

7.4.5 FONDI I POSAÇËM PËR PARANDALIMIN E KRIMINALITETIT

Legjislacioni shqiptar ka krijuar mundësinë për të siguruar dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore nga një skemë shtetërore e kompensimit, nëpërmjet zbatimit të ligjit, nr. Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar⁷⁹.

Rëndësia e këtij ligji qëndron në parashikimin e masave të posaçme për të goditur pasurinë e krijuar si rezultat i veprimtarisë së krimit të organizuar. Ligji parashikon kalimin në favor të shtetit të të gjitha pasurive që konfiskohen me vendim gjykate. Për administrimin e tyre krijohen organe të posaçme. Sidoqoftë, ligji nuk destinohet vetëm për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, por për të gjitha kategoritë e viktimave të krimit të organizuar.


Ky ligj vendos disa forma të administrimit të pasurive të konfiskuara në favor të viktimave të krimit të organizuar, të cilat mund të përdoren si për dëmshpërblimin individual, ashtu edhe për dëmshpërblimin kolektiv të tyre. Ligji parashikon krijimin e një fondi me pasuritë e konfiskuara, i cili ka për qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori (neni 37/2/c e ligjit). Të ardhura të krijuara nga ky fond i posaçëm mund të përdoren për dëmshpërblim individual të viktimave mbi bazën e vendimit gjyqësor, si dhe për mbështetjen, rehabilitimin dhe riaftësimin e viktimave.

⁷⁸ Manuali i UNODC për antitrafikimin.

⁷⁹ Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar me ligj nr. 70/2017, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.



KAPITULLI 8.



BASHKËPUNIMI ME AGJENCITË LIGJ ZBATUESE DHE JO LIGJ ZBATUESE, SISTEMIN GJYQËSOR DHE PARTNERËT

Numri i ulët i procedimeve penale dhe, aq më tepër, numri i ulët i dënimeve të trafikantëve, tregojnë se vendosja para drejtësisë e autorëve të veprave penale vazhdon të mbetet sfida. Për agjencitë ligjzbatuese dhe autoritetet gjyqësore sfidat kryesore përfshijnë:

- i) vështirësi për të vërtetuar elementët kompleksë të veprës penale;
- ii) sigurimin e nivelit të duhur të burimeve dhe njohurive për kryerjen e hetimeve financiare; dhe
- iii) vështirësitë në bashkëpunimin ndërinstitucional

8.1 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR NDËRMJET AGJENCIVE LIGJ ZBATUESE

Bashkëpunimi ndërkombëtar zyrtar mund të bazohet në traktate ose marrëveshje dypalëshe, shumëpalëshe ose rajonale, përfshirë marrëveshjet për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë ligjore në çështjet penale.

Bashkëpunimi informal nuk rregullohet me statute apo traktate, por nënkupton kontakte operacionale mes oficerëve të policisë për të lehtësuar shkëmbimin e sigurt dhe të shpejtë të informacionit, në funksion të hetimit.

Sfidat që hasen më shpesh për bashkëpunimin e efektshëm të agjencive ligjzbatuese janë:

- Mosnjohja e sistemeve ekzistuese;
- Mungesa e besimit të partneri i mundshëm;
- Dallimet aktuale ose të perceptuara në drejtësinë penale/sistemet gjyqësore;
- Strukturat ligjzbatuese të panjohura ose të pazakontë të shtetit partner;
- Mosnjohja e kanaleve / mekanizmave ekzistues të komunikimit / bashkëpunimit;
- Mos ekzistenca ose dobësia e kanaleve të drejtpërdrejta të komunikimit ndërkombëtar mes shteteve;
- Pengesat gjuhësore;
- Paragjykimet kulturore/ historike/ fetare/ organizative;
- Gjasat e hetimit intensiv të burimeve/financës

Shumica, në mos të gjitha këto çështje, mund të zgjidhen ose përmirësohen duke përdorur masa të bashkëpunimit zyrtar.

Shembuj të formave të bashkëpunimit ligjzbatues ndërkombëtar:

- Zyrtarë shtetërorë (Oficerë Ndërlidhës) të atashuar në shtet tjetër për të lehtësuar

bashkëpunimin me agjencitë ligjzbatuese të qeverisë pritëse në funksion të hetimeve penale

- Pjesëmarrja ose anëtarësimi në mekanizma bashkëpunimi rajonal, p.sh. SELEC
- Legjislacioni ndërkombëtar për bashkëpunimin
- Marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe Memorandumet e Mirëkuptimit që evidentojnë bashkëpunimin ligjzbatues dhe shkëmbimin e mekanizmave informues
- Anëtarësimi në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminalistike (INTERPOL) dhe/ose bashkëpunimi me strukturat rajonale siç janë Zyra Evropiane e Policisë (Europol), Eurojust (edhe çështjet e bashkëpunimit gjyqësor), CEPOL dhe Frontex.

Posaçërisht për Shqipërinë:

- Prokurori ndërlidhës pranë Eurojust në Hagë;
- Oficeri policor ndërlidhës pranë Europol në Hagë;
- Oficeri ndërlidhës i Europol i atashuar në Tiranë;
- Zyra Qendrore Kombëtare e Interpol-it (NCB) në Tiranë;
- Oficeri policor ndërlidhës pranë SELEC në Bukuresht.

Sfidat e bashkëpunimit ligj zbatues zakonisht ndodhin kur kërkimet ose hetimi duhet të zhvillohen përtej procedurave të zakonshme ose të njohura. Shembulli tipik është rasti kur është e qartë se një hetim vendas ka lidhje ndërkufitare ose ndërkombëtare që kërkojnë hetime të mëtejshme.

8.2 SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Hetimi i trafikimit të qenieve njerëzore fillon ‘lokalisht’ nga struktura hetimore, sepse ka ndodhur ose po ndodh në territorin e vendit dhe prandaj është përgjegjëse për hetimin e veprës penale.

Pasi identifikohet një lidhje apo aspekt ndërkombëtar, vlerësohet dhe merret vendimi se si, ose nëse do të zhvillohet më tej. Më poshtë, janë disa shembuj të lidhjeve ndërkombëtare që në fazat e hershme të hetimit që mund të duhet të hetohen më tej janë:

- Numër telefoni i identifikuar ose i dyshuar jashtë shtetit
- Automjet apo formë tjetër transporti e regjistruar jashtë shtetit
- Letërnjoftim, pasaportë, dokumente udhëtimi, dokumentet mbështetëse të vizave të huaja
- Viktimë ose i dyshuar që është shtetas i huaj
- Adresë ose vend i identifikuar jashtë shteti, p.sh. ambiente banimi, hotel, njësi magazinimi, depozitë sigurie, ambiente fabrike
- Mandatet, faturat, autorizimet apo dokumente të tjera udhëtimi nga shtete të tjera
- Dokumentacioni i transfertave ndërkombëtare të parasë.

Kërkimet për sa më sipër ndodhin në fazën e hershme hetimore dhe mund të kryhen përmes kanaleve të komunikimit të agjencive ligj zbatuese. Ky bashkëpunim njihet si “bashkëpunim jozyrtar”, edhe pse procesi i nënshtrohet Memorandumeve të Mirëkuptimit, rregullimeve dypalëshe ose protokolleve të tjera, këto kërkime janë kërkesa për informacion.

Shembuj të sistemit të trajtimit dhe klasifikimit të informacionit nga Policia e Shtetit apo tjetër agjenci sipas Ligjit Nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

“**Tepër sekret**”, kur ekspozimi i paautorizuar mund t’i shkaktojë dëme veçanërisht të rënda sigurisë kombëtare.

“**Sekret**”, kur ekspozimi i paautorizuar mund t’i shkaktojë dëme serioze sigurisë kombëtare.

“**Konfidencial**”, kur ekspozimi i paautorizuar mund t’i shkaktojë dëme sigurisë kombëtare.

“**I kufizuar**”, kur ekspozimi i paautorizuar mund të dëmtojë veprimtarinë ose efektivitetin e institucioneve shtetërore në fushën e sigurisë kombëtare.

Kërkesat për informacione që vlerësohen me përparësi të lartë, për shkak të gjasave që informacioni të jetë thelbësor për hetimin apo shpëtimin e viktimave, zakonisht paraqiten si kërkesa urgjente për ndihmë në kohë reale dhe trajtohen si të tilla.

Kërkimet e tjera jo urgjente trajtohen sipas informacionit të kërkuar dhe qëllimit të tij.

Kanali më efektiv për shkëmbimin e informacionit mes agjencive ligj zbatuese do të ishte një platformë e dedikuar, krahasuar me telefonatat apo e-maillet në drejtim të një pike kontakti të njohur apo të panjohur që përdor një kanal potencialisht të pasigurt.

Autoritetit përgjegjës të një shteti tjetër i kërkohet, në mënyrë tipike, që të bëjë kërkime nëpërmjet një rrjeti të dedikuar ligj zbatues ose gjyqësor.

Për hetimet brenda Evropës, Europol dhe Eurojust ofrojnë mbështetje për hetime në krimet e rënda dhe krimin e organizuar, të cilat kryhen përmes Zyrës Ndërlidhëse të Europol-it ose drejtpërdrejtë nga Eurojust-i. Për kërkimet në vende të tjera të botës, kanali i zakonshëm është Interpol përmes Zyra Qendrore Kombëtare-së në kryeqytet.

Oficeri policor ndërlidhës ose prokurori ndërlidhës i atashuar pranë shtetit në fjalë është në gjendje t’u përgjigjet drejtpërdrejtë në kohë reale këtyre lloj kërkesash, pasi kanë marrëdhënie të konsoliduar me vendin pritës dhe veprimtaria e tyre i nënshtrohet kuadrit ligjor ose një Memorandumi Mirëkuptimi.

Kërkimet e zhvilluara përmes këtyre kanaleve ndërlidhëse kufizohen në shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit operativ dhe në kërkesat e kufizuara për veprimet e Policisë. Kërkesat për prova dhe veprimet e mbledhjes së provave, të tilla si marrja e deklaratave, kontrollet në banesa, operacionet e mbikëqyrjes, d.m.th. Bashkëpunimi gjyqësor duhet të avancojë përmes kanaleve të Ndihmës së Ndërsjellë Ligjore.

8.3 NDIHMA E NDËRSJELLË LIGJORE

Ndihma e Ndërsjellë Ligjore (NNL) është një proces që Shtetet e përdorin për të dhënë dhe marrë ndihmë zyrtare nga njëri tjetri në hetimet dhe ndjekjet penale. Forma specifike e ndihmës së ndërsjellë ligjore që Shtetet i ofrojnë njëri tjetrit do t’i nënshtrohet të drejtës së brendshme dhe modaliteteve ndërkombëtare⁸⁰.

NNL-ja ose “bashkëpunimi zyrtar” zakonisht mbështetet në traktatet dypalëshe ose shumëpalëshe,

⁸⁰ OSBE Manuali i Trajnimit për Burimet Policore – Trafikimi i Qenieve Njerëzore – OSBE 2013

por mund të mbështetet gjithashtu në legjislacionin e brendshëm që mund të jetë baza ligjore e paracaktuar e kërkesës. Kërkesat për NNL mund të bëhen dhe të pranohen vetëm nga autoritetet gjyqësore të institucioneve kompetente vendase pasi ato kanë të bëjnë me marrjen dhe rikuperimin e provave.

Provat mund të merren në mënyra jozyrtare. Masa se nga çfarë mund të merren këto prova varet nga dy faktorë: nga masa që legjislacioni i brendshëm i Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së i lejon kërkesat për prova, dhe nga lloji i marrëdhënies së Shtetit tuaj me Shtetin apo Shtetet e tjera nga i cili apo të cilët kërkoni të merrni provat. Sa më e mirë të jetë marrëdhënia profesionale ndërmjet shteteve, aq më të mëdha janë gjasat për një aplikim jozyrtar të suksesshëm.⁸¹

Ndërkohë që nuk mund të renditim se cilat provat mund të merren në mënyrë jozyrtare, si udhëzime i përgjithshëm, nëse prova është çështje dokumenti publik, ajo mund të merret në mënyrë jozyrtare. Gjithsesi, nëse lidhet me veprime të fshehta, atëherë është mëse e sigurt se do të jetë i nevojshëm një aplikim zyrtar.

Mund të konsiderohen edhe aplikimet jozyrtare për të konstatuar nëse dëshmitarët janë të gatshëm të japin dëshmi apo të marrin një deklaratë me shkrim kur ato janë dëshmitarë vullnetarë. Kur kërkohen prova jozyrtare, nëse një hetues ose prokuror ka ndonjë dyshim që provat mund të përjashtohen nga çdo seancë gjyqësore në vijim, ata gjithmonë duhet të bëjnë një kërkesë zyrtare për provat.

Provat që zakonisht kërkojnë aplikim zyrtar përfshijnë deklaratat nga dëshmitarë jovullnetarë, të dhëna financiare nga bankat dhe institucione të tjera si dhe prova që lidhen me teknikat e posaçme hetimore shtrënguese. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë detyrimin të respektojnë konventat ndërkombëtare që kanë ratifikuar dhe legjislacionin e tyre të brendshëm përkatës për mënyrën si mund të marrin provat. Hetuesit dhe prokurorët duhet të sigurojnë se, në rast të kërkesës për prova zyrtare, duhet të respektohen konventat dhe legjislacioni. Në rast të kërkesës për materiale jo-dëshmuese, për shembull inteligjencë, atëherë ndihma e ndërsjellë juridike nuk është gjithmonë e zbatueshme.⁸²

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (UNTOC) përmban dispozita të hollësishme për bashkëpunimit zyrtar dhe jozyrtar në çështjet penale, të cilat janë të zbatueshme edhe për Protokollin e Trafikimit, si më poshtë:

- Ekstradimi (neni 16);
- Transferimi i personave të dënuar (neni 17);
- Ndihma e ndërsjellë ligjore (neni 18);
- Hetimet e përbashkëta (neni 19);
- Bashkëpunimi në përdorimin e teknikave të veçanta hetimore (neni 20);
- Transferimi i procedimeve penale (neni 21)
- Bashkëpunimi ndërkombëtar për qëllime konfiskimi (nenet 13-14);
- Bashkëpunimi ligj zbatues (neni 27).

Çarë mund të kërkohet përmes NNL-së :

- Marrja e provave ose deklaratave;
- Kryerja e shërbimeve që lidhen me dokumentet gjyqësore;

⁸¹ OSBE Manuali i Trajnimit për Burimet Policore – Trafikimi i Qenieve Njerëzore – OSBE 2013

⁸² OSBE Manuali i Trajnimit për Burimet Policore – Trafikimi i Qenieve Njerëzore – OSBE 2013

- Ushtrimi i kontrolleve dhe sekuestrimeve;
- Dorëzimi i simuluar, p.sh. drogës;
- Operacionet e mbikëqyrjes;
- Ngrirja e produkteve të krimit;
- Shqyrtimi i objekteve dhe vendeve;
- Sigurimi i informacionit, mjeteve të provës dhe akt-ekspertizave;
- Sigurimi i origjinaleve ose kopjeve të certifikuara të dokumenteve dhe të të dhënave, përfshirë të dhënat shtetërore, financiare, tregtare apo të biznesit;
- Identifikimi ose gjurmimi i produkteve të krimit, pronave, mjeteve apo sendeve të tjera për qëllime provueshmërie.

8.4 BASHKËPUNIMI ME SHOQËRINË CIVILE

Shoqëria civile është “sektori i tretë” i shoqërisë, së bashku me qeverinë dhe biznesin. Përbëhet nga organizata të shoqërisë civile dhe organizata joqeveritare (OJQ).

Shoqëria civile është një pjesë përbërëse e pandarë e çdo përgjigjeje kombëtare për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Direktiva e BE-së kundër Trafikimit si edhe Konventa e KiE për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore njohin dhe përshkruajnë rolin e shoqërisë civile dhe inkurajojnë vendet të punojnë ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, si edhe të përfshijnë organizatat joqeveritare të njohura dhe aktive që punojnë me personat e trafikuar, veçanërisht në nismat e politikëbërjes, fushatat e informimit dhe ndërgjegjësimit, programet kërkimore dhe arsimore dhe në trajnime, si dhe në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të masave antitrafik.

Plani i Veprimit i OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore⁶⁴ miratuar në vitin 2003, thotë në Preambulë: “Duke pranuar që ndërsa përgjegjësia kryesore për luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore u takon Shteteve pjesëmarrëse, lidhja e këtij fenomeni me krimin e organizuar tejkombëtar kërkon bashkëpunim në nivelin ndërkombëtar dhe rajonal, duke përfshirë sektorin privat dhe OJQ-të. ”

Përfshirja e shoqërisë civile në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore evidentohet qartë në deklaratat e bëra nga organizata, institucione, politikanë, figura të larta dhe praktikues, kur shpjegojnë strategjitë për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe përdorin shprehjen “3 P-të” ose “5 P-të”.

1. Mbrojtja
2. Procedimi
3. Parandalimi
4. Ndëshkimi (i trafikantëve/mosndëshkimi i personave të trafikuar) dhe
5. Promovimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, p.sh. partneritetet

Për shembull, Plani i veprimit i OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore siguron kuadrin për veprimtaritë e OSBE-së në mbështetje të përpjekjeve antitrafikim të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

Plani përmban zotime thelbësore për veprim në nivelin kombëtar, të njohur si “3 P-të”:

Parandalimi, përfshirë trajtimin e shkaqeve rrënjësore dhe ndërgjegjësimin;

Procedimi, përfshirë hetimin dhe gjykimin; dhe

Mbrojtja e të drejtave të viktimave, përfshirë ndihmën dhe kompensimin.


Në vitin 2013, OSBE-ja shtoi edhe një “P” të katërt, Partneritetet, ku nënvizon nevojën për të forcuar bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe partnerët e tjerë të jashtëm, përfshirë për çështjet si ligj zbatimi, Mekanizmat Kombëtarë të Referimit (MKR) dhe puna e përbashkët ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit publik.

Ndihma për viktimën, mbështetja, masat e mbrojtjes dhe kërkesat ligjore nuk mund të përmbushen nga organet ligj zbatuese ose organet gjyqësore që veprojnë të veçuara nga shoqëria civile. Angazhimi me OJQ-të, organizatat ndërqeveritare, organizata ndërkombëtare si OSBE, IOM, UNHCR, UNODC për shembull, si partnerë të barabartë në këto fusha, është thelbësor për të garantuar një përjasje me në qendër viktimën, si edhe për të përfituar nga përvoja dhe burimet e këtyre lloj organizatash.

Organizatat e shoqërisë civile mund të japin (dhe shpesh e bëjnë këtë) kontribute aktive, konstruktive dhe pozitive drejt hartimit të ligjeve dhe politikave në lidhje me trafikimin e personave dhe, më gjerë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë. Në këtë drejtim, ato nuk duhet të konsiderohen thjesht si një grup subjektsh të specializuara që ofrojnë thjesht mbështetje teknike kur kërkohen ose lejohen nga Shteti.⁸³

⁸³ Roli Vendimtar i Shoqërisë Civile në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore - OSBE 2018

KAPITULLI 9.



MOSDËNIMI I VIKTIMËS SË TRAFIKIMIT

9.1 PARIME TË PËRGJITHSHME

Në të gjitha rastet e trafikimit zbatohen një numër parimesh të përgjithshme Ato janë:

- Viktimat e trafikimit duhet të identifikohen si viktima të krimit;
- Ato nuk duhet të trajtohen si kriminelë;
- Ato nuk duhet të trajtohen vetëm si burim provash;

Peronat e trafikuar disa herë trajtohen si kriminelë dhe jo si viktima, qoftë në Shtetet e destinacionit, apo ato të transitit ose origjinës. Në Shtetet e destinacionit, ato mund të ndiqen penalisht dhe të ndalohen për shkak të statusit të migrimit apo punës së parregullt. Po ashtu, autoritetet e imigracionit mundet që thjesht t'i dëbojnë në Shtetin e origjinës nëse statusi i imigrimit është i parregullt. Personat e trafikuar që kthehen në Shtetin e origjinës mund t'i nënshtrohen procedimit për përdorim të dokumenteve të rreme, për largim nga Shteti në mënyrë të paligjshme, apo se kanë punuar në industrinë e seksit. Kriminalizimi e kufizon qasjen e viktimës së trafikimit në drejtësi dhe mbrojtje dhe redukton gjasat që ta raportojnë viktimizimin e tyre pranë autoriteteve. Duke pasur parasysh frikën e viktimave për sigurinë e tyre personale dhe prej ndëshkimit nga trafikantët, frika e shtuar e procedimit penal dhe ndëshkimit vetëm sa mund shërbejë si një pengesë e mëtejshme për viktimën që të kërkojë mbrojtje, ndihmë, dhe drejtësi.

Neni 26 i Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2005, shprehet se:

“Çdo Palë, në përputhje me parimet bazë të sistemit të saj ligjor, do të parashikojë mundësinë e mos vendosjes së dënimit për përfshirjen e viktimave në aktivitete të paligjshme, në masën që ato kanë qenë të detyruara ta bëjnë këtë.”

Kjo është “Dispozita e mosdënimit” dhe baza për ta zbatuar parimin në lidhje me çdo veprimtari jo të ligjshme është se viktima ka qenë e detyruar.

Ky parim mbështetet në arsye të ndryshme, përfshirë:

- Ruajtjen e interesave të drejtësisë duke siguruar që viktimat të mos dënohen për veprime që nuk do t'i kishin kryer po të mos ishte për arsye të viktimizimit të tyre.
- Mbrojtjen e të drejtave të viktimës për të siguruar që atyre u jepet qasje e menjëhershme në mbështetjen dhe shërbimet e nevojshme dhe për të shmangur nënshtrimin e tyre ndaj traumës apo viktimizimit të mëtejshëm.
- Inkurajimin e viktimave për të raportuar krime të kryera kundër tyre dhe për të marrë

pjesë i dëshmitarë në procese gjyqësore kundër trafikantëve pa pasur frikën e të qenit të censuruar vetë.

- Sigurimin që viktimat nuk dënohen për sjelljen e trafikantëve

Kodi ynë penal, njih përjashtimin nga dënimi të personave të dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin, sipas nenit 52 të Kodit Penal.

Këta persona mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.

BIBLIOGRAFI

REFERENCA

INSTRUMENTE NDËRKOMBËTARË

- » Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1948.
- » Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- » Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të e 25 tetorit 2012 “ Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.
- » Konventa për Ndalimin e Tregtisë së Skllavërive të Bardhë, 1910.
- » Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Trafikimit të Grave dhe Fëmijëve, 1921.
- » Konventa e Lidhjes së Kombeve për Skllavërinë, 1926.
- » Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës nr. 29, për Punën e Detyruar, 1930.
- » Konventa e Lidhjes së Kombeve për Ndalimin e Trafikimit të Grave në Moshë Madhore, 1933.
- » Konventa për Ndalimin e Trafikimit të Personave dhe Shfrytëzimit të Prostitucionit të të tjerëve, 1949.
- » Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Këshilli i Evropës, 1950 (hyri në fuqi në 1953).
- » Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, Organizata e Kombeve të Bashkuara 1979.
- » Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Organizata e Kombeve të Bashkuara 1989.
- » Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, 2000.
- » Konventa e Migracionit për Punësim, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 1949.
- » Konventa nr. 143 Për Punëtorët Migrantë (Dispozita Shtese), Organizata Ndërkombëtare e Punës, 1975.
- » Marrëveshja e parë Ndërkombëtare për Sigurimin e Mbrojtjes së Efektshme ndaj Trafikimit kriminal, 1904.
- » Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005.
- » Pakti për të Drejtat Civile e Politike, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1966.
- » Pakti për të Drejtat Ekonomike Social e Kulturore, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 1966.
- » Protokollin kundër Trafikimit të Migrantëve me Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare, Organizata e Kombeve të Bashkuara, 2000.

- » Protokollin për Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikut të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve
- » Protokollin 2014 i Konventës mbi Punën e Detyruar, Organizata Ndërkombëtare e Punës, 1930.
- » Rekomandimi nr. (85) 11 i Këshillit të Evropës mbi Pozicionin e Viktimës në kuadrin e Legjislacionit dhe Procedurës Penale.
- » Vendimi Kuadër i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal, 2001.
- » Konventa 95 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Mbrojtjen e Pagave.
- » Konventa 181 e Organizatës Ndërkombëtare e Punës mbi Agjencitë Private të Punësimit.
- » Konventa Evropiane e Këshillit të Evropës për Kompensimin e Viktimave të krimeve të dhunshme, 1983.
- » Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimi të Pushtetit, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 1985.
- » Direktiva e Këshillit të Bashkimit Evropian 2004/80/EC “Për kompensimin e viktimave të krimit”.

RAPORTE, STUDIME, MANUALE, ARTIKUJ, ETJ.

- » ICMPD, Anti-Trafficking Training Material for Judges and Prosecutors [Material Trajnimi për Gjyqtarë dhe Prokurorë në Shtetet anëtare të BEsë dhe vendet candidate], 2006. https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/icmpd_curriculum_2006_en_1.pdf
- » UNODC, Anti-Human Trafficking Manual for Criminal Justice Practitioners 2009 [Manuali për Anti-Trafikimin për profesionistët e sektorit të Drejtësisë]. <https://www.unodc.org/unodc/en/human-trafficking/2009/anti-human-trafficking-manual.html>
- » Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the EU Strategy on Combatting Trafficking in Human Beings 2021- 2025, Brussels, 14.4.2021, në https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/default/files/pdf/14042021_eu_strategy_on_combatting_trafficking_in_human_beings_2021-2025_com-2021-171-1_en.pdf
- » Organization for Security and Cooperation in Europe/ODHIR, Mekanizmat Kombëtarë të Referimit: Bashkimi i Përpjekjeve për Mbrojtje të Drejtave të Personave të Trafikuar, Manual Praktik, 2004.
- » Organization for Security and Cooperation in Europe/ODHIR, Compensation for Trafficked and Exploited Persons in the OSCE Region, 2008. Organization for Security and Cooperation in Europe, Combating Human Trafficking, Permanent Council Decision No. 557: OSCE Action Plan to Combat Trafficking in Human Beings, <https://www.osce.org/actionplan>
- » Organization for Security and Cooperation in Europe, “Trafficking in Human Beings: Identification of Potential and Presumed Victims”, 2011. <https://www.osce.org/files/f/documents/4/e/78849.pdf>

- » Prezenca e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Shqipëri, “Tipologjia e Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri”, 2020.
- » Raporti i 3të i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi progresin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020) në zbatim të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave. https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third_progress_report.pdf
- » Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit mbi Trafikimin e Personave, 2020: Shqipëria, https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/TIP_ENG.pdf.
- » Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit. OSBE, 2014. <https://www.osce.org/files/f/documents/d/c/110471.pdf>
- » Raporti i Raportuesit të Posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për Trafikimin e Personave, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, A/HRC/41/46, 23 prill 2019.
- » Rregullat Minimale Standard të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit 1985)
- » Udhëzimi i UNICEF për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Trafikimi, https://www.unicef.org/protection/Unicef_Victims_Guidelines_en.pdf
- » UNICEF “Reference Guide on Protecting the Rights of Child Victims of Trafficking in Europe”, 2004.
- » Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të Rinjtë (Udhëzimet e Riadit)
- » UNODC: Database e çështjeve gjyqësore, <https://sherloc.unodc.org/cld/v3/htms/cldb/index.html?lng=en>
- » Trafficking and Exploitation: Guidance for health Workers, Scottish Government, October 2019,
- » Treguesit e punës së detyruar, ILO, https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/--declaration/documents/publication/wcms_203832.pdf
- » Zyra e Komisionierit të Lartë për Drogën dhe Krimin, “Abuse_of_a_Position o Vulnerability” https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2012/UNODC_2012_Guidance_Note_-_pdf
- » Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, “Parimet dhe udhëzimet e rekomanduara për të drejtat e njeriut dhe trafikimin e qenieve njerëzore” <https://www.ohchr.org/documents/publications/traffickingen.pdf>
- » Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, Ligji Model kundër trafikimit të personave i, https://www.unodc.org/documents/human-trafficking/2014/UNODC_2014_Issue_Paper_Consent.pdf
- » Human trafficking and exploitation: guidance for health worker: Scottish Government October 2019 [Trafikimi dhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore: udhëzues për punonjësit shëndetësor: Qeveria skoceze tetor 2019]
- » Tipologji e Trafikimit të Fëmijëve në Shqipëri, Prezenca e OSBEsë 2020.
- » Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998, e ndryshuar.

- » Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995, i ndryshuar.
- » Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, 1995, i ndryshuar.
- » Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, 2017.
- » Ligji nr. 9110 datë 24.07.2003 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave për Krime të Rënda”.
- » Ligji 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.
- » Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.
- » Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
- » Ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.
- » Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 663 datë 17.07.2013 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020 dhe Planit të Veprimit për Vitet 2013-2016”.
- » Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 26.11.2014 “Për një Shtesë në Vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave ‘Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020, dhe Planit të Veprimit për vitet 2013-2016”.
- » Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 499, datë 29.8.2018, “Për Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”.



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri